



Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës
në Dragash



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013 - 2023

PJESA II: KAPITUJT 5 - 9

Michael Voit

Dorothea Roßner

Maria Elena Zuniga Barrientos - Project Manager

Me kontributin e:

Florian Bemmerlein-Lux – Biolog, Peter Bank – Biolog, Ergin Hajredini – Ekspert i Pylltarisë dhe GIS, Dr. Halil Ibrahim – Ekolog, Todd Wassel – Specialist i Turizmit, Cristian Angelescu – Inxhinier Sanitar, Shpresa Kastrati – Inxhinierë për Sanitari, Ekkehart Naumann – Ekspert i energjetikës, Maliq Pireci – Ekspert i energjetikës, Rreze Duli, Specialiste për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale Kaltrina Salihu – Zyrtare për komunitet, Ismail Gagica, Ekspert i GIS, Bashkim Susuri – Gazetar dhe Bashkëpunëtor i Projektit, Ajhan Hadzija – Koordinator i Turizmit, Abdullah Kryeziu – Përkthyes, UNICEF Kosovë, dhe nga Grupi Komunal Punues (GKP) i Komunës së Dragashit: Avni Nebiu – Koordinator, Hajri Ramadani – Drejtor i Arsimit, Ramadan Jashari – Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ahmet Bahtijari – Drejtor për Ekonomi dhe Financa, Bajram Hoxha – Drejtor i Zhvillimit Bujqësor dhe Inspeksionit, Bean Hadziasan – Drejtor i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes të Ambientit, Uzair Hamza – Zyrtar për komunitete, Tafil Krasniqi- Drejtor për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, Kamber Kamberi – Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Lindita Piraj – Zyrtare komunale për barazi gjinore, bazuar në vlerësimin paraprak të UN-HABITAT.

**Dragash, Kosovë
Qershor 2013**

Përmbajtja

5.	VIZIONI, PARIMET E PËRGJITHSHME DHE SYNIMET	4
5.1	VIZIONI	4
5.2	PARIMET E PËRGJITHSHME DHE SYNIMET	5
5.2.1	<i>Parimet e përgjithshme</i>	<i>5</i>
5.2.2	<i>Synimet afatgjata të zhvillimit</i>	<i>5</i>
5.3	PRIORITETET STRATEGJIKE.....	9
6.	SKENARËT	10
6.1	FAKTORËT KRYESORË PËR ZHVILLIM	10
6.2	SKENARI I PRIRJEVE	11
6.3	MJETET E PËRMIRËSIMIT	12
6.4	SKENARI MË I MIRË	12
7.	KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR	14
7.1	HARTA E KORNIZËS ZHVILLIMORE	14
7.2	PARIMET PËR ZHVILLIMIN FUNKSIONAL TË VENDBANIMEVE.....	15
7.3	FUNKSIONET SHITESË TË VENDBANIMIT	17
7.4	PARIMET E RRJETIT RRUGOR	17
7.5	PARIMET PËR ZHVILLIMIN E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS	18
7.6	FUNKSION SHITESË NË PEIZAZHE: TURIZMI	19
7.7	VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE I MJEDISIT NË KORNIZËN E PROPOZUAR.....	19
8.	STRATEGJITË	20
8.1	BIODIVERSITETI DHE RUAJTJA E NATYRËS	20
8.2	VENDBANIMET	27
8.3	EKONOMIA VENDORE	43
8.4	RRJETI RRUGOR, TRANSPORTI	50
8.5	SHËNDETI DHE MIREQËNIA SOCIALE.....	57
8.6	ARSIMIMI	61
8.7	TURIZMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE.....	65
8.8	BUJQËSIA.....	73
8.9	PYLLTARIA	78
8.10	ENERGJI	84
8.11	UJI DHE KANALIZIMI	88
8.12	MENAXHIMI I MBETURINAVE	93
9.	DISPOZITAT E IMPLEMENTIMIT	101
9.1	UDHËZUES MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PZHK	101
9.2	KUSHTET MBI ÇËSHTJET QË JANË TË RËNDËSISHËMPËR PËRDORIMIN E TOKËS DHE ZHVILLIMIN	101

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

9.2.1	<i>Kushtet e përcaktimit të destinacionit të zonave në territorin e komunës.....</i>	101
9.2.2	<i>Kushtet për rregullimin e hapësirës.....</i>	101
9.2.3	<i>Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike</i>	102
9.2.4	<i>Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike</i>	103
9.2.5	<i>Kushte për vendosjen e korridoreve ose shtigjeve, zonave të komunikimit dhe sistemet e tjera infrastrukturore</i>	103
9.2.6	<i>Masat për mbrojtjen e peizazhit, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike</i>	104
9.2.7	<i>Mjetet për trajtimin e mbeturinave.....</i>	105
9.2.8	<i>Masat për parandalimin e ndikimeve të dëmshme për mjedisin</i>	106
9.2.9	<i>Masat për parandalimin e ndikimit negativ social.....</i>	106
9.2.10	<i>Masat e implementimit të Planit.....</i>	107
9.3	DISPOZITAT LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN	107
9.4	DISPOZITAT E RADHITJES KRONOLOGJIKE	108
9.5	ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTEJSHËM	108
9.6	PLANI I VEPRIMIT AFATMESËM 2013-2016 (26 KORRIK 2013 FAZA I	110
9.6.1	<i>EKIPA KOMUNALE PËR ZBATIM, MONITORIM DHE VLERËSIM (EKZMV)</i>	115
9.7	DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	115

5. Vizioni, parimet e përgjithshme dhe synimet

5.1 Vizioni

Qëllimi i vizionit është të formulojë imazhin e të ardhmes dhe një model që Dragashi duhet të arrijë gjatë viteve të ardhme. Imazhi përmban çështjen kryesore dhe qëllimet e zhvillimit të pandikuar nga faktorët e jashtëm. Këto janë përfshirë në hapin tjetër (skenarët, shih Kapitullin 6).

Si hap i parë për pjesëmarrje, Punëtorja e Vizionit për Planin Zhvillimor Komunal është mbajtur më 5-8 shtator, 2011. 40 qytetarë nga 18 fshatra të Dragashit dhe 17 anëtarë të UNDP-së dhe të MMPH kanë punuar bashkë për krijimin e një draft vizioni për komunën e Dragashit për të ofruar përkrahje dhe udhëzime për PZHK. Pjesëmarrësit ishin anëtarë nga Asambleja Komunale, Grupi Punues Komunal, Grupet Punuese të Fshatrave dhe anëtarë të shoqërisë civile. Objektivat kryesore të Punëtorisë së Vizionit ishin të rritet pronësia e shoqërisë civile, sektorit privat, dhe e komunës në Planin Zhvillimor Komunal dhe për të forcuar dialogun dhe bashkëpunimin mes aktorëve dhe pjesëmarrësve të ndryshëm.

Në një prezantim në qershor të vitit 2012 ky draft vizion u ishte prezantuar anëtarëve të Grupit Punues Komunal dhe ishte konfirmuar nga ky grup.

Në shtator të vitit 2012 një punëtori tjetër do të mbahet me anëtarët e Asamblesë Komunale. Ata do të kenë rastin të adresojnë idetë e tyre, dëshirat dhe brengat lidhur me zhvillimin e ardhshëm të Dragashit dhe të aprovojnë apo amendojnë draftin e vizionit.

Drafti aktual i vizionit i formuluar nga grupet punuese është si në vijim:

Dragashi prezanton dhe i ruan traditat.

Porta jugore e parkut nacional Malet e Sharrit me biodiversitet të pasur, infrastrukturë kryevepër me shkalë të duhur, ekonomi të qëndrueshme, burime ekologjike të shfrytëzueshme dhe bio-prodhime të cilësisë së lartë, është një vend ku çdonjëri dëshiron të vijë dhe të pushojë në natyrën e bukur dhe të pastër. Trashëgimia e pasur kulturore dhe popullata e gatshme të mirëpresë mysafirët dhe ushqimi vendor i tërheqin vizitorët vendor dhe ndërkombëtar.

Brenda analizës për PZHK, temat kryesore janë nënvizuar. Rezultatet janë përshkruar në Kapitujt 2 deri 4. Këto rezultate e vërtetojnë draft vizionin e formuluar nga punëtorja mbi vizionin. Vizioni i adreson natyrën dhe biodiversitetin e pasur, trashëgiminë kulturore dhe traditat, popullin e Dragashit dhe sektorët që duhet zhvilluar: turizmi, produktet e qëndrueshme vendore, parku nacional, dhe në mënyrë të tërthortë infrastrukturën e nevojshme. Këto aspekte që mund të konsiderohen si fuqitë më të mëdha shërbejnë si bazë për vizionin.

Vizioni përputhet me planet dhe politikat kombëtare, posaçërisht me Planin Hapësinor të Kosovës.

5.2 Parimet e përgjithshme dhe synimet

5.2.1 Parimet e përgjithshme

Parimet prezantojnë vlerat e propozuara dhe të miratuara që duhet të respektohen në të ardhmen. Rregullimi hapësinor plod të bazohet në këto parime për sa i përket Planit Hapësinor të Kosovës:

- PZHK përkrah parimin e ruajtjes së burimeve natyrore dhe përkrah zhvillimin e qëndrueshëm;
- PZHK përkrah parimin e qasjes së integruar, përfshirë këtu edhe elemente të infrastrukturës dhe transportit; zhvillimin ekonomik, social dhe të mjedisit, dhe politika të tjera strategjike për komunën;
- PZHK promovon zhvillimin e barabartë dhe të harmonizuar në mbarë territorin e Dragashit.
- PZHK inkurajon procesin demokratik të pjesëmarrjes dhe interesat e përbashkëta të banorëve të Dragashit, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetesës dhe mirëqenies sociale;
- PZHK promovon një ekonomi stabile që do të krijojë mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës për të gjithë banorët e Dragashit, me të drejta të barabarta për të gjithë;
- PZHK ruan traditat dhe identitetin kulturor të Opojës dhe rajoneve të Gorës;
- PZHK bazohet në parimin e ofrimit të qasjes në arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera sociale për të gjithë banorët;
- PZHK promovon zhvillimin ekonomik në fushën e bujqësisë dhe sektorit të shërbimeve duke shtuar njohuritë dhe asociacionet;
- PZHK përbush largësinë e Dragashit, në bazë të parimit të partneritetit dhe bashkëpunimit ndërkomunal dhe në kontekst më të gjerë gjithashtu, me qëllim të mbrojtjes, përdorimit racional të burimeve ekzistuese të cilat i takojnë komunitetit, dhe duke përfituar nga projektet e përbashkëta.

5.2.2 Synimet afatgjata të zhvillimit

Përkufizimi i synimeve dhe objektivave të zhvillimit bëhet në përputhje me Vizionin. PZHK përcakton synimet afatgjata sipas temave, në bazë të pikave të forta dhe të dobëta, si dhe duke marrë parasysh mundësitë potenciale të zhvillimit dhe sfidat e zhvillimit.

PZHK ka marrë parasysh edhe rekomandimet e veçanta nga Planifikimi Hapësinor i Kosovës për “Zonën portokalli”, pjesë e së cilës është edhe Dragashi pjesërisht, të cilat fokusohen në:

- Zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike
- Zhvillimin e një rrjeti atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisjen e shërbimeve publike në favor të qytetarëve, me cilësi të përmirësuar jetese për qytetarët, punësim dhe barazi sociale
- Zhvillimi i bujqësisë
- Programi ZHEL (zhvillimi ekonomik lokal) me promovimin e NVM (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme)
- Zhvillimi i infrastrukturës rajonale
- Zhvillimi i turizmit malor dhe kulturor, mbrojtja e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike

Biodiversiteti dhe Ruajtja e Natyrës

Mbrojtja, ruajtja dhe rehabilitimi i biodiversitetit të pasur të florës dhe faunës të Komunës

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

- Mbrojtja e trupave të ujit, pyjeve, kullotave dhe formacioneve shkëmbore me biodiversitet të veçantë.
- Bashkëpunimi me Parkun Nacional Mali Sharr.
- Parandalimi i ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe peizazhit.
- Sigurimi dhe zhvillimi bashkëpunimit ndërkufitar me iRJM dhe Shqipërinë, në aspekt të përpjekjeve të përbashkëta për mbrojtjen e biodiversitetit, hulumtimit dhe eko-turizmit .

Vendbanimet

Promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të vendbanimeve në mënyrë të rregulluar. Ruajtja e karakterit dhe bukurisë individuale të vendbanimeve dhe peisazhit përreth.

- Regullimi i aktiviteteve në vendbanimet private do të shpiejë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të fshatrave.
- Të gjitha fshatrat do të kenë zona për zhvillimin e ndjeshëm të zonave të banimit.
- Mjedi do të mbrohet nga ndikimet e vendbanimit.
- Do të mbrohet karakteri individual dhe identiteti i fshatrave; ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore.
- Përmirësimi i projektimit të hapësirës publike në fshatra.
- Mbrojtja e banorëve nga rreziqet natyrore si orteqet, rënia e shkëmbijve dhe vërshimet.

Ekonomia vendore

Përmirësimi i performancës ekonomike të sistemit komunal, kryesisht për sa i përket punësimit dhe pagave të popullsisë. Valorizimi i burimeve vendore, organizimi sipas zinxhirit të vlerave, dhe modernizimi i kapaciteteve, duke ruajtur një mjedis të qëndrueshëm afatgjatë, dhe barazi sociale dhe gjinore.

- Krijimi i qeverisjes së shëndoshë të sistemit ekonomik.
- Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrenca e zinxhirit të vlerave.
- Krijimi i sistemit për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për ndërmarrësit, prodhuesit, popullsinë, organizatat e shoqërisë civile, dhe institucionet publike.
- Realizimi dhe implementimi i marketingut të efektshëm territorial.
- Përmirësimi i kapaciteteve në planifikimin e zhvillimit ekonomik.
- Dinamika productive endogjene do të jetë pjesa kryesore e sektorit ekonomike të Dragashit.

Infrastruktura rrugore dhe transporti

Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe transportit publik si çels për tejkalimin e largësisë gjeografike të Dragashit si tërësi dhe të fshatrave të tij. Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe mbrojtja e mjedisit si çështje kyçe e zhvillimit të qëndrueshëm. Rrjeti i përmirësuar i rrugëve vendore do të ofrojë qasje të shpejtë, të sigurtë dhe të besueshme në të gjitha fshatrat.

- Rrjeti rrugor dhe transporti publik drejt Prizrenit se qendër rajonale, si dhe lidhja drejt Shqipërisë dhe iRJM, do të forcohet.
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrugëve do të sigurojë se investimet janë afatgjata dhe të qëndrueshme.
- Proceset e planifikimit dhe vendim-marrjes për projektet rrugore përfshijnë analizat e ndikimit të mjedisit dhe përputhen me Parkun Nacional.

Shëndetësia dhe mbrojtja civile

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Efikasiteti i sistemit të njësive shëndetësore për të mundësuar furnizimin efikas mjekësor. Shëndeti dhe mjetet e jetesës do të përmirësohen me pajime moderne dhe mbrojtje të organizuar civile.

- Përmirësimi i aftësive, motivacionit dhe rritja e numrit të personelit mjekësor.
- Azhurnimi i pajisjeve teknike dhe fizike.
- Nxitja e informatave që kanë të bëjnë me temat e higjienës dhe shëndetit.

Arsimi

Rritja e nivelit arsimor në Dragash. Sigurimi i arsimit të vazhdueshëm dhe aftësive të punës për meshkujt dhe femrat, pavarësisht nga sfondi financiar, social ose etnik.

- Inkurajimi i qasjes në nivele më të larta të arsimit për djemtë dhe vajzat.
- Rritja e mundësive profesionale për të rriturit, duke përfshirë meshkujt, femrat, të papunët dhe personat me kualifikime të ulëta.
- Arsimimi do të përmbajë çështjet aktuale (shëndetësi, trashëgimi kulturore, energji, ndotje të mjedisit).
- Krijimi i institucioneve parashkollore për të liruar prindërit dhe përgatitjen e fëmijëve për në shkollë.

Trashëgimia Turistike dhe Kulturore

Mbrojtja e aseteve natyrore dhe “origjinalitetit të bazuar në vend” në çdo pjesë të Komunës. Vetëdijësimi i brendshëm dhe i jashtëm për bukuritë e Dragashit, si faktor kyç për zhvillimin ekonomik. Realizimi dhe mirëmbajtja e inventarit të aseteve të trashëgimisë kulturore, dhe masat aktive për mbrojtjen, ruajtjen dhe rehabilitimin e trashëgimisë.

- Implementimi i infrastrukturës turistike njerëzore dhe fizike.
- Zhvillimi turistik do të përfshijë karakteristikat ekzistuese dhe do të zbulojë fusha të reja.
- Qyteti i Dragashit do të veprojë si një “kamp turistik”.
- Plani i Menaxhimit të Parkut Nacional do të përfshijë elemente të infrastrukturës turistike dhe do të përkrahë realizimin e saj.
- Vetëdijësimi i popullsisë për trashëgiminë kulturore dhe natyrore.
- Ruajtja e trashëgimisë të prekshme dhe të paprekshme kulturore në bazë të hulumtimit profesional dhe praktikës më të mirë ndërkombëtare.
- Komunitetet lokale commando të jenë të angazhuara në mënyrë aktive në hartimin dhe zbatimin e strategjive të turizmit kulturor dhe natyror

Bujqësia

Përmirësimi i performancës së sistemeve bujqësore dhe blegtorale. Nxitja e përmirësimit dhe përdorimit të burimeve vendore në përputhje me mjedisin, organizimi i tyre në zinxhirë të vlerës, dhe përmirësimi i kapaciteteve të konkurrencës duke ruajtur qëndrueshmërinë afatgjate të mjedisit dhe barazisë sociale dhe gjinore.

- Krijimi i qeverisjes së shëndoshë të sistemeve bujqësore dhe blegtorale
- Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrenca e zinxhirëve të vlerës.
- Përmirësimi i përpunimit, cilësisë dhe marketingut të produkteve bujqësore.
- Krijimi i të ardhurave shtesë për bujqit dhe banorët ruralë, sidomos për femrat, që çon në përmirësimin e standardeve të jetesës dhe kushteve të punës në zonat rurale.

Pylltaria

Ruajtja dhe zgjerimi i zonës pyjore ekzistuese dhe përmirësimi i menaxhimit të saj për të shtuar prodhimin. Zvogëlimi i rreziqeve nga ortekët, erozioni dhe rrëshkitjet e tokës me pyllëzimin e zonave të rrëpinjta. Përmirësimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm, kontrollit të zjarrit dhe procedurave dhe masave zjarrfikëse.

- Përkrahje të vazhdueshme qeverisjes të sistemit përkatës të pylltarisë.
- Përkrahje në certifikimin e pyjeve publike sipas standardeve të KMP-së.
- Rritja e zonës pyjore në tokat e braktisura dhe në zonat e rrëpinjta që nuk janë të përshtatshme për prodhimin bujqësor.
- Rritja e qëndrueshme prerjes legale të drunjve të zjarrit dhe drunjve teknik që do të ndihmojnë në përmirësimin e strukturës aktuale të pyjeve dhe do të shtojë të hyrat vetanake për buxhetin komunal.
- Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve publike.
- Rritja e vetëdijes për rrezikun nga zjarret.

Energjia

Nxitja e furnizimit me energji elektrike, përdorimin e energjisë termike dhe masat për përmirësimin e efikasitetit energjetik në sektorin publik dhe privat të Komunës së Dragashit. Përdorimi i potencialit për prodhimin e energjisë elektrike në bazë të Teknologjive për Energji Ripërtëritëse (TER) për rritjen e furnizimit lokal me energji elektrike, përkrahja e ekonomisë vendore dhe shamnja e ndikimeve negative në mjedis, duke përfshirë dëmtimin e habitateve nëpër lumenj dhe dëmtimin e biodiversitetit.

- Nxitja e furnizimit të sigurtë dhe të besueshëm me energji elektrike, ekologjikisht të shëndoshë dhe cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit në komunë.
- Përfshirja e TER në përzierjen energjetike të komunës.
- Nxitja e iniciativave të ndërmarrësve ndërkombëtarë apo vendorë dhe ndërmarrjeve ose konsorciumeve që investojnë në kapacitetet që kanë të bëjnë me prodhimin e energjisë.
- Nxitja e efikasitetit energjetik nëpër amvisëri dhe objektet publike.
- Strategjia Komunale e Energjisë do të inkurajojë kompanitë vendore dhe ndërkombëtare të përfshijnë burimet vendore dhe fuqinë lokale të punës në planet e tyre të biznesit, në mënyrë që të përkrahin zhvillimin komunal.

Uji dhe Kanalizimi

Mbrojtja e cilësisë së ujit të pijshëm dhe burimeve të ujit. Zvogëlimi i humbjeve në sistemet e distribuimit të ujit të pijshëm dhe ofrimi i shërbimeve të përshtatshme të ujit dhe kanalizimit për qytetarët e komunës me tarifa të pranueshme. Të gjitha shtëpitë, madje edhe ato që nuk janë të banuara gjatë dimrit, do të lidhen me sistemet e ujit dhe ujërave të zeza.

- Krijimi i funksionimit të shëndoshë të sistemeve të ujit dhe ujërave të zeza në bazë të objekteve ekzistuese infrastrukturore, zgjerimi i sistemit dhe mirëmbajtja parandaluese.
- Arritja e pranimit të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, në bazë të parimeve ekonomike si zgjidhja e vetme e qëndrueshme.
- Përmirësimi i performancës ekonomike të ofrimit të shërbimeve ekzistuese të ujit dhe kanalizimit.
- Promovimi i imazhit territorial në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe tërheqja që burimet e jashtme të përdoren në mënyrë koherente me udhëzimet e përbashkëta strategjike.

5.3 Prioritetet strategjike

1. Prioritet shumë i lartë

Zhvillimi i qëndrueshëm është parimi themelor dhe çështja kryesore prioritare e zhvillimit komunal në Dragash. Kjo përbëhet nga mbrojtja e mjedisit dhe duke marrë parasysh aspektet ekonomike në zhvillimin e mjeteve të jetesës dhe infrastrukturës. Zhvillimi ekonomik është themeli i zhvillimit të fushave të tjera, por nuk guxon të shkatërrojë burimet natyrore të Dragashit. Një tendencë strategjike për zhvillimin në çdo fushë është të mundësohen mediat moderne (sidomos interneti) për të tejkaluar pengesën e Komunës së Dragashit që përbëhet nga 36 fshatra të shpërndara.

2. Prioritet i lartë

Prioriteti i lartë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor vlen për:

- Sigurimin e infrastrukturës teknike për rritjen e mundësive të jetesës dhe për të mundësuar turizmin.
- Sigurimi i infrastrukturës fizike për të lehtësuar qasjen në Dragash dhe përforcimin e lidhjeve jashtë vendit.
- Mbrojtja e tokës së lërueshme dhe shfrytëzimi i saj racional.
- Përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike, me theks të veçantë në punësim
- Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike, sidomos në zonat malore.
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe traditave.
- Rritja e bashkëpunimit ndër-komunal dhe ndër-shtetëor.

3. Prioritet i mesëm

Objektivat në vijim janë për:

- Krijimin e hapësirave publike dhe themelimin e objekteve publike, të cilat do të ofrojnë kushte më të mira jetese.
- Përmirësimin e transportit publik për të ndihmuar banorët, për të lehtësuar qasjen turistike dhe për të zvogëluar nevojën e automjeteve.
- Zvogëlimin e varësisë nga furnizimi nacional i energjisë, me zhvillimin e teknologjisë për energji ripërtëritëse dhe prodhim të energjisë përbrenda komunës.

6. Skenarët

Skenari teknik është një metodë e planifikimit strategjik, e cila përdoret edhe në politikë edhe në ekonomi. Qëllimi i këtij skenari është të analizojë zhvillimet e mundshme në të ardhmen. Këtu përfshihen situatat e ardhshme alternative dhe shtegjet që çojnë drejt tyre. Skenarët bazohen në pasojat hipotetike të vendimeve dhe veprimeve të mundshme për vetëdijësimin lidhur me proceset e kauzale.

Përveç se janë treguar mundësitë e shfaqjes së një situatë hipotetike në të ardhmen, janë paraqitur edhe variacione dhe alternativa. Qëllimi kryesor është të nxirren në pah mundësitë dhe veprimet e nevojshme për të kontrolluar procesin.¹

Pikënisja e analizës së skenarit është përgjithësisht i ashtuquajtur "skenari i prirjes", i cili është i bazuar në një afat kohor. Kjo prirje përfaqëson skenarin e zhvillimit të ardhshëm nën supozimin e një mjedisi me zhvillim stabil. Mirëpo, është poashtu e nevojshme, nën supozimin e një mjedisi me zhvillim jostabil, që të merren parasysh aspektet pozitive dhe negative për zhvillim. Prandaj, duhet të analizohen faktorët relevantë, të cilët kanë ndikim kryesor në zhvillim.

6.1 Faktorët kryesorë për zhvillim

Për zhvillimin potencial të një komune rurale si Dragashi, faktorët në vijim duhet të merren parasysh si faktorët me ndikim kryesor:

- Ndryshimet e popullsisë.
- Konkurrenca ekonomike.
- Zhvillimi i përdorimit të tokës në përgjithësi.
- Zhvillimi i aktiviteteve në vendbanime.
- Niveli teknik dhe efikasiteti i infrastrukturës teknike.
- Niveli arsimor.
- Biodiversiteti.

Mundësia e kontrollimit dhe ndikimit të zhvillimit varet nga shkalla e gadishmërisë për bashkëpunojnë mes shoqërisë në përgjithësi dhe individëve, dhe gadishmërisë për të pranuar dhe respektuar rregullat.

Zhvillimi potencial i komunës poashtu ndikohet edhe nga zhvillimi në të kaluarën dhe nga gjendja e tanishme. Prirjet aktuale në Dragash, në fushat më relevante të zhvillimit janë:

- Në bazë të të dhënave të natalitetit dhe mortalitetit, zhvillimi natyror i popullsisë në Dragash është 1.13 % (2010). Prirja natyrore shënon një rënie të vogël në rritjen natyrore të popullsisë. Një faktor tjetër në ndryshimin e popullsisë është shpërngulja, gjë që po ndodh në Kosovë dhe në nivel ndërkombëtar. Bilanci i shpërnguljes së brendshme sipas komunave, tregon se gjatë disa viteve të fundit ka pasur rënie të rëndësishme të popullsisë të Dragashit. Shkalla e migrantëve të jashtëm (anëtar i mëparshëm i familjes që tani jeton jashtë vendit) nga Dragashi është rreth 25%. Nga ana tjetër, migracioni ndërkombëtar në Dragash ekziston (shkalla e migracionit > 10%). Sondazhet nacionale tregojnë se ndërsa ka prova të qarta për familjet që kthehen në Kosovë, vendi vazhdon të përballet me migracionin ndërkombëtar.

¹ www.wikipedia.com

Për një të kthyer, ka dy banorë që e lënë Kosovën për të jetuar jashtë.² Është e pamundur të parashikohet se cili nga këto efekte do të dominojë. Migracioni është fenomen që shkaktohet nga shumë faktorë dhe i nxitur sidomos nga faktorët ekonomikë, politikë dhe kulturorë. Është e mundshme që ndikimi i shpërnguljeve jashtë vendit do të varet nga përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe ekonomia e përgjithshme lokale, dhe sidomos në tregun e punës: nëse ka progres, shpërngulja jashtë vendit mund të ndalojë dhe popullsia mund të mbetet stabile ose madje edhe të rritet. Mirëpo, nëse nuk ka progres, shpërngulja jashtë vendit mund të ketë efekt më të fuqishëm se rritja natyrore e popullsisë dhe tendenca aktuale e humbjes së popullsisë mund të vazhdojë.

- Situata e komunës tregon konkurrencë të dobët ekonomike dhe probleme për hyrjen në tregje të reja. Ekonomia e Dragashit është dominuar nga një ndërmarrje e madhe dhe pronë e vetme sociale, ndërmarrja e prodhimeve bujqësore Sharprodhimi, e cila është e konfiskuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Nuk ekziston asnjë iniciativë private për t'u kthyer në tregun e Sharprodhimit.
- Një faktor relevant i të ardhurave janë dërgesat nga diaspora, të cilat përkrahin qytetarët e komunës por gjithashtu krijojnë varësi.
- Ekziston një zonë e konsiderueshme e tokës së lëvrueshme që është lënë e djerrë dhe një zvogëlim i jashtëzakonshëm i numrit të bagëtive, e cila ka të bëjë me mungesën e përfitimit në bujqësi dhe blegtori. Kjo ka të bëjë me mungesën e njohurisë, të dhënave, menaxhimit dhe furnizimit teknik. Menaxhimi i gabuar dhe degradimi gjithashtu është duke ndodhur në fushën e pylltarisë. Niveli i ulët i degradimit është e pranishme tek pyjet sidomos në zonën kufitare me Shqipërinë.
- Zgjerimi i pakontrolluar i zonave të banimit, i shkaktuar nga mungesa e qeverisjes, rrezikon mjedisin dhe pengon furnizimin e duhur teknik.
- Niveli i infrastrukturës teknike është i ulët, kryesisht për shkak të mirëmbajtjes së ulët dhe mungesës së ndërgjegjesimit.
- Niveli i arsimit fillor dhe të mesëm është në rritje e sipër; mirëpo, arsimi profesional ende mungon.
- Vlera e lartë e biodiversitetit në Dragash ka evoluar me peisazhin e vet të gjerë dhe të paprekur. Megjithatë, në disa raste habitatet speciale të florës dhe faunës nga ndikimi i veprimtarisë të njeriut kane ndryshuar, siç është zgjerimin e kullotave në zonat malore. Degradimi i filluar i bagëtisë dhe bujqësisë në disa raste shkakton humbjen e biodiversitetit.

Gjatë dekadave të fundit, Kosova ka pasur një histori të vështirë që ka shkaktuar shumë ndryshime dhe faza të turbullta të udhëheqjes në mbarë vendin dhe në disa rajone. Si rrjedhojë, gadishmëria për të bashkëpunuar, për të pranuar dhe respektuar rregullat nuk është shumë e zhvilluar brenda shoqërisë, madje edhe në Dragash. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së vazhdueshme të komunikimit dhe zbatimit të rregullave nga administrata. Ekzistonn edhe një mungesë e vetëdijes në mesin e qytetarëve.

6.2 Skenari i prirjeve

Nëse këto prirje që kanë ndodhur në vitet e fundit do të vazhdojnë dhe do ta përcaktojnë të ardhmen, zhvillimi i Dragashit do të vazhdojë ngadalë dhe disa mangësi.

² Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011, Njerëzit në lëvizje – një analizë e lëvizshmërisë ndërkombëtare, nacionale dhe lokale të njerëzve të Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, gusht 2012.

Shpërngulja do të vazhdojë nëse perspektivat ekonomike nuk do të përmirësohen gjatë viteve të ardhshme. Mirëpo zhvillimi ekonomik do të ndodhë me hapa të ngadalshëm, i shpërndarë në komunë, pa mundësi për të hyrë në tregje të reja dhe për të shtuar shkallën e punësimit. Në fushën e bujqësisë zvogëlimi i bagëtive dhe degradimi i menaxhimit të përdorimit të tokës do të ndikojë që njerëzit të braktisin punën e vështirë bujqësore dhe do të shpërngulen në qytet ose jashtë vendit. Konkurrenca nuk do të arrihet në mbarë Komunën, më së shumti në disa fshatra. Nëse nuk ka rregullore, humbja e përdorimit tradicional të tokës bujqësore dhe trashëgimisë kulturore do të vazhdojë. Zgjerimi i pakontrolluar i venbanimeve përgjat rrugëve do të trazojë modelet tradicionale të vendbanimit; zgjerimi drejt zonave me rrezik të lartë, me produktivitet të lartë ose me vlerë biodiversiteti, do të rrezikojë jetën dhe shëndetin dhe do të shkatërrojë burimet natyrore për zhvillim të suksesshëm. Situata e keqe fizike e infrastrukturës ekzistuese teknike dhe mungesa e mirëmbajtjes nuk do të ndryshojnë. Hedhja e pamenduar e mbeturinave të ngurta dhe ujërat e zeza shkaktojnë ndotjen e mjedisit edhe më tej. Qeveria/komuna luan rol të dobët në procesin e zhvillimit. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për lidhjen kauzale dhe veprimet dhe gadishmëria e tyre për të respektuar rregullat do të mungojë edhe më tej.

6.3 Mjetet e përmirësimit

Prirjet nuk mund të ndryshohen shumë lehtë. Shtegjet që shpiejnë drejt situatave alternative në të ardhmen fillojnë me situatën aktuale dhe disa vendime dhe veprime. Por në disa fusha nuk ka mjete për të ndryshuar realitetin.

Në Dragash, mjetet dhe çështjet në vijim janë të rëndësishme për të arritur një të ardhme alternative:

- Transferimi i njohurive: në shumë fusha relevante, ekzistojnë teknika ose praktika më të mira në dispozicion. Transferimi i njohurisë mund të përmirësojë konkurrencën e aktiviteteve ekonomike dhe rezultatet e prodhimit bujqësor dhe industrial.
- Trajnimi profesional për personelin komunal në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe administrimit shton ndërgjegjësimin dhe kuptimin në nivel administrativ
- Transferimi i mjeteve financiare: Kosova në tërësi dhe Dragashi në veçanti pranojnë një vlerë të madhe të të ardhurave nga diaspora dhe grantet nga komuniteti ndërkombëtar.
- Përshtatja e organizimit dhe strukturës komunale, dhe zhvillimi i kapaciteteve çojnë drejt përdorimit më të mirë të resurseve
- Mirëmbajtja e përmirësuar e rrugëve dhe infrastrukturës teknike mundëson që investimet të zgjasin më shumë
- Investimi i projekteve për planifikimin strategjik dhe konceptet e qëndrueshmërisë garantojnë sukses dhe përmirësim të situatës
- Bashkëpunimi social: përfshirja e hershme e qytetarëve krijon angazhimin aktiv dhe shton gadishmërinë për të pranuar rregulloret.

6.4 Skenari më i mirë

Nëse këto mjete mund të shfrytëzohen, zhvillimi i Dragashit do të arrijë vizionin e formuluar, të ruajë biodiversitetin e vet të pasur, të koncentrohet në ekonominë e qëndrueshme dhe bio-produktet, si dhe në rritjen e turizmit.

Migracioni do të shënojë ulje, nëse në vitet e ardhshme rriten perspektivat ekonomike dhe mjetet e jetesës. Shoqata e operatorëve ekonomikë do të përforcojë konkurrencën ekonomike dhe do të mundësojë hyrjen në tregjet e reja. Zhvillimi ekonomik financohet për qëndrueshmëri dhe vendoset në zona të zgjedhura, të cilat janë të përcaktuara për tregti dhe turizëm. Në këtë mënyrë do të

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

mbështetet i tërë territory i komunës. Shoqatat dhe investimet në fushën e bujqësisë lehtësojnë punën e vështirë dhe transferimin e njohurive për të përmirësuar menaxhimin e përdorimit të tokës. Ky menaxhim do të orientohet në aspektet e mjedisit dhe ruajtjen e përdorimit tradicional të tokës. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe traditave do të jenë një çështje e rëndësishme brenda shoqërisë dhe do të ruajnë identitetin social. Përveç ruajtjes së objekteve historike, modernizimi i vendbanimeve dhe zgjerimi do të orientohen në bazë të rregulloreve të menduara mirë. Këtu do të merren parasysh zonat me rreziqe të larta (ortekë, vërshime) dhe toka e lëvrueshme ose biodiversiteti me cilësi të lartë. Problemet e situatës së vështirë fizike të infrastrukturës ekzistuese teknike do të zgjidhen me anë të mirëmbajtjes së rregullt dhe rritjes së qëllimshme. Roli i qeverisë/komunës, në procesin e zhvillimit është planifikimi, udhëheqja dhe bashkëpunimi. Pjesëmarrja e qytetarëve do të rrisë vetëdijen për lidhjen kauzale dhe gadishmërinë e tyre për të respektuar rregullat. Qytetarët do të marrin parasysh mjedisin në veprimet e tyre dhe do të zvogëlojnë ndotjen.

7. Korniza e Zhvillimit Hapësinor

Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar për zhvillimin hapësinor në Komunën e Dragashit. Ajo formulon strukturën dhe organizimin hapësinor për zhvillim të ardhshëm.

7.1 Harta e Kornizës Zhvillimore

Harta e Kornizës Zhvillimore tregon elementet qendrore të zhvillimit hapësinor.




Figura 1: Harta e Kornizës Zhvillimore

7.2 Parimet për zhvillimin funksional të vendbanimeve

Struktura e zhvillimit urban të Dragashit historikisht është ngritur mbi kushtet e ndryshme kulturore, ekonomike dhe natyrore. Shkaku i gjendjes së tij gjeografike dhe topografike, komuna përbëhet nga 36 fshatra, të cilat dallojnë për nga lokacioni dhe lartësia mbidetare, madhësia dhe zhvillimi demografik, tregui punësimit dhe objektet infrastrukturore. Si pasojë e parakushteve kushtetuese, vendbanimet përmbushin funksione të ndryshme brenda rrjetit shoqëror, kulturor dhe ekonomik. Zhvillimi i mëtutjeshëm duhet të sigurojë jetesë të mirë në mbarë Komunën dhe në çdo nënzonë. Kushtet e barabarta dhe të mira të jetesës dhe punës duhet të arrihen dhe të ruhen në çdo pjesë të Komunës. Ruajtja dhe arritja e efikasitetit në nënzonat e Dragashit, sigurimi i aktivizimit dhe promovimit të zhvillimit të vazhdueshëm të potencialit ekzistues endogjen është thelbësorë. Prandaj një menaxhim efikas i hapsirës është i duhur për vëzhgimin dhe rritjen e sigurisë së hapsirave të ndryshme të strukturuar.

Parimi i përgjithshëm mbështet shpërndarjen ekzistuese hapsinore të funksioneve të vendbanimeve sipas Teorisë së Vendeve Qendrore nga Walter Christaller.

Teoria e Vendeve Qendrore, e formuar në vitin 1930, vazhdon të jetë aktuale dhe shpesh përdoret për planifikim hapsinorë në Evropë. Koncepti është, të ndërtohet një strukturë e vendeve qendrore të nivele të ndryshme hierarkike. Varësisht nga niveli u tyre hierarkik, vendet qendrore bartin lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve publike. Grumbullimet e mëdha përmbajnë shumë e më shumë ndërtime të caktuara sesa vendet e hierarkisë më të ulët.

Një sistem hierarkik i funksioneve të vendbanimeve duhet të garantojë kushte të barabarta, të mira të jetesës dhe punës në çdo pjesë të Komunës. Sipas dendësisë së popullatës, llojit dhe strukturës së tregut të punës, paisjeve infrastrukturore dhe parakushteve kushtetuese, zhvillimi dhe struktura e ardhshme ndryshon brenda fshatrave të Dragashit. Përmes avancimit të balancuar dhe të planifikuar, burimet e kufizuara financiare të komunës mund të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe zhvillimin ekonomik. Parimi i përgjithshëm është i ngjashëm me konceptin nacional për zhvillim hapsinorë, i cili karakterizon qendrat e mëdha dhe të vogla, zonat e zhvillimit ekonomik dhe të interesit të veçantë. Në nivelin e komunës, qendër komunale është qyteti i Dragashit, i cili bëhet një grumbullim urban që vepron si bazë ekonomike, turistike, kulturore, edukative dhe shendetësore i cili mbështet tërë komunën. Për më tepër, nënqendrat e shpërndara në tërë komunën veprojnë si qendra më të vogla të cilat ofrojnë shërbime të nevojshme publike tej-lokale për kërkesat e shtuara. Zonat e zhvillimit ekonomik në Dragash gjenden në qytetin e Dragashit dhe në nënqendra. Zonat me interes të veçantë ndërldihen me turizëm si çështje kryesore në zhvillimin e Dragashit dhe mjedisit endemik. Një mjedis i përshtatshëm, i mbrojtur dhe i ruajtur nga qytetarët është bazë primare e vlerës endemike dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të Dragashit. Mjedisi do të mbrohet dhe promovohet nga Parku i propozuar Kombëtar i Sharrit dhe do t'i shtojë vlerën komunës, Kosovës dhe Evropës.

Dragashi si qendër komunale duhet të ofrojë shërbime dhe furnizime për tërë komunën në nivelin më të mirë të mundshëm

Qyteti i Dragashit si qendër komunale duhet të veprojë si mbajtës i ritmit, lokacion i aftë biznesi, qendër e edukimit dhe mirëqenjes si dhe zonë e këndshme për të jetuar. Përveç konsolidimit të funksionit qendrorë të qytetit të Dragashit, zhvillimi hapsinorë i nënzoneve tjera në komunë është gjithashtu i rëndësishëm. Grumbullimi urban i qytetit të Dragashit dhe zonave rrethuese rurale duhet të komplimentojnë njëra tjetrën dhe t'i dhurojnë pronat e tyre specifike hapsinore zhvillimit të vazhdueshëm. Fitimi dhe shpenzimi duhet të balancohet në zhvillimin hapsinor të komunës. Prandaj duhet të krijohen nënqendrat të cilat veprojnë si gjeneratorë shtytës për zonat rurale, të cilat ofrojnë ca autonomi dhe kushte të krahasueshme jetese dhe pune.

Funksionet e qendrës komunale:

- Qendër administrative
- Të siguroj edukim të përmirësuar në shkollat e mesme dhe trajnime profesionale për meshkuj dhe femra
- Të siguroj që qendra e mjekësisë familjare të ofrojë shërbimet më të larta mjekësore në komunë
- Dyqane të specializuara (p.sh. veshëmbathje, paisje mekanike, elektroteknikë) që kënaqin “kërkesat periodike” duhet të gjenden në qytetin e Dragashit
- Ndërmarrjet e reja industriale duhet të vendosen në zonën tregëtare të qytetit të Dragashit
- Duhet të përgatitet zgjerimi urban i objekteve të banimit, zonave tregëtare
- Mbushja dhe zgjerimi urban i qytetit të Dragashit do të bëjë që vendbanimet Shajne dhe Lubovishtë të bëhen periferi
- Përmirësimi i infrastrukturës (uji, kanalizimi, mbeturinat,...) në një nivel më të lartë
- Përmirësimi i transportit publik drejt Prizrenit dhe drejt nënqendrave

Nënqendrat duhet të ofrojnë kushte të mira të jetesës dhe të furnizohen nga fshatrat e afërta

Zgjedhja e fshatrave që të veprojnë si nënqendra duhet të bazohet në strukturën ekzistuese të vendbanimit dhe në parakushtet kushtetuese. Indikatorët për përzgjedhjen e nënqendrave janë popullata dhe numri i shtëpive, një popullatë dhe shtëpi që kanë shënuar rritje që nga viti 1981 si dhe një infrastrukturë e mirë shoqërore dhe teknike. Nënqendrat janë të pajisura me shkolla kryesore, qendra të mjekësisë familjare, kanë qasje të mirë rrugore dhe të cilat tanimë janë nënqendra ekonomike ose kanë më shumë se 50 biznese. Një tjetër aspekt i rëndësishëm për përzgjedhjen e nënqendrave, bazuar në parimin e balancit hapësinor (gjithpërfshirës në hapësirë dhe ofrim të shërbimeve tërësore publike në distancë të arsyeshme), është vendndodhja e tyre në Dragash. Parimi i përgjithshëm identifikon Blaçin, Bellobraden, Bresanën, Breznen, Brodin, Rapçën dhe Restelicën si nënqendra.

Funksionet e nënqendrave:

- Të ofrojnë shkollim për klasat 1-9, (shkolla fillore)
- Qendra mjekësore familjare ofron shërbime bazike mjekësore dhe disa specialistë
- Dyqanet ofrojnë të mira të nevojshme (gjëra ushqimore, gazeta) të cilat kënaqin “kërkesat ditore”
- Ndërmarrjet vendosen në zonat e reja tregtare në nënqendra
- Përgatitja e zgjerimit të kontrolluar, posaçërisht për objektet e banimit
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike (uji, kanalizimi, mbeturinat,...)
- Lidhje të mira me rrjetin e rrugëve kryesore
- Transport publik drejt qytetit të Dragashit

Fshatrat duhet të ofrojnë kushte të mira të jetesës, të furnizuara nga qendra dhe nënqendrat

Shumica e vendbanimeve klasifikohen si fshatra (22 nga 36). Fshatrat do të zhvillohen në një mënyrë origjinale, të ruajnë karakterin e tyre tradicional gjersa të adaptohen me nevojat e jetës së sotme. Kjo përfshinë një përmirësim të infrastrukturës teknike. Për sa i përket infrastrukturës shoqërore (p.sh. në fushën e shërbimeve shëndetsore) por edhe sa i përket zhvillimit ekonomik ato përfitojnë nga qasja e mirë në nënqendrën e afërt dhe në qytetin e Dragashit si qendër komunale.

Funksionet e fshatrave:

- Të ofrojnë shkollim për klasat 1-5
- Të ofrojnë shërbime themelore mjekësore
- Zhvillim të rrallë ekonomik, kryesisht zhvillim bujqësor
- Përmirësim të infrastrukturës teknike (uji, kanalizimi, mbeturinat,...)
- Disa zgjerime në fushën e banimit

Fshatrat e largëta: qëllimi është në përkrahjen e njerëzve, jo vendit

Disa fshatra në Dragash karakterizohen me një numër të vogël të banorëve dhe një numër të vogël të shtëpive me tendenca dramatike të zvogëlimit që nga viti 1981 si dhe numër të vogël të nxënësve dhe bizneseve të vogla. Arsyeja kryesore për këtë situatë ka qenë pozita e largët gjeografike e këtyre fshatrave dhe një qasje tradicionalisht e keqe rrugore. Edhe nëse ndërkohë ka ndodhur ose do të ndodhë së shpejti një përmirësim i qasjes rrugore, pozita lart në male e këtyre fshatrave, larg nga rrugët kryesore dhe nga zonat e zhvilluara, me sa duket do të detyrojë rënie të mëtutjeshme. Shkaku i burimeve të vogla financiare, komuna nuk do të jetë në gjendje të ndalojë këtë proces ose të inicojë një kthesë domethënëse. Komuna duhet të garantojë kushte të mira të jetesës për banorët e fshatrave të largëta duke ofruar shërbime publike sa më larg që është e mundur në vetë fshatrat ose, nëse është e nevojshme, duke aranzhuar transport të sigurtë deri te objektet e shërbimeve publike në fshatrat tjera. Parimi i përgjithshëm identifikon si fshatra të largëta fshatrat Baçkë, Dikanc, Orçushë, Pllajnik dhe Xërxe.

Funksionet e fshatrave të largëta:

- Të ofrojnë shkollim për klasat 1-5 në fshat ose në fshatrat e afërta (duke përfshirë edhe sigurimin e transportit)
- Ofrimi i shërbimeve themelore mjeksore në fshatrat e afërta ose me ambulanta lëvizëse
- Zhvillim ekonomik vetëm në fushën e bujqësisë
- Përmirësimi i infrastrukturës themelore, implementim me priorite më të ulët
- Zgjerime të rralla në fushën e banimit

7.3 Funksionet shtesë të vendbanimit

Funksioni ekonomik

Përpos menaxhimit të shfrytëzimit të tokës, Komuna e Dragashit duhet të zhvillojë dhe shtojë sektorët tjerë ekonomik, p.sh. ndërtimtarinë, prodhimtarinë, tregtinë, akomodimin dhe sektorin e energjisë. Këto aktivitete duhet të zhvillohen në Fushën e Menaxhimit Intenziv; pjesërisht të zhvillohen në Fushat e Menaxhimit Gjithëpërfshirës. Ndërtimtarija ka të bëjë me zonat ekzistuese urbane dhe zgjerimin e vendbanimit. Zonat tregtare ekzistojnë afër qytetit të Dragashit, në Pllavë, Buçe dhe Buzez. Zonat e reja tregtare duhet të krijohen në Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne dhe Restelicë. Si rezultat, zona tregëtare do të ketë afër qytetit të Dragashit, në luginën e Opojës me qasje të mirë në Prizren dhe afër Restelicës me qasje të mire në IRJM (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë).

Funksioni Turistik

Turizmi i bazuar në natyrë duhet të zhvillohet në regjionin e Opojës dhe Gorës. Qendrat turistike janë vendbanimet që lidhen me shtigje këmbësorësh, zona të skijimit, vende për piknik, peisazhe të jashtëzakonshme dhe trashëgimi kulturore. Ato duhet të ofrojnë akomodim dhe informacione turistike. Vendbanimet e destinuara për t'u bërë qendra turistike janë Bellobrad, Bresanë, Brezne, Zaplluxhe, Brod, Rapçë, Radeshë, Restelicë dhe qyteti i Dragashit si bazë turistike. Në lidhje me qendrat turistike atje, zhvillohen zonat turistike.

7.4 Parimet e rrjetit rrugor

Përmirësimi i mëtutjeshëm i rrjetit rrugor dhe transportit publik është i nevojshëm për të mbuluar largësinë gjeografike të Dragashit në tërësi dhe të fshatrave të tij. Ajo do të përmirësoj jetesën, do të mbështesë ekonominë vendore duke ofruar qasje më të mirë në tregje dhe do të promovojë

turizmin. Më e rëndësishmja është të përmirësohet rrjeti rrugor regjional dhe tej-kufitar, posaçërisht drejt Prizrenit si qendër rajonale dhe drejt Shqipërisë dhe iRJM bazuar në lidhjet tradicionale dhe kulturore (historike). Në hartën e parimit themelor janë të përfshira rrugët më të rëndësishme regjionale dhe tej-kufitare. Propozimet për rrugë të reja, të cilat potencialisht do të jenë të rëndësishme së madhe, por të cilat kërkojnë studim të mëtutjeshëm, janë të shënuara me një vijë të ndërprerë.

7.5 Parimet për zhvillimin e shfrytëzimit të tokës

Parimi i përgjithshëm përveç rrjetit hierarkik të vendbanimeve gjithashtu merret me zhvillimin e konturës tokësore të Dragashit. Sipas vlerës së lartë të mjedisit të Dragashit, mbrojtja e biodiversitetit është njëri nga parimet kryesore të planit komunal për zhvillim. Menaxhimi i shfrytëzimit të tokës duhet të rritet duke u kujdesur për faktorët e mjedisit. Mbrojtja e ambientit në nivele të caktuara që kanë të bëjnë me pasuritë natyrore siguron zhvillim të vazhdueshëm dhe efikas. Do të duhej të jetë një zonë rreptësisht e mbrojtur në majë të malit Koritnik në veriperëndim dhe në malet në juglindje të Dragashit ku karakteristikave të jashtëzakonshme natyrore do të duhej t'u mungonin ndikimet njerëzore. Rajoni malor pasues i kësaj zone përmban biotope të veçanta që varen nga ndikime specifike njerëzore. Menaxhimi i gjerë i kullosave nuk është në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes por ruan shumëllojshmërinë biologjike. Pylltaria në këtë Zonë të Menaxhimit të Gjerë duhet të jetë në përputhshmëri me Standardet për Mbrojtjen e Pyjeve. Në luginën e Opojës dhe në luginën e Gorës ekzistojnë tokat më të përshtatshme, kështuqë do të duhej të jenë të mundshme kullosat intensive, kulturat e veçanta si dhe pylltaria produktive. Një ngritje e prodhimit të bujqësore dhe pyjore duhet të ndiqet në këtë Zonë të Menaxhimit Intenziv derisa aspektet ambientale të merren parasysh (p.sh. ruani pakëz hapësirë për lumenjtë).

Zonat Rreptësisht të Mbrojura: larg ndikimeve njerëzore

- Mbrojtja e ambientit është qëllimi i synuar
- Qasje vetëm për hulumtime
- Pa pylltari
- Pa bujqësi

Zonat e Menaxhuara Gjerësisht: mirëmbajtja përmes menaxhimit njerëzor

- Mbrojtja e ambientit është qëllimi themelor i synuar
- Qasja për arsye ekonomike dhe turistike është e mundshme përderisa mbrohet ambienti
- Pylltaria në pajtueshmëri me Këshillin Mbrojtës të Pyjeve
- Menaxhim i gjerë i kullosave duke u kujdesur për faktorët ambientalë

Zona e shfrytëzimit Intenziv të Tokës: shfrytëzimi produktiv i tokës krahas mbrojtjes së ambientit

- Mbrojtja e ambientit është një qëllim i synuar përpos prodhimit nga shfrytëzimi i tokës, zhvillimi komercial dhe turistik i vendbanimit
- Zona kryesore për jetesë dhe punë
- Pylltari produktive duke marrur parasysh aspektet
- Menaxhim intensiv i kullosave dhe kulturave të veçanta duke pasur në konsideratë aspektet mjedisore.
-

7.6 Funkcion shtesë në peizazhe: turizmi

Pasuritë e mëdha kulturore dhe turistike të Dragashit, mjedisi i tij natyror, shumëllojshmëria kulturore e banorëve, trashëgimia e prekshme dhe e paprekshme, ofrojnë mundësi të shumta për zhvillim turistik dhe ekonomik. Parku Nacional Malet e Sharrit në Dragash ofron rastin unik për të promovuar turizmin në komunë duke ofruar mundësi ambientale dhe kulturore, shpirtërore, shkencore, edukative, argëtuese për vizitorët.

Zonat kryesore turistike do të jenë lugina e Opojës (posaçërisht çiklizmi, ecja, udhëtimi me veturë) dhe Malet e Gorës afër Brodit dhe Restelicës (posaçërisht ecja, skijimi, vizitimi i Parkut Kombëtar). Një tjetër zone turistike mund të krijohet afër Zaplluxhes ku është i mundshëm skijimi. Planifikimi i detajuar i zhvillimit turistik në Dragash është i nevojshëm dhe do të konkretizohet në strategjinë e turizmit.

7.7 Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik dhe i mjedisit në kornizën e propozuar

I tërë PZHK dhe sidomos korniza për zhvillim hapësinor janë hartuar për ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të përdorimit të tokës. Prandaj, qëllimi i kornizës së propozuar zvogëlon ndikimet negative në mjedis, ekonomi dhe shoqëri. Pa marrë parasysh, Ligji i Planifikimit Hapësinor dhe Udhëzuesi për Planifikim Hapësinor, si dhe Ligji mbi Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (SEA) caktojnë hartimin e një vlerësimi të ndikimit të të gjitha planeve dhe programeve, të cilat ka gjasa të kenë efekte të rëndësishme për mjedisin.

Rezultatet e SEA janë se ndikimet e mjedisit në kornizën e zhvillimit hapësinor mund të priten nga zgjerimi i rrjetit rrugor dhe zhvillimi i zonave turistike për rrëshqitje me ski. Dimensionimi i ndikimeve të mjedisit nuk mund të vlerësohet në këtë nivel, por duhet të minimizohet anë të orientimit dhe pozicionimit. Ndikimet e mëtejshme të mjedisit me zhvillimin e përdorimit të tokës nuk priten për shkak se aspektet e mjedisit janë marrë parasysh sipas vendit dhe fushëveprimit. Përveç kësaj, korniza PZHK do të ketë efekt pozitiv dhe do të përmirësojë çështjet socio-ekonomike dhe ato të mjedisit në komunë.

8. Strategjitë

8.1 Biodiversiteti dhe Ruajtja e Natyrës

Qëllimet e përgjithshme
Mbrojtja, ruajtja (konservimi) dhe rehabilitimi i biodiversitetit të pasur të florës dhe faunës së komunës, sipas Ligjit të Ruajtjes së Natyrës dhe kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor, shoqëror dhe ekonomik të komunës.
Objektivat
<p>Themelimi i një qeverisjeje të shëndoshë të sistemit për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës për komunën, përmes ofrimit të ndihmës rrjeteve prej shumë niveleve, në nivel qeveritar (ndërmjet drejtorive komunale për ekonomi, bujqësi, arsim, etj), në nivel të shoqërisë civile (përmes shoqatave dhe ndërmjet shoqatave civile dhe institucioneve publike), në nivel ndër-komunal (në mes të komunave fqinje), në nivel vertikal (koordinimi me Qeverinë Kombëtare dhe institucionet e saj). Kjo përfshin në veçanti:</p> <ul style="list-style-type: none">• Mbrojtjen e ujërave të akumuluar, pyllit, gjelbërimeve dhe formacioneve shkëmbore, me vlera të veçanta të biodiversitetit në funksionet dhe shërbimet e tyre ekologjike, sipas Ligjit mbi Mbrojtjen e Natyrës (që do të thotë rezervë rigoroze natyrore/rezervat natyrore, zona speciale – Zonat Speciale të Mbrojtura dhe Zonat Speciale për Ruajtje, monumente natyrore dhe peisazhe të mbrojtura).• Bashkëpunimin me Drejtorinë për Parkun Nacional të Malit të Sharrit dhe Agjencinë Kosovare të Pyjeve lidhur me planifikimin, implementimin dhe fuqizimin e një Menaxhimi për Parqe Nacionale, me qëllim të ruajtjes së biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit (përfshirë funksionet e pyjeve për balancimin e ujit, ortekë, gërryerje dhe kontrollin nga rreziqet për rrëshqitje të dheut) të zonave të mbrojtura.• Parandalimin e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe natyrës përmes masave efektive të kombinuara me monitorim, kontroll dhe përforsim efektiv.• Sigurimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar me ish Republikën e Maqedonisë dhe Shqipërinë sa i përket përpjekjeve të përbashkëta për mbrojtjen e biodiversitetit, për kërkime dhe për eko-turizëm.
Veprimet (të marra nga Komuna e Dragashit (2010): Plani Lokal i Veprimit mbi biodiversitetin në Komunën e Dragashit 2011-2015)
A) Themelimi i ruajtjes së natyrës në zhvillimin komunal
A1) Zhvillimi i udhëzuesit për ruajtje të natyrës në Komunë për çdo fushë kryesore (biodiversitet, pylltari, bujqësi, blegëtori, menaxhim i ujit, menaxhim i ujërave të zeza, masa të infrastrukturës siç janë trafiku dhe transporti)
A2) Zhvillim dhe instalim i mekanizmave financiarë për të ruajtur angazhimin e Komunës në mbrojtjen dhe

zhvillimin e biodiversitetit

- A3) Organizim i vazhdueshëm i fushatave të ndërgjegjësimit peisazhin dhe laramaninë e pasurisë së biodiversitetit në fshatrat e Komunës, shkollat dhe panairot, për të nxitur mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit.

B) Themelimi i Parkut Nacional të Malit të Sharrit

- B1) Mbështetja për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar (Menaxhimi i Parqeve Nacionale dhe Plani Hapësinor) përmes Drejtorisë së Parqeve Nacionale;
- B2) Bashkëpunimi i komunës me drejtorinë e Parkut Kombëtar për të optimizuar prodhimin e të ardhurave dhe për t'i përdorur ato optimalisht, që do të thotë për të balancuar vlerat e shtuara për natyrë;
- B3) Themelimi i Qendrës së Biodiversitetit në Dragash (njëra në Opojë dhe tjetra në rajonin e Gorës);
- B4) Ofrimi i ndihmës dhe inicimi i themelimit të partneriteteve me komuna ndërkufitare për të ndihmuar dhe promovuar turizmin ndërkufitar të Parqeve Nacionale të Maleve të Ballkanit (Sharr, Korab, Deshat);

C) Zona të tjera të mbrojtura dhe planet e menaxhimit

- C1) Mbështetja aktive e autoriteteve kompetente në themelimin e inventarëve të detajuara të zonave plot biodiversitet Brenda Parkut Nacional (flora, vegjetacioni, insektet, zvarranikët dhe amfibët);
- C2) Promovimi dhe informimi i publikut në mënyrë aktive mbi statusin adekuat të mbrojtjes, sipas konfigurimeve ligjore dhe sjelljeve;
- C3) Mbështetja dhe promovimi aktiv i përgatitjeve të planeve menaxhuese për parqet nacionale dhe për të gjitha zonat e mbrojtura (që do të thotë rezervë rigorozë e natyrës, zonat speciale - Zonat Speciale të Mbrojtura dhe Zonat Speciale për Ruajtje, monumentet natyrore dhe pejsazhet e mbrojtura) jashtë parqeve nacionale. Komuna në mënyrë aktive do të ndjekë pajtueshmërinë e planeve të menaxhimit me përdorimet tradicionale të tokës dhe kërkesave për menaxhimin e pejsazheve.
- C4) Përfshirja e zonave të mbrojtura në konceptin për ngjitje (ecje, *ang.* hiking)

D) Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm – Turizmi rural

- D1) Fuqizimi i një departamenti për turizëm në administratën komunale;
- D2) Përgatitja e një Plani Veprues për Eko Turizëm që përfshin:
- D3) Shënjimi dhe rregullorja e shtigjeve për çiklizëm dhe për ecje – renovimi dhe ndërtimi i shtëpizave (kolibeve) malore
- D4) Inicimi i aktiviteteve private të cilat janë të përputhshme me qëllimet dhe kërkesat e zonave të mbrojtura dhe parqeve nacionale; dhënia e lejeve do të jetë e kufizuar për aktivitete të tilla të përputhshme
- D5) Mbështetja e zhvillimit të materialeve informative për turistët dhe popullatën lokale – programe shkollore
- D6) Zhvillimi i mundësive malore për çiklizëm me koncept që nuk është duke dëmtuar biodiversitetin dhe nuk ka ndikim negativ në pasurinë e mjedisit
- D7) Zhvillimi i turizmit për gjueti dhe peshkim për zonat jashtë Parqeve Nacionale
- D8) Inicimi i njohjes së Dragashit si një "Rezervat zyrtar i Biosferës" së UNESCO-së (Programi për Njeriun dhe Biosferën i UNESCO-së, 2012) në bashkëpunim me Qeverinë Kombëtare;
- D9) Krijimi i një "Emri Markë" për rajonin e Dragashit dhe Mjedisin, si dhe përdorimi i tij për produkte lokale.

E) Programet për specie të veçanta: gjuetia, peshkimi dhe të tjera

- E1) Rritja e sasisë së peshqve me specie të tjera vendore, duke mos dëmtuar ekosistemet e ujërave të ëmbla

<p>E2) Zhvillimi i turizmit për gjueti dhe peshkim në bashkëpunim me Shoqatën e Gjuetarëve për zonat jashtë parqeve nacionale</p> <p>I. Vendimi mbi planet për gjueti dhe kafshë të egra</p> <p>II. Shkollimi i gjuetarëve në nivel adekuat</p> <p>III. Rregullimi dhe caktimi i qartë i përgjegjësive dhe procedurave, në rast të ankesave dhe vëzhgimeve mbi:</p> <p>a. Prerjen ilegale të drunjve;</p> <p>b. Shkeljen e kodit dhe rregullave të peshkimit ose të gjuetisë;</p> <p>F) Planet, masat dhe zbatimimi i rregullave për produktet jo-drunore (mbledhja e kërpudhave dhe barishteve)</p> <p>F1) Mbështetja e autoriteteve kompetente në njoftimin e zonave ku lejohet mbledhja e produkteve pyjore që nuk janë nga druri (jo-drunore) për popullatën vendore;</p> <p>F2) Mbështetja e autoriteteve kompetente në themelimin e rregullave dhe rregulloreve për mbledhje profesionale të produkteve pyjore jo drunore (kodet e sjelljes, sasia e lejuar, periudhat e mbrojtjes, etj.);</p> <p>F3) Mbështetja e autoriteteve kompetente në themelimin dhe zbatimin e mekanizmave të nevojshme të kontrollit dhe mbikëqyrjes;</p> <p>G) Mbështetja dhe lehtësimi i masave për mbrojtjen e pyjeve (shihni gjithashtu Strategjinë Komunale për Pylltari):</p> <p>G1) Qitja me paralajmërim të hershëm dhe kontroll;</p> <p>G2) Ruajtja dhe restaurimi i pyjeve;</p> <p>G3) Masat e pyllëzimit, përfshirë dhe ofrimin e ndihmës me material për fidanishte).</p> <p>H) Parandalimi dhe kontrolli i ndotjes</p> <p>H1) Parandalimi i hedhjes ilegale të mbeturinave (ndotja e ambientit) – mbeturina amvisërie dhe të ndërtimit</p> <p>H2) Parandalimi ose zvogëlimi i ndotjes me ndikim në ndryshimet klimatike</p> <p>H3) Zbatimimi i pastrimit të mbeturinave nëpër lumenj</p> <p>H4) Zëvendësimi i poçeve elektrike nga zhiva me ato moderne nga sodiumi</p> <p>Aktivitetet e tjera të rëndësishme mjedisore janë në strategji për: 8.2 Vendbanimet, 8.7 Turizmi dhe trashëgimia kulturore, 8.8 Bujqësia, 8.9 Pylltaria, 8.10 Energjia, 8.11 Uji dhe Kanalizimi, 8.12 Mbeturinat e ngurta</p>
Planifikimi i mëtejshëm
<ul style="list-style-type: none">Hartimi i një udhëzimi për ruajtjen e natyrës në Komunë, për çdo fushë kryesore (biodiversiteti, pylltaria, bujqësia, blegtoaria, menaxhimi i ujit, menaxhimi i mbeturinave, masat infrastrukturore si trafiku dhe transporti) dhe miratimi i fuqishëm nga shoqëria civile dhe përfaqësuesit e komunitetit
Përgjegjësia / Korniza Institucionale
<ul style="list-style-type: none">Të involvuar në mënyrë direkte janë drejtoritë e Komunës në vijim:Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është përgjegjëse për hartimin e planeve për zhvillim, planeve hapësinore, urbane dhe rurale; kriteret e lejeve të ndërtimit; baza e të dhënave për pronat; mbrojtja e mjedisit; dhe menaxhimi i ujërave të zeza

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<p>dhe mbeturinave të ngurta.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë, Turizmit, Zhvillimit Rural dhe Inspektionit është përgjegjëse për politikën në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë; përgatitjen e propozim rregulloreve dhe urdhëresave administrative që kanë të bëjnë me bujqësinë, infrastrukturën, zhvillimin e turizmit dhe shërbimet e inspektionit. • Në mënyrë indirekte janë të involvuara drejtoritë e Komunës në vijim: • Drejtoria e Arsimit është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit të arsimit lokal, trajnimit të mësimdhënësve, dhe çështjet infrastrukturore që kanë të bëjnë me objektet arsimore. b. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes, dhe Shpëtimit është përgjegjëse për shërbimet emergjente, planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse dhe planet e mbrojtjes. • Drejtoria e Parkut Nacional Mali Sharr është përgjegjës për qeverisjen e të gjitha burimeve të Parkut Nacional • MMPH - Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor është përgjegjëse për hartimin e politikave, zbatimin e ligjeve, dhe mbikqyrjen e aktiviteteve për mbrojtjen mjedisore të burimeve të ujit, ajrit dhe tokës. • AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është përgjegjëse për mbikqyrjen e mjedisit dhe natyrës, krijimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave dhe sistemeve për informata të mjedisit, si dhe për sigurimin e ekspertizës për menaxhimin e zonave të mbrojtura. • Agjencia Pyjore e Kosovës është përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve (d.m.th., pyjet publike), dhe mbikqyrjen e tokës pyjore private. 	
Afati kohor	Implikimi financiar
<p>Projektet prioritare (masat afatmesme)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përpilohet një udhërrëfyes për natyrën e ruajtjes në Komunë të secilës fushë kryesore (A1) • Të arrihet marrëveshje me Drejtorinë e Parkut Nacional “Mali i Sharrit” dhe me Agjencinë Kosovare të Pylltarisë për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në planifikim, implementim dhe fuqizim të Planit Menaxhues për Parkun Nacional (B1, B2) • Të zhvillohen dhe të instalohen mekanizma financiarë për të ruajtur angazhimin e Komunës në ruajtjen dhe në zhvillimin e biodiversitetit (A2) 	<p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p>
<p><u>Masat afatmesme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Fushatat e ndërgjegjësimit për peizazhin dhe biodiversitetin (A3) • Themelimi i Qendrës për Biodiversitet në Dragash (B3) • Krijimi i partneriteteve me komunat ndërkufitare (B4) • Informimi i publikut mbi statusin adekuat të mbrojtjes (C2) • Përkrahja dhe promovimi i përgatitjes së planeve të menaxhimit për PN dhe zonat e mbrojtura (C3) • Krijimi i planit të veprimit për turizëm ekologjik (D2) • Inicim i njohjes zyrtare nga UNESCO si “Rezervë Biosfere” (D3) • Krijimi i një udhëzuesi oër aktivitetet e gjuetisë jashtë PN (E2) • Përkrahja dhe kontrolli i mbledhjes së produkteve pyjore në përjashtim të drurit (F1-3) • Kontrolli dhe paralajmërimi i hershëm i zjarrit (G1) 	<p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p>

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe restaurimi i pyjeve (G2) • Zbatimi i pastrimit të lumenjve nga mbeturinat (H3) 	i lartë mesatar
<p><u>Masat afatgjata</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkrahja e inventarit të hollsishtëm të pikave më të rëndësishme të biodiversitetit (C1) • Pyllëzimi (F3) • Zëvendësimi i llambave elektrike të merkurit me llambat moderne të sodiumit (G4) 	mesatar i lartë i ulët
Vlerësimi	
<p>Strategjia e ruajtjes së natyrës do të ketë ndikime të caktuara pozitive në mjedis. Masat për ruajtjen e natyrës do të shtojnë mbrojtjen e mjedisit (tokën, ujin, ajrin dhe mjedisin), duke përmirësuar në këtë mënyrë shëndetin dhe duke dhënë kontribut për mbrojtjen e trashëgimisë së paprekshme kulturore dhe natyrore.</p> <p>Strategjia për ruajtjen e natyrës përmban disa masa për përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik. Nuk ekzistojnë ndikime negative ose kufizime të pritura, madje as edhe nga krijimi i rregulloret e Parkut Nacional ose rregulloreve të tjera për mjedisin.</p>	

Arsyeshmëria

Gjendja ekzistuese (rrallësia) e pyjeve, zonat e papyllëzuara dhe ligatinat është regjistruar deri në një masë që lejon një përkufizim të parë të zonave që kërkojnë mbrojtje në mënyrë që të ruhen funksionet e tyre ekologjike dhe shërbimet në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (rezervat e rrepta natyrore, zonat e veçanta – zonat e veçanta të mbrojtura dhe zonat e veçanta të ruajtjes, monumentet e natyrës dhe peizazhet e mbrojtura) dhe futja e zonës së Parkut Kombëtar si pjesë e planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar.

Harta vlerësuese në vijim ofron të dhënat bazë për Udhërrëfyesin zhvillimor:

- A1.1 dhe A1.2 Vlerësimi i biodiversitetit
- A3 Vlerësimi i burimeve të ujit – regjenerimi, kërcënimet dhe cilësia
- A4.1 - A4.3 Vlerësimi i rreziqeve natyrore
- A5.1 dhe A5.2 Vlerësimi i pyjeve dhe i bujqësisë – gjendja dhe funksioni i pyjeve
- A6 Vlerësimi i mbeturinave të ngurta
- A7 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe i potencialit turistik

Harta “G1-1 Ruajtja e natyrës” i karakterizon zonat preferenciale për ruajtjen e natyrës si:

- Zona që klasifikohen në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si
 - Rreptësisht rezervë *),
 - Zonë e veçantë e ruajtjes dhe zona të veçanta të mbrojtura
 - Monumentet natyrore apo
 - Relievi i mbrojtur
- Zonat që kërkojnë rehabilitim (apo një përzierje zhvillimi e rehabilitimi)
- Zonat që janë në dispozicion për zhvillim të mëtejshëm

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Është me rëndësi të theksohet se shumica e relievit të Dragashit është rezultat i praktikave shekullore të përdorimit të tokës që poashtu janë origjinë e shumëllojshmërisë së jetës së gjallë dhe të relievit atraktiv. Ndryshimi i formës së përdorimit të tokës do të ndërhyjë në biodiversitet.

Shtirja e formave të biodiversitetit dhe pikave kryesore të tij tregon qartë se shumë prej zonave ekzistuese ekologjike janë brenda hapësirës së Parkut Nacional "Mali i Sharrit" (shih hartat e AZhQ të lartpërmendura). Gjetjet e identifikimit fillestar të lokacioneve, Natyra 2000, në Kosovë, janë konfirmuar (dhe janë shtuar detaje të konsiderueshme) (Mustafa dhe të tjerë, 2009).

Zabelet dhe kullosat e gjera dhe tokat me barishte të thata gjithashtu kanë vlera të larta për biodiversitetin. Sidoqoftë, këto lloje vegjetacionesh varen nga menaxhimi (tradicional) i shfrytëzimit të tokës.

Vegjetacioni dhe flora janë pjesë e pasqyrës së përgjithshme për një strategji të gjithmbarshme ruajtje dhe duhet të kombinohen me vlerësimin e faunës dhe të funksioneve ekologjike pyjore për një udhërrëfyes gjithëpërfshirës të ruajtjes së natyrës.

Përkufizimi i llojeve të ndryshme të zonave të mbrojtura në bazë të Ligjit mbi Mbrojtjen e Natyrës dhe përkufizimit të zonës së Parkut Nacional mund të bazohen në këtë vlerësim.

Rreth 70% e komunës janë habitat për gjitarët, zogjtë dhe fluturat, sipas Direktivës Europiane për Habitat (përfshirë Direktivën e Zogjve - EU 2007 dhe 2009). Përveç habitatit alpin për Chamois, habitatit subalpine, pyjet e larta dhe ekotonet apo zonat transicionale vegjetative të tokës pyjore janë korridore ekologjike për rrëqebuj, arinj dhe ujq, duke lidhur kështu vargmalet e Parkut Nacional 'Mali i Sharrit' me mallet e Maqedonisë dhe të Shqipërisë. Kjo vërteton të gjeturat (dhe shton një mori detajesh) të identifikimit preliminar të lokacioneve, Natyra 2000, Kosovë (Mustafa dhe të tjerët, 2009).

Burimet e faunës janë pjesë e informacionit për sugjerimin e zgjerimit të Parkut Nacional dhe të përkufizimit të ardhshëm të llojeve të ndryshme të zonave dhe specieve të mbrojtura sipas Ligjit mbi Mbrojtjen e Natyrës (rezervat e rrepta natyrore, zonat e veçanta për ruajtje dhe ato të mbrojtura, monumentet natyrore dhe relieve i mbrojtur. Korridoret ekologjike luajnë një rol të rëndësishëm për lejimin e lëvizjes së lirë të specieve nga një vend në tjetrin dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të rrjetit ekologjik.

Për shkak të diversitetit të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe strukturave relievo të territorit të Komunës së Dragashit, kjo komunë ofron një diversitet të madh për popullatat e ndryshme, respektivisht për një numër të theksuar grupesh e specieve të shtazëve. Përveç tokave pyjore, pyjeve të larta, zabeleve, të gjitha llojet tjera të ligatinave dhe zonave me shkëmbinj e rërë janë të një rëndësie të madhe.

Nuk ekzistojnë studime shkencore sistematike në dispozicion mbi faunën e Dragashit. Sidoqoftë, të dhëna nga OJQ-të, fshatarët, informata të mbledhura nga literature dhe vëzhgimet e bëra nga ekspertët e PZHKB-së, ofrojnë një bazë të mirë të dhënash mbi faunën lokale të kësaj zone.

Gjitarët:

- Ariu i kaftë (*Ursus arctos*): Një nga vecoritë dalluese të Maleve të Sharrit. Këta rriten në lokacionet pyjore (si pyjet në lindje të Bresanes dhe Blacit, në Malin e Koritnikut dhe në mallet ndërmjet Restelicës dhe Krushevës) dhe e kalojnë kufirin edhe në pjesët më të largëta në juglindje dhe në pjesën vazhduese të Parkut Nacional "Mali i Sharrit" në verilindje. Arinjtë rrallë shihen në zonat e kullosave pyjore dhe në qendër të rajonit të Opojës.
- Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*): Edhe ky ka një përhapje të njëjtë me ariun në

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

zonat pyjore dhe në zonat e larta kufitare. Edhe pse është një specie e rrezikuar në nivel të Gadishullit Ballkanik, pritishtëritë janë që ai është i pranishëm në Komunën e Dragashit në zonat kufitare me Shqipërinë dhe IRJM-në.

- Ujqit (*Canis lupus*): janë gjithandej në komune.
- Dhia e egër e Ballkanit (*Rupicapra rupicapra balcanica*): është e pranishme në zonat e larta shkëmbore, në zonat alpine dhe subalpine.
- Dreri (*Capreolus capreolus*): Përgjithësisht jeton në pyll, edhe pse ata mund të shkojnë në tokat pyjore dhe livadhe.
- Derri i egër (*Sus scrofa*): ndan të njëtin habitat me drerin – më afër zonave bujqësore

Zogjtë:

OJQ “Harabelat” ka ofruar të dhëna mbi zogjtë për vitet 2004 – 2010, në raport me 11 lokacione të komunës. Një total prej 153 specie zogjesh janë vëzhguar gjatë kësaj periudhe. Lokacionet individuale numërojnë ndërmjet 27 dhe 85 speciesh të ndryshme. Afërsisht, një e tretë e këtyre specieve gjinden në Aneks të ndryshme të Direktivës së BE-së për Zogjtë (shih tabelën 2-5 në Aneksin e Hartave 2.5). Gjetjet tregojnë për një shumëllojshmëri të specieve të zogjeve në komunë. Zonat e vëzhguara përfaqësojnë lloje të ndryshme relieves dhe popullatash/habitatesh të pranishme në komunë

Fluturat:

40 specie fluturash janë vëzhguar deri më tani në faqet e larta të maleve dhe nëpër zabele. Përmendet një llojllojshmëri speciesh 30 prej të cilave janë të emërtuar në Aneksin II apo IV të Direktivës së BE-së për Habitatet apo janë të vlerësuar si “të rrezikuara” apo “të cenueshme” në Kosovë sipas kritereve të IUCN-së.

Insektet ujore (bazuar në mostrat e marra nga PZHKB-ja, pranverë 2011):

Përkrah specieve shumë të shpeshta, janë identifikuar dhe specie të rralla në lumenjtë e Dragashit:

- *Limnephilus petri* i gjetur në Lumin Brod është një specie endemike e Gadishullit Ballkanik i pranishëm vetëm në Kosovë (brenda Kosovës, vetëm në rrjedhën e sipërme të Lumit Brod) dhe në Bullgari.
- *Genus Trianodes* me speciet e tij dyngjyrëshe të gjetura në Liqenin e Breznës është i pari dhe i vetmi i kësaj gjinie dhe specie në Kosovë deri më tani.

Këto insekte ujore relativisht të rralla dhe të pakëta në numër në Komunën e Dragashit shpalosin një faunë tejet të pasur dhe specifike të kësaj zone. Ekziston një potencial i madh për insekte të tjera ujore lokale endemike apo edhe për specie të reja të shkencës. Ekziston nevoja për të mbledhur më shumë nga ky grup i kafshëve ashtu që të ndërlihet kjo me ceshtjet e menaxhimit dhe ruajtjes.

Amfibet dhe reptilët

5 specie amfibesh (i tërë Aneksi IV) dhe 6 specie reptilësh janë lokalizuar. Meqë nuk ekziston një inventarizim sistematik për këtë zonë, këto shifra janë vetëm informata të rastësishme. Regjistrime më të thukta të të dhënave do të mund të vinin si rezultat i një vëzhgimi sistematik.

8.2 Vendbanimet

Synimet e përgjithshme
Zhvillimi i mëtejshëm i vendbanimeve duhet të bëhet në mënyrë të rregulluar mirë. Ndryshe nga aktivitetet e pakontrolluara individuale në të kaluarën, ndikimi më i fuqishëm i administratës komunale do të sigurojë respektimin e interesave të përbashkëta, mbrojtjen e resurseve natyrore dhe përkrahjen e zhvillimit të vazhdueshëm. Procesi i planifikimit urbanistik dhe dorëzimi i kërkesave për leje ndërtimi do të jenë në pajtim me ligjet. Kështu, fshatrat do të kenë mundësinë për zhvillim të dukshëm, duke ruajtur karakterin dhe bukurinë e tyre individuale dhe peizazhet përreth. Cilësia e përmirësuar e disejnit dhe funksionalitetit të hapësirave publike dhe ruajtja e arkitekturës tradicionale dhe trashëgimisë kulturore duhet të kontribuojnë në përfortimin e identitetit të fshatrave.
Objektivat
<ul style="list-style-type: none">• Rregullimi i aktiviteteve në vendbanimet private do të ndihmojë drejt zhvillimit të vazhdueshëm të fshatrave. Kjo do të lejojë planifikimin dhe ndërtimin e duhur të infrastrukturës teknike dhe ndërtimin e objekteve në vendet ku infrastruktura teknike është e mundur. Statusi i vendbanimeve për të qenë joformale do të qartësohet dhe nëse është e nevojshme, të gjitha procedurat për rregullarizimin do të bëhen.• Zonat ndërtimore për zhvillimin e mëtejshëm të vendbanimeve, zonave ekonomike dhe për qëllime të tjera do të përgatiten në vende të përshtatshme dhe me madhësi të mjaftueshme, varësisht nga madhësia, numri i banorëve dhe klasifikimi i vendbanimeve që janë përcaktuar në parimet e përgjithshme të planifikimit.• Të gjitha fshatrat do të kenë zona për zhvillim të ndjeshëm të vendeve të banimit. Madhësia dhe pozita e zonave të banimit nëpër fshatra do të përcaktohet në bazë të strukturës së vendbanimit, kërkesës së paraparë dhe në bazë të mundësive mjedisore. Harta udhëzuese i përmban propozimet e elaboruara për të gjitha 36 fshatrat.• Zonat për ndërtime të mëdha komerciale do të përqëndrohen në qytetin Dragash si qendër komunale dhe nëpër nënqendra. Harta udhëzuese përfshin propozimet për një zonë industriale në Dragash dhe për zona komerciale në Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne dhe Restelicë, vende me qasje të mirë në trafik, relief të rrafshët, duke lënë një distancë nga zonat e banuara për të mbrojtur ato nga zhurma dhe gazrat e automjeteve. Zonat komerciale do të krijojnë mundësi për themelimin e bizneseve të ndryshme dhe kështu do të stimulojnë ekonominë vendore dhe krijimin e vendeve të punës.• Karakteri individual dhe identiteti i fshatrave do të jetë i mbrojtur; vendet me trashëgimi kulturore duhet të ruhen dhe të restaurohen.• Do të përmirësohet rregullimi i hapësirave publike nëpër fshatra. Sheshet publike dhe rrugët kryesore në qendrat e fshatrave do të bëhen vende tërheqëse dhe të përshtatshme për përdorim multifunksional.• Me shmangien e vendeve të rrezikshme të banimit, banorët do të mbrohen nga rreziqet natyrore siç janë ortekët, rrëshkitja e shkëmbinjve dhe vërshimet. Prandaj, shpatet e pjerrta, bregjet e lumit dhe vende të tjera të rrezikshme duhet të jenë të ndaluara për aktivitete të

<p>vendbanimeve. Në rastet e nevojshme, duhet të merren masa për zvogëlimin e rreziqeve të pranishme (për shembull: zvogëlimi i rrezikut nga orteku në Restelicë)</p> <ul style="list-style-type: none">• Mjedisi duhet të jetë i mbrojtur nga ndikimet e vendbanimit, prandaj zgjedhja e zonave të përshtatshme duhet të marrë në konsideratë “rezistencën hapësinore” të faktorëve natyrorë. Hapësira e gjelbër me funksion siç është ai i “brezit të gjelbër” duhet të ruhet nga ndërtimet.
Aktivitete
<p>A) Vazhdim i planifikimit urban:</p> <p>A1) Propozim planet për zhvillim urban [PZU] dhe plani rregullativ urbanistik [PRU] në qytetin Dragash dhe nënqendrat Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne, Brod, Rapçë dhe Restelicë</p> <p>A2) Propozim planet rregullative urbane për zonat e mëdha të ndërtimit siç është zona industriale në qytetin Dragash.</p> <p>A3) Hartimi i planeve urbanistike zhvillimore [PUZh] dhe planeve urbane rregullatore [URP] për Dragashin, Pllajnikin dhe Vranishtën me qëllim që të qartësohet statusi si vendbanime joformale. Nëse është e nevojshme, duhet të ndërmerren të gjitha hapat relevante sipas “Udhëzuesit për planifikim hapësinor të vendbanimeve joformale” (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor).</p> <p>B) Përcaktimi i përgjegjësive dhe procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit sipas ligjeve ekzistuese:</p> <p>B1) Marrja parasysh e çështjeve specifike me anë të planifikimit urbanistik: rregullimi i mirëfilltë urbanistik i dendësisë dhe sipërfaqes së hapur, cënueshmëria nga rreziqet dhe fatkeqësitë (ortekët, erozioni, vërshimet), makro-mikroklima (rrezet e diellit, era, vendet e ngrira), të dhënat mbi zonat e zhvillimit dhe parcelat e kadastrit, rregullat për të hyrë në ndërtesë (infrastruktura rrugore dhe instalime të tjera), siguria dhe rendi publik, si dhe vlerat historike dhe kulturore.</p> <p>B2) Kontrolli, mbikqyrja dhe inspektimi i kushteve të ndërtimit (Ndërtesat lejohen vetëm në zonat e caktuara nga PZHK/PZHU/PUR dhe në pajtim me rregulloren e caktuar nga PUR).</p> <p>B3) Sigurimi i infrastrukturës fizike dhe sociale përbrenda zonës urbane.</p> <p>C) Zhvillimi i zonave komerciale / industriale:</p> <p>C1) Qyteti Dragash / Shajne: Realizimi i zhvillimit të një zone industriale në veri të qytetit Dragash (Vendimi i Kuvendit Komunal nga viti 2008, zona është në ndërtim e sipër)</p> <p>C2) Qyteti Dragash: Zgjerimi i zonës ekzistuese komerciale në jug të qytetit Dragash; parandalimi i ndërtimit të vendbanimeve private.</p> <p>C3) Verifikimi i nevojës për zona komerciale në nënqendrat Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne dhe Restelicë; përgatitja e kushteve infrastrukturore për veprimtari të mundshme të ndërtimeve private.</p> <p>D) Zhvillimi i zonave të banimit:</p> <p>D1) Verifikimi i nevojës për lagjet e banimit në fshatra, sipas propozimit të dhënë në hartat udhëzuese; përgatitja e kushteve infrastrukturore për veprimtari të mundshme të ndërtimeve private.</p> <p>E) Zbukurimi i qendrave të fshatrave:</p> <p>E1) Përmirësimi i vlerave luksoze dhe dizejnit urban të hapësirës qendrore publike nëpër fshatra, me përdorimin e elementeve të tilla si trotuare me gur natyror, pemë, karrike, shatërvane...</p> <p>F) Trashëgimia kulturore</p> <p>F1) Grumbullimi sistematik i të dhënave lidhur me objektet e ndërtuara në stil tradicional të arkitekturës, si dhe të dhënat e vendeve dhe elementeve të tjera me rëndësi kulturore dhe fetare (si varrezat, etj.)</p> <p>F2) Promovimi i vlerës së objekteve tradicionale si pjesë e trashëgimisë kulturore, me anë të realizimit të projekteve eksperimentuese, p.sh. që përdoren si qendra kulturore</p> <p>F3) Përkrahja e pronarëve privatë në ruajtjen dhe restaurimin e objekteve tradicionale, duke ofruar fonde dhe</p>

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

eksperizë teknike G) Ruajtja e hapësirave të gjelbra, përmirësimi i gjelbërimit nëpër fshatra G1) Nxjerrja e një statuti që do të mbrojë prerjen e drunjve të mëdhenj nëpër vendbanime G2) Inkurajimi i projekteve eksperimentale për projektimin e hapësirës nën qiell të hapur (p.sh. Tregu i gjelbër ose sheshi në Kuvendin Komunal të qytetit Dragash) G3) Ngritja e vetëdijes lidhur me mjedisin dhe sistemi i brezit të gjelbër (vënia e shenjave të brezave të e gjelbër, për t'i ruajtur ato jashtë aktiviteve ndërtimore) H) Programi për zvogëlimin e rreziqeve në zonat e rrezikuara të banimit H1) Realizimi i anketës për analizën e rreziqeve gjeologjike, kombinuar me një plan për zvogëlimin e rreziqeve teknike në Restelicë. H2) Zbatimi i programit për zvogëlimin e rreziqeve, i cilipërshin: pyllëzimin e zonave përkatëse përreth Restelicës, ndërtimin e sistemeve teknike për mbrojtje nga orteqet; nëse është e nevojshme – të merren masa aktive për zvogëlimin e rrezikut të rëshkitjes së shkëmbinjve, me eliminimin e zonave të rrezikut dhe me krijimin e sistemit monitories për rrezik nga orteqet.	
Planifikim i mëtejshëm	
<ul style="list-style-type: none"> • Propozim planet për zhvillim urbanistik janë bërë të paktën për qytetin Dragash dhe nënqendrat Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne, Brod, Rapçë dhe Restelicë • Propozim planet e rregullimit urban për zonat e mëdha të ndërtimit siç është zona industriale në Dragash. • Realizimi i analizës së hollësishme të rreziqeve gjeologjike dhe një propozim plan teknik për zvogëlimin e rreziqeve në Restelicë 	
Përgjegjësia / Korniza Institucionale	
<ul style="list-style-type: none"> • Sipa Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Ligjit për Ndërtime, Komuna mban përgjegjësinë e planifikimit urbanistik dhe për realizimin e lejeve ndërtimore. • Komuna siguron lejen e ndërtimit për të gjitha objektet, përveç për ato që janë përcaktuar në Nenin 35 të Ligjit për Ndërtim. Ndërtimi jashtë zonave të caktuara të ndërtimit është i ndaluar përveç për objektet e përmendura në nenin 17.3 të Ligjit mbi Planifikim Hapësinor. Për të gjitha këto objekte, leja e ndërtimit jepet nga MMPH. • Kujdesi për hapësirën publike është nën përgjegjësinë e Komunës përderisa toka është pronë publike. Komunitetet lokale mund të mbështesin aktivitetet komunale në këtë fushë. • Të gjitha ndërtimet në zonat private mbeten përgjegjësi private. 	
Afati kohor	Implikimi financiar
Projektet prioritare (masat afatshkurta) • Vënia në fuqi e PZHU PUR për qytetin Dragash dhe nënqendrat. (A1) • Krijimi i procedurës për aplikimin e lejeve ndërtimore. (B) • Zvogëlimi i efektshëm i rreziqeve natyrore me masat përkatëse, sidomos në Restelicë. (H) • Zhvillimi i zonës së planifikuar industriale në Dragash dhe ofrimi i hapësirës për bizneset që do të krijojnë vende të reja pune. (C1) • Realizimi i projekteve modele për rehabilitimin e shtëpive historike, mundësisht të përdorura për qëllime kulturore. (F2)	mesatar i ulët mesatar – i lartë mesatar i ulët
Masat afatmesme	
<ul style="list-style-type: none"> • PUR për zonat e mëdha të ndërtimit, zonat industriale, etj. (A2) 	i ulët

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<ul style="list-style-type: none"> • Verifikimi i nevojës për lagjet komerciale në nënqendra (C3) • Verifikimi i nevojës për lagje banimi (D1) • Grumbullimi i të dhënave sistematike për trashëgiminë e prekshme (F1) • Statuti për mbrojtjen e drunjve (G1) • Programet e ndërgjegjësimit mbi mjedisin dhe sistemin e brezit të gjelbër (G3) 	<p><u>i ulët</u></p> <p><u>i ulët</u></p> <p><u>i ulët</u></p> <p><u>i ulët</u></p> <p><u>mesatar</u></p>
<p><u>Masat afatgjata</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zgjerimi i zonave ekzistuese komerciale në jug të qytetit Dragash • Rritja e qendrave të fshatit (E) • Mbështetja e pronarëve privatë në ruajtjen dhe restaurimin e objekteve tradicionale. • Projektet eksperimentale për projektimin e sipërfaqeve të hapura (G2) 	<p><u>mesatar</u></p> <p><u>i lartë</u></p> <p><u>mesatar</u></p> <p><u>mesatar</u></p>
<p>Vlerësim</p> <p>Ndikimet e mjedisit parashihen për shkak të zgjerimit të mëtejshëm të zonave ndërtimore, mirëpo vendi i këtyre zonave zgjidhet në pajtim me konsideratat e mjedisit. Për më tepër, sistemi i brezit të gjelbër mbron zonat me vlera të larta mjedisore. Çështjet e shëndetit dhe trashëgimisë kulturore nuk dëmtohen nga strategjia e vendbanimeve, përkundrazi do të përmirësohen; mbrojtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve të hapura dhe peizazheve përbrenda dhe jashtë fshatrave, si dhe grumbullimi i të dhënave për trashëgiminë e prekshme, do të kenë ndikim pozitiv mbi këto çështje.</p> <p>Zgjerimi i zonave të banimit dhe zonave komerciale të lidhura me fshatrat ekzistuese do të përkrahë zhvillimin socio-ekonomik. Modernizimi i disa fshatrave në nën-qendra dhe përforsimi i qendrës komunale do të përmirësojë mundësitë e jetesës.</p>	

Arsyet

Gjatë viteve të kaluara aktivitetet e venbanimeve janë realizuar pa rregullore. Sipas ligjeve aktuale, kjo praktikë konsiderohet e paligjshme. Veç kësaj, përvoja e këtyre shton numrin e konflikteve.

Plani për Zhvillim Komunal ofron udhëzime lidhur me pozitën dhe madhësinë e zonave të vendbanimit nëpër fshatra, në bazë të konceptit të kuptimit funksional të fshatit. Përcaktimi përfundimtar i zonave të ndërtimit duhet të bëhet në planet zhvillimore urbane dhe planet rregullative urbane.

Qyteti Dragash si qendër komunale do të ketë hapësirën më të madhe për zhvillimin e të gjitha llojeve të vendbanimit, veçanërisht për të përmirësuar funksionin e vet si qendër komerciale dhe sociale. Fshatrat Shajne dhe Lubovishtë mund të shërbejnë si periferi dhe mund të ofrojnë zona banimi afër qytetit Dragash.

Nënqendrat do të zhvillojnë edhe zona komerciale, nëse ekzistojnë mundësi gjeografike për një gjë të tillë.

Në qendrën e komunës, në nënqendra dhe nëpër fshatra do të mundësohen zonat ndërtimore për venbanime private. Numri i tyre përputhet me kërkesën, gjë që mund të përcaktohet në bazë t

ëzhvillimit të popullatës dhe madhësisë hapësirë për jetë, për kokë banori. Madhësia e zonave ndërtimore, e përcaktuar për një periudhë 10 vjeçare, duhet të përbëjë 10 deri në 30 % të madhësisë aktuale të fshatrave.

Një çështje e vështirë është ajo e fshatrave të largëta të cilat janë duke u çpopulluar. Pasiqë numër shumë i madh i banorëve të këtyre fshatrave janë larguar dhe gjasat për rikthimin e tyre janë shumë të vogla, nuk ekziston nevoja të propozohen zona të mëdha për ndërtim të mëtejshëm. Nga ana tjetër, edhe atje duhet të ekzistojnë mundësi për zhvillim dhe punime ndërtimore.

Kriteret për përcaktimin e zonave të ndërtimit

Qëllimet kryesore të këtij udhëzimi janë të orientojë zhvillimin hapësiror të vendbanimeve në një mënyrë të qëndrueshme, duke iu shmangur ndotjes së mjedisit dhe rreziqeve natyrore, për të lehtësuar qasjen në infrastrukturën teknike dhe për të ruajtur strukturën e zhvilluar historike të fshatrave. Sipas topografisë, toka, fshatrat dhe kriteret e tjera, zonat e ndryshme janë pak a shumë të përshtatshme për ndërtim.³ Kjo është prezantuar në Hartën e Rezistencës Hapësirë (IG1), në të cilën janë bazuar edhe rekomandimet e Planit për Zhvillim Komunal. Kështu, asetet topografike, historike dhe strukturore të fshatit në lidhje me synimet dhe objektivat e përkufizuara në strategjitë e vendbanimit për qytetin Dragash, vendosin udhërrëfyesin e vendbanimeve.

Harta e Rezistencës Hapësirë është mjet i rëndësishëm i cili përcakton vendet e papërshtatshme për ndërtim: Shmanguni zonave me rezistencë të lartë hapësirë: shpatet me pjerrtësi më të madhe se 15 %, zonat me vegjetacion që ka vlera të lartë të biodiversitetit, zonat bujqësore të kategorisë I-II, zonat me rreziqe më të mëdha natyrore dhe pyjet që përmbushin funksione të rëndësishme. Shmangia e afrimit të fshatrave (pjesëve të tyre) nëse fshatrat janë ndarë/larguar nga elemente natyrore. Këto zona që duhet të mos jenë pjesë e aktiviteteve ndërtimore janë quajtur breza të gjelbër.

Krahas rezultateve të hartës për rezistencë hapësirë, udhëzimi për projektimin urban është që të shihet lloji i bashkangjtitjes në relief dhe në terren dhe të rekomandohen zhvillime në grupe të koncentruara e jo zhvillime lineare përgjat rrugëve.

Numri i zonave të propozuara të vendbanimit

Vendbanimet ekzistuese përbëjnë një madhësi prej rreth 510 ha. Nën supozimin se numri i popullsisë do të mbetet pothuajse në nivelin e njëjtë si sot por konsumimi i hapësirës për vendbanime të ndryshme (vende banimi, zona komerciale, tregti, turizëm...) do të rritet për kokë banori (ashti siç ndodh në të gjitha vendet në zhvillim), është reale të pritet një kërkesë rreth 10% për një periudhë prej 10 vjetësh. Madhësia e përgjithshme e zonave të vendbanimit është rreth 120 ha, që do të thotë pothuajse 25% e zonave urbane ekzistuese. Kjo shifër është shumë më e lartë sesa kërkesa e paraparë, sepse udhëzimi mundohet të shfaqë një varg mundësishë për zhvillimin e ardhshëm. Duke marrë parasysh se numri më i madh i parcelave janë pronë private, në të ardhmen do të ketë nevojë që toka ndërtimore të blehet dhe të shitet. Parashikimet në procesin e planifikimit urbanistik janë të pamundura, si për shembull, se cilat parcela do të jenë në dispozicion për tregun e patundshmërive. Prandaj, udhëzimi duhet të përfshijë hapësirë shumë më të madhe se që është e nevojshme, por të gjitha hapësirat e propozuara duhet të jenë të vendosura në vende të përshtatshme.

³ Të dhënat janë të shënuara në ëHartat e mëposhtme të Vlerësimit: A1.1 dhe A1.2 Vlerësimi i biodiversitetit, A4.1 - A4.3 Vlerësimi i rreziqeve natyrore, A5.3 Vlerësimi i pyjeve dhe bujqësisë – kapaciteti produktiv i tokës, A7 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe potencialit turistik

Përshkrimi i zhvillimit të vendbanimeve

Zhvillimi hapësinor i vendbanimeve është treguar në hartën e Udhëzimit G7: Udhëzimi mbi Vendbanimet. Informata plotësuese janë dhënë për çdo fshat dhe qytetin Dragash në hartat A3 (G7.1 – G7.35) në proporcionin 1:5,000. Këto harta karakterizojnë udhëzimin e vendbanimit (zonat e fshatrave) si:

- Zona ndërtimore (zona për zgjerimin ndërtimit të shtëpive/ vendbanimit. Ndërtimi jashtë kësaj zone nuk është i lejuar)
- Zona komerciale (zona për ndërmarrje, tregti dhe biznes. Dyqanet e vogla mund të jenë jashtë kësaj zone, por bizneset e zhurmshme (p.sh. fabrika, garazha) duhet të vendosen në këtë zonë)
- Objektet publike (zona rreth shkollës së re në Dragash për të përqëndruar objektet e reja publike/ ndërtesat publike)
- Zona turistike (zonat përbrenda ose në afërsi të vendbanimit, ku mund të ndërtohen objektet turistike (siç janë hotelet, pushimoret, objektet e Parkut Nacional)
- Qendra urbane (zona në fshat, ku duhet të ketë hapësirë publike për tubime tradicionale – kjo zonë duhet të jetë e dizajnuar për të siguruar vlerat e komoditetit)
- Brezi i gjelbër (i liruar nga ndërtimi; ruajtja e mjedisit/ hapësirës së gjelbër)

Dragashi

Qyteti i Dragashit është qendra kryesore administrative dhe komerciale e komunës së Dragashit dhe tregu kryesor i qytetit. Ai paraqet pikën qendrore për rrugët që çojnë drejt luginave kryesore të komunave Restelicë dhe Brod. Qendra e qytetit ka një numër të madh të objekteve dhe shërbimeve institucionale, dhe si e tillë paraqet pikën qendrore për të gjitha rrugët që kalojnë përmes komunës. Stacioni i autobusave ndër-komunalë është i vendosur në qendër të qytetit. Territori i Dragashit është shumë i urbanizuar dhe në krahasim me vendet e tjera ka mungesë të tokave bujqësore dhe baritore. Qyteti është i vendosur shumë afër lagjes Lubovishtë në juglindje dhe lagjes Shajne në verilindje. Midis qytetit të Dragashit në veri dhe Shajnes është hapur një rrugë e re, përgjat të cilës është duke u ndërtuar një objekt i ri i shkollës së mesme. Është pastruar një pjesë e madhe e tokës, ku komuna parasheh ndërtimin e një qendre komerciale. Në jugperëndim të Dragashit është qendra e vjetër komerciale ku është e vendosur fabrika e leshit Remateks.

Si qendër komunale, Dragashi është vendi ku duhet të vendosen ndërmarrjet e reja, kështu që janë shpallur dy zona industriale, dhe atë në veri dhe në jug të qytetit. Zna përreth shkollës së mesme të re, është paraparë për objekte publike. Zonat ndërtimore të qytetit Dragash janë vendosur në jug dhe në veriperëndim të qytetit, kryesisht si 'kupë e mbushur' në lagjet e grumbulluara nga ndërtimet shtesë. Duhet të përcaktohet një linjë e qartë dhe e mbyllur që do të definojë zonën urbane në pamjen e tablosë. Në zonën e ndërtuar ndodhen edhe "brezat e gjelbër". Këto zona të gjelbra, të cilat duhet të jenë të përjashtuara nga ndërtimet e reja, theksojnë konturat urbane, mbrojnë zonat me vlerë për mjedisin dhe ruajnë distancën midis disa fshatrave. Në qendër të fshatit, midis stacionit të autobusit dhe sheshit në afërsi të objekteve institucionale, duhet të ekzistojë një hapësirë publike për takime ose bashkime tradicionale – kjo sipërfaqe duhet projektuar ashtu që të posedojë vlera të komoditetit. Kjo mund të arrihet me zgjerimin e dy shesheve dhe lidhjen midis tyre (kontrolli i trafikut, projektim i sipërfaqes nën qiell të hapur).

Shajne

Për shkak të afërsisë me qytetin Dragash, ky fshat fiton një mbushje dhe shtrirje urbane. Fshati Shajne kryesisht përbëhet nga parcelat dhe fushat rurale, megjithëse vërehet një zhvillim i "periferive". Këshillat për këtë zhvillim janë ruajtja e disa prej pasurive të fshatit dhe menaxhimi i zhvillimit urban.

Zona në jugperëndim të fshatit Shajne është propozuar për zonë urbane e banimit, e cila do të ofrojë vendbanime në afërsi të qytetit të Dragashit, tzonën e re komerciale dhe shkollën e mesme. Ndërtimet duhet të mbyllin boshllëqet midis qendrës së fshatit dhe shtëpive të reja përgjat rrugës kryesore dhe për t'iu shmangur luginës së lumit. "Qendra urbane" e fshatit, afër xhamisë, duhet të projektohet në mënyrë që të posedojë vlera të komoditetit.

Lubovishtë

Fshati bëhet periferi e qytetit Dragash për shkak të shtrirjes dhe stërmbushjes urbane të qytetit. Ka disa zhvillime sidomos praën rrugës shumë të frekuentuar drejt Brodit. Ka shumë shtëpi me oborre në pjesën e përparme dhe të pasme por ka një numër shumë të vogël të bizneseve për shkak të afërsisë së tij me Dragashin.

Brezi i hollë i gjelbër midis Lubovishtës dhe qytetit të Dragashit duhet të jetë i mbrojtur nga ndërtimet dhe nuk duhet të ndërtohet përgjatë luginës së lumit. Vendbanimet janë propozuar në kodrën poshtë shkollës, por megjithatë janë pak të distancuara nga rruga kryesore. "Qendra urbane" e fshatit është e vendosur në maje të kodrës.

Restelicë

Fshati është një vendbanim relativisht i madh i cili është zhvilluar shpejtë. Është shumë i izoluar, por njëkohësisht është portë drejt vargut malor drejt iRJM-së dhe Parkut Nacional Mavrovë në jug. Vendbanimet janë të ndara në dy pjesë të qarta: linja veriore dhe jugore e luginës. Pjesa veriore ka një varg rrugësh me kthesa dhe një strukturë të dendur urbane e cila përbën thelbin historik. Në dekadën e fundit, Restelica është zgjeruar për pothuajse dyfishin e madhësisë së vet të mëparshme. Relievi i ngushtë ka penguar zhvillimin dhe kështu, përgjatë luginës kanë filluar të shfaqen grupe të gjysmë-lagjeve më të dendura. Fatkeqësisht, zhvillimi i shpejtë dhe i pakoordinuar i fshatit ka shkaktuar probleme të rënda lidhur me rrjetin dhe trafikun rrugor, infrastrukturën publike dhe rrezik të lartë nga orteku dhe shkarja e dheut në këtë terren të pjerrët me lartësi të madhe.

Duke qënë vendbanim i dytë për nga numri i banorëve në Dragash, Restelica është klasifikuar si nënqendër dhe duhet të përforcojë pozitën e vet. Prandaj, ekziston nevoja për zhvillim të mëtejshëm. Kjo nënkupton zgjerimin e mëturtyshëm të zonës së banimit dhe krijimin e objekteve komerciale (p.sh. për tregti, zëjtari...). Rekomandimi i Planit për Zhvillim Komunal është ta vendosë këtë qendër në maje të kodrës në veriperëndim të fshatit, ku pjerrësia nuk është aq e theksuar, së bashku me lidhjen e propozuar rrugore. Ky është vendi i vetëm në të cilin Harta për Rezistencë Hapësinore tregon përshtatshmërinë për një vendbanim të ri. Në luginën e lumit dhe sipërfaqet e lëna në hapësirat në brendi të sipërfaqes së ndërtuar, nuk guxon të ndërtohen vendbanime. Pika tradicionale e tubimit në xhaminë në pjesën veriore të fshatit duhet të zgjerohet me një projektim për sipërfaqet nën qiellin e hapur. Për më tepër, janë të nevojshme masa që do të mbrojnë Restelicën nga shkarja e tokës dhe orteqet. Masa e parë është shmangia e ndërtimit në zonat me rrezik të lartë; hapi i dytë është mbrojtja e shtëpive ekzistuese nga rreziqet natyrore, sidomos në veri, lindje dhe në jug të Restelicës. Për këtë qëllim, ekziston udhëzim për një program të zvogëlimit të rreziqeve, i cili është i përfshirë në Planin për zhvillim komunal.

Brod

Fshati është vendosur në një luginë të vogël, në brendi të maleve. Gjatë dekadave të fundit, popullata është zvogëluar dhe nuk ka shtrirje për shkak të mungesës së hapësirës. Nëpër këtë vendbanim të dendur rrjedhin tre lumenj, me luginën kryesore të lumit Brod në veri dhe në jug. Rruga drejt jugut shpie në hotelin Arxhana.

Pozita e Brodit është një shtrirje e vogël e vendbanimeve por përmban potencial të lartë turistik. Prandaj, Plani për zhvillim komunal propozon një zonë të vogël ndërtimi në veri, në terrenin e vetëm të përshtatshëm. Edhe pse Brodi konsiderohet si nënqendër, gjendja reale e natyrës nuk lejon

propozimin e zonave të mëdha urbane, siç mund të shihet nga Harta e Rezistencës Hapësinore. Inicimi i venbanimit-satellit siç rekomandohet për Restelicën, nuk është i dobishëm për Brodin për shkak të karakterit dhe topografisë së tij të veçantë. Kufijtë e venbanimit janë të rrethuar me breza të gjelbër, për të mbrojtur zonat e rrezikshme dhe ato me vlerë ekologjike nga ndërtime. Në jug të Brodit, në luginën e lumit por në një largësi të caktuar nga vet lumi, janë propozuar zona turistike për të zhvilluar hapësira rekreative që mund të përfshijnë kampe ose vende pushimore. Një hap tjetër që do të nxirrte në pah vlerat e qendrës turistike Brod, është zgjerimi i sipërfaqes së hapur në qendër të fshatit.

Bresanë

Fshati Bresanë ka numrin më të madh të popullësisë nga fshatrat e komunës (në bazë të të dhënave të dobëta statistikore). Fshati ka lidhje shumë të mirë me rrugën kryesore jashtë komunës, duke qënë se është më afër Prizrenit se sa qendrat e tjera të fshatrave. Është një venbanim relativisht i madh, i cili shtrihet përgjatë rrugëve kryesore dhe me ndërtesa risht të ndërtuara për të krijuar një vendbanim mesatarisht të dendur. Zgjerimi është i kufizuar me pyje dhe topografi në kufijtë veriorë dhe verilindorë. Përgjatë akseve të rrugës kryesore që dalin nga fshati dhe shipejnë drejt fshatërave Zgatar, Kuk, Buzez dhe Blaç, mund të vërehet një strukturë e zakonshme e shtrirjes urbane. Gjithashtu ka një afërsi dhe zhvillim drejt fshatit Kuklibeg. Fshati Bresanë ka karakter të fuqishëm të trashëgimisë, sidomos numri i objekteve tradicionale në pjesën lindore të vendbanimit.

Pasi që Bresana është klasifikuar si nënqendër, ekziston nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të fshatit. Pozita natyrore lejon zgjerimin në drejtim të perëndimit dhe veriperëndimit. Zhvillimi i mëtejshëm i vendbanimeve duhet të përqëndrohet në “boshllëqet” midis shtëpive ekzistuese në verilindje, për të ruajtur karakterin origjinal të vendbanimit të dendur. Zgjerimi i mëtejshëm në drejtim të Kuklibegut në jug duhet të ndalohej, për të ruajtur diskrecionin e fshatrave dhe karakteret e tyre të veçanta. Sipërfaqja e hapur në qendër të fshatit, e vendosur në mes të dy udhëkryqeve praën qendrës mjekësore dhe xhamisë së vjetër, mund të përmirësohet me zgjerimin e sheshit të qendra mjekësore që i ngjason parkut. Në veri të Bresanës Plani për zhvillim komunal propozon një zonë komerciale. Midis zonës komerciale dhe zonave të banimit duhet të ketë një hapësirë të gjelbër e cila do të mundësonte distancën pamore dhe atë të zërit.

Kuklibeg

Ky fshat i vogël në jug të Bresanës është shumë afër dhe zhvillohet drejt fshatit më të madh. Për më tepër, ky fshat shfrytëzonë xhaminë e Bresanës (edhe të vjetrën edhe të renë). Megjithatë, tanimë ekziston një shtrirje në venbanimet e izoluar në drejtim të fshatit Kuk.

Ky orientim i zgjerimit përputhet me ruajtjen e brezit të gjelbër midis fshatrave Kuklibeg dhe Bresanë, mirëpo duhet të ketë një “resht të dytë” të shtëpive me qasje rrugore. Ndërtimi në një rresht përgjatë rrugës kryesore shkatërron karakterin e fshatit. Veç kësaj, Kuklibegu nuk duhet të bashkohet me Kukun në jug. Qendra e fshatit mund të forcohet me projektimin e sipërfaqes nën qiell të hapur, në mënyrë që fshati të ruajë identitetin e vet.

Kuk

Për shkak të pozitës së vet në luginën e Opojës, vendbanimi është relativisht i rafshët dhe ka shtrirje në rafshin drejt veriut. Hapësira e gjelbër dhe fushat janë të vendosura midis shtëpive. Jugu i zonës është pak më tepër kodrinor me disa pyje pranë lumit, kështu që kjo zonë nuk është e përshtatshme për ndërtim të mëtejshëm.

Zona e ndërtimit qëndron në “boshllëqet” midis shtëpive të posa ndërtuara në veri, për të krijuar një kufi të mbyllur të vendbanimit. Shtretërit e lumenjve janë shpallur zona të brezit të gjelbër, për të mbrojtur njëkohësisht edhe mjedisin edhe banorët. Shtretërit e lumenjve përbrenda vendbanimit përmbajnë potencialin për t’u projektuar si hapësira nën qiellin e hapur dhe si qendër e fshatit.

Blaç

Fshati është i vendosur në jug të një vendi kodrinor me pjerrtësi dhe vegjetacion përgjatë lumenjve. Vendbanimi është i ndarë në tre pjesë, dhe lidhet me rrugën rajonale për Bresanë në perëndim dhe Zaplluxhe në lindje. Midis këtyre pjesëve janë ndërtuar parcela më të mëdha me nga një shtëpi.

Zhvillimi i përbashkët në vend të zgjerimit veçmas nga çdo pjesë e vendbanimit nënkupton krijimin e një zone të qartë të pamjes së fshatit. Shtretërit e lumenjve duhet të mos jenë të prekura nga ndërtimet e reja, në mënyrë që lumenjtë të theksojnë vijën kufitare të vendbanimit. Midis shesheve të xhamia (pjesa perëndimore) dhe të shatërvani (pjesa e mesme), një projektim i zonës së hapur rrugore do të përcaktonte “thelbin” e fshatit. Përgjatë rrugës drejt Zaplluxhes, zona e propozuar komerciale mundëson hapësirë për themelimin e ndonjë objekti komercial.

Bellobrad

Si rezultat i pozitës së vet në pragun e një lugine të gjerë, terreni është relativisht i rrafshët por rritet gradualisht në veri të fshatit. Bellobradi është zhvilluar në formën e fshatit rrugor, pasi që përmes fshatit kalon rruga rajonale, përgjatë të cilës janë zhvilluar disa biznese. Ekziston një shtrirje e vogël drejt veriut dhe jugut, ku lumi kufizon zgjerimin.

Në pajtim me origjinën e vet si fshat rrugor, zhvillimi i mëtejshëm duhet të jetë pranë rrugës kryesore, ku terreni është i përshtatshëm dhe ku ekziston qasje infrastrukturore. Arat me vlerë të lartë, shpatet e pjerrta dhe livadhet rreth lumit Bellobrad duhet të jenë të mbeten jashtë ndërtimit të venbanimeve.

Duke qënë se Bellobradi klasifikohet si nënqendër, duhet të propozohet një hapësirë për qendër komerciale, mirëpo në fshat nuk ka vende të përshtatshme. Prandaj, propozimi është që të ripërdorohet dhe të konvertohet hapësira e ndërmarrjes së mëparshme NSh “Sharrprodhimi” në jug të fshatit Bellobrad. Fermat ekzistuese bujqësore duhet të zhvendosen dhe kjo hapësirë të shfrytëzohet për zonë komerciale. Rruga drejt kësaj zone është lidhja midis rrugës rajonale dhe luginës jugore të Opojës. Nga udhëkryqi në qendër të Bellobradës deri në shesh të xhamia dhe biblioteka, një projektim i sipërfaqes së hapur mund të ofrojë një hapësirë publike për takime dhe mbledhje tradicionale.

Brezna

Ky fshat gjendet në rrëzë të malit Koritnik, ku hapet rrafshina e gjerë në veri. Ka lidhje të lehta rrugore me qytetin e Prizrenit dhe atë të Dragashit, kështu që popullsia ka pasur rritje të vazhdueshme qysh prej vitit 1961.

Në pjerrtësi ekziston tanimë një vendbanim mjaft i dendur, por ka zgjerime edhe drejt rrafshinës. Vendbanimi aktualisht përbëhet nga një numër lagjesh më të vogla, ku ka lagje të epërme, të mesme dhe të ulëta. Një gjë e veçantë për Breznën është lartësia më e ulët mbidetare (900m – 1570m) si dhe afërsia e saj me liqenin e Breznës, që është liqeni i vetëm i rëndësishëm në komunë. Brezna klasifikohet si nën-qendër.

Sipas planeve të projektit të Hidrocentralit të Zhurit (HCZH), akumulimi i planifikuar i ujit do të mbulonte pjesë të mëdha të fshatit, duke përfshirë edhe pjesën e quajtur Llapushnik, ku gjendet ndërtesa e shkollës. Vija e bregut të atij liqeni do të shkonte përmes fshatit; më e një e treta e zonës së ndërtuar, si dhe rreth 150 shtëpi ekzistuese do të duheshin hequr.

Derisa të ketë një vendim përfundimtar për realizimin e atij projekti, aktivitetet ndërtimore duhet të respektojnë këtë plan. Kështu, zonat e propozuara ndërtimore e marrin parasysh projektin e HEC-it, kanë një distancë nga zona e akumulimit të ujit, si dhe shfrytëzojnë topografinë dhe vijën e planifikuar të bregut. Zona e nevojshme komerciale gjendet në lindje të fshatit, në një distancë të vogël deri tek rruga kryesore.

Rapçë

Fshati gjendet në rrëzë të Malit Koritnik në një luginë, që shtrihet drejt juglindjes. Ky vendbanim ka dy pjesë, që janë rreth 500 m prej njëra-tjetrës. Pjesa e epërme është vendbanim i dendur, kryesisht me shtëpi banimi. Pjesa e ulët është më e vogël, por ka ndërtesa publike, si dhe përmban më shumë ind tradicional urban në kuptimin e rrugëve dhe ndërtesave.

Sipas topografisë dhe origjinës së dy pjesëve të vendbanimit, zgjerimi i përbashkët nuk rekomandohet. Pjerrinat, brigjet e lumit dhe livadhet janë shpallur si brez i gjelbër, për të ruajtur pamjen e fshatit në luginë. Ndërtimi në pjesën e epërme duhet të plotësojë hapësirat mes shtëpive dhe të orientohet drejt vendbanimit të dendur ekzistues. Për më tepër, ka një propozim për një zonë turistike, që do të mund të ishte lokacion i një restoranti/hoteli apo villave të pushimit, në veri të Rapçës. Pjesa e epërme ka një «ind urban» si pjesa më e ulët, por të dyja duhen avancuar për t'i dhënë hapësirë grumbullimeve tradicionale apo të zakonshme. Skema e hapësirës publike në pjesën e ulët duhet të lidhë udhëkryqin (rrugët drejt pjesës së epërme, drejt Kërstecit dhe drejt Dragashit), si dhe sheshin afër xhamisë me një projekt të hapësirës së lirë. Zonat e propozuara ndërtimore gjenden afër rrugës në pjesën e epërme si dhe juglindje, të afërta me shtëpitë ekzistuese të reja.

Radeshë

Përkundër terrenit malor, Radesha është zhvilluar në një fshat më të madh, i cili ndahet në pjesët e tij të epërme dhe të poshtme, në një luginë të vogël në lindje të Dragashit. Ka pak hapësirë, si dhe terreni është shumë i rrëpirë, kështu që lagjet janë mjaft të dendura, derisa shumica e rrugëve janë të ngushta dhe të thyera. Lumi kalon përmes vendbanimit të ulët dhe mes pjesëve të ndryshme të fshatit.

Shtretërit e lumit, pjerrinat e mëdha, bashkë me zonat e mbuluara me vegjetacion paraqesin një nivel të lartë të rezistencës hapësimore, si dhe janë shpallur si breza të gjelbër që duhen ruajtur nga ndërtimi. Në pjesën e ulët të Radeshës, nuk ka fusha të përshtatshme për ndërtim, kështu që zonat ndërtimore propozohen në pjesët e epërme të fshatit. Brenda të dyja pjesëve të vendbanimit, ka disa sheshe, të cilat kanë potencialin e krijimit të një hapësire publike për grumbullime tradicionale apo të zakonshme, me një projekt të hapësirës së lirë. Ka pak turizëm në Radeshë, për shkak të pozitës së saj atraktive në bjeshkë. Një zonë turistike propozohet në rrugën për Leshtan. Kjo sipërfaqe më e rrafshët është e përshtatshme për një restorant, hotel apo disa vila pushimi, si dhe do të mund të përdorej si pikë fillestare për ecje malore.

Buçë

Fshati gjendet në rrëzë të malit Koritnik, ku rrafshina e gjerë hapet drejt luginës së Opojës. Përrockat malore rrjedhin nga veriu dhe jugu i fshatit, drejt lindjes. Mes këtyre përrockave, fshati i vogël është shumë i dendur, por ka edhe hapësira të lira dhe breza të gjelbër. Rruga kryesore (e shtruar) në fshat përfundon në zonën e «sheshit të fshatit».

Kjo zonë ka nevojë për një avancim të vogël në projektim, ndoshta në lidhje me rehabilitimin e shtëpive të gurit që janë dëmtuar dhe braktisur, në lindje, prapa rrugës kryesore. Propozohen zona të vogla ndërtimore për banim të ri, në hapësirat mes zonave të ndërtuara të fshatit për të formuar një linjë kufitare të vendbanimit. Zgjerimi përgjatë rrugëve, në jug dhe drejt shtratit të lumit, duhet ndaluar. Këto zona janë shpallur si breza të gjelbër.

Brrut

Gjendet në skajin verior të luginës së Opojës, derisa peizazhi përreth fshatit është kodrinor, derisa pjesa më e madhe e zonës ndërtimore është tejet e rrëpinjtë. Vendbanimi mjaft i dendur shtrihet në të dyja anët e rrugës rajonale drejt Bellobradit në perëndim dhe Zgatarit në lindje. Zgjerimi i

vendbanimit përmes fragmentimit po fillon të ndodhë përgjatë rrugëve më të vogla në veri dhe në lindje.

Për shkak të rrëpirave ekzistuese, ndërtimi është i komplikuar në jug dhe në veri të Brrutit. Për të ruajtur distancën mes dy fshatrave Brrut dhe Zgatar, zgjerimi në lindje gjithashtu duhet të ndalet. Në vend të kësaj, zona e ndërtimit duhet të orientohet kah struktura fillestare e dendur në fshat, si dhe të formojë një vijë kufitare të vendbanimit. Në këtë mënyrë, fshati do të fitojë një paraqitje shumë të qartë në pejsazh, që është i shkëlqyeshëm në luginën e Opojës.

Zgatar

Gjendet në skaj të luginës së Opojës, si dhe shtrihet në shpate të rrëpira me pak hapësirë. Kështu, pjesa e vjetër e fshatit është e dendur. Ekzistojnë disa shtëpi të vjetra brenda fshatit. Zgjerimi i fshatit kryesisht ndjek rrugën rajonale drejt Blaçit, por në rrëzën e malit fillon të shtrihet në rrafsh. Në anën tjetër, zgjerimi i fshatit drejt Brrutit po vazhdon përtej kufijve të fshatit Zgatarit.

Rritja e përbashkët me Brrutit shkatërron strukturën historike të dy vendbanimeve diskrete, të cilat kanë karakterin dhe identitetin e tyre individual. Situata topografike nuk mundëson zgjerimin drejt veriut e as drejt jugut, derisa zgjerimi përgjatë rrugës ndërlidhet me karakterin e Zgatarit. Por, nuk duhet të ketë ndërtim «rreshti» përgjatë rrugës. Fushat ekzistuese, të përshtatshme për ndërtim, në lindje të fshatit, duhet të «mbushen», për të krijuar një zonë qartësisht të definuar të vendbanimit dhe zonën rurale.

Zaplluxhe

Ky fshat gjendet në lindjen e skajshme të luginës së Opojës në fund të rrugës rajonale. Vendbanimi ndahet në dy pjesë, gjendur përgjatë dy përrockave që derdhen në lumin Blaç. Rrjeti rrugor është relativisht i mirë, sidomos në pjesën jugore, ku janë ndërtuar shumë shtëpi të reja.

Zonat ndërtimore janë shpallur në të dyja pjesët e vendbanimit në «hapësirat» mes banimit ekzistues për të definuar një vijë të qartë kufitare të vendbanimit. Për më tepër, synohet edhe zhvillim turistik në Zaplluxhe. Ka një propozim për dy zona turistike, që gjenden afër rrugëve kryesore për të siguruar qasje më të lehtë. Shtrati i lumit dhe zonat e pjerrëta përreth fshatit duhen liruar nga ndërtimet.

Gllaboçicë

Fshati shtrihet përgjatë rrugës drejt Restelicës. Rruga e pjerrët ndahet nga rruga rajonale duke hyrë në një vendbanim mjaft të dendur. Fshati karakterizohet nga një terren i rrëpirë e shpator, me pak hapësirë për rritje të mëtutjeshme, edhe pse ende ndodhin ndërtime së brendshmi në parcelat ekzistuese, ku ndërtesat e vjetra zëvendësohen me ndërtime më të reja. Popullsia e Gllaboçicës ka rënë në dekadat e fundit.

Nuk ka aq shumë hapësirë, por ndoshta as nevojë për zgjerim të mëtutjeshëm në Gllaboçicë. Vendet e vetme të mundshme për banim gjenden në perëndim dhe në rrugën rajonale, ku terreni është më pak i pjerrët. Zonat ku ka rezistencë më të madhe hapësinore, janë të mbuluara me breza të gjelbër, që duhen ruajtur nga ndërtimet. Qendra e fshatit, ku ka pika të grumbullimeve tradicionale dhe xhami, duhet avancuar për të fituar vlera komoditeti.

Krushevë

Vendbanimi është rritur përgjatë rrugës rajonale drejt Restelicës, në një pjesë malore të rrëpirë mbi lumin Restelicë. Fshati karakterizohet nga një terren i rrëpirë e shpator, me pak hapësirë për rritje të mëtutjeshme. Popullsia ka qëndruar konstante në një nivel të vogël në dekadat e fundit.

As në Krushevë nuk ka shumë mundësi, e ndoshta as nevojë për zgjerim më të madh. Disa fusha të përshtatshme për ndërtim gjenden në perëndim, përgjatë rrugës rajonale, kështu që karakteri

original i fshatit rrugor do të vazhdojë. Një vend tjetër për ndërtim të disa shtëpive është mbi fshat në veri, por gjitha zonat tjera përreth duhen ruajtur nga ndërtimi.

Buzez

Fshati, që është në mes të luginës së Opojës, është i lidhur me fshatrat Bellobrad, Kapre, Kosavë, Kuk dhe Bresanë. Nuk është fshat i madh, edhe pse ka pak industri të lehtë. Shtëpitë janë të shpërndara përreth fabrikës së qumështit në njërën anë, derisa pjesa e vjetër e vendbanimit (përreth xhamisë së re) gjendet në anën tjetër të rrugës.

Vendbanimi ekzistues komercial vazhdon të qëndrojë në zonën e propozuar komerciale. Zonat e propozuara banesore gjenden në «hapësirat» mes shtëpive ekzistuese, për ta mbajtur fshatin në një vend. Një masë tjetër për ta përforcuar vendbanimin në raport me zonën e gjerë rurale është të avancohet pamja e qendrës së fshatit me një projektim të hapësirave të lira.

Kapra

Ky fshat i vogël afër udhëkryqit të disa rrugëve të asfaltuara në mes të luginës së Opojës është mjaft mirë i lidhur me fshatrat Buzez, Bellobrad dhe Kosavë. Fshati rrethohet me rrafshira të mëdha/fusha që përdoren për kullosa. Fshati shpesh ka zëvendësime të ndërtesave tradicionale me shtëpi moderne. Ekziston një hapësirë e madhe e lirë afër xhamisë, në një formë sheshi të fshatit.

Ky shesh paraqet «thelbin» e fshatit. Zgjerimi i mëtutjeshëm i banimit duhet të ndërlihet me këtë qendër, pra zonat e ndërtimit gjenden në «hapësirat» mes zonës ekzistuese të ndërtuar. Zgjerimi i mëtutjeshëm duhet të shtrihet mbi toka pjellore të një vlere më të lartë, por nuk kufizohet me shpate. Shtrati i lumit duhet ruajtur nga ndërtimi.

Kosavë

Fshati gjendet në skajin jugor të luginës së Opojës, me një pjesë të rrëpirë malore në perëndim, ku ka një aktivitet gurthyes. Zgjerimi i vendbanimit ka orientim kah lumi Pllajnik dhe rruga kryesore. Ka vetëm disa ndërtesa të vjetra që kanë mbetur, derisa ndërtimet e reja të dendura janë në gjithë fshatin. Një pjesë e madhe e pjesës së epërme malore përtej fshatit përballet me erozion të madh, derisa rrëshqitja e gurëve është shumë e mundur.

Shumë pjesë të zonave përreth janë shpallur si brez i gjelbër, për shkak të rezistencës hapësinore, në bazë të rreziqeve të përmendura dhe strukturës pejsazhore me vlerë të lartë (lumenjtë e zabelet). Zonat ndërtimore janë në pjesën perëndimore të fshatit, si «mbushje e brendshme» e pjesëve të vendbanimit me ndërtime tjera.

Kërstec

Ky fshat i vogël ndahet në dy pjesë – i epërm dhe i poshtëm – me rreth 500 metra prej njëri-tjetrit, në rrëzë të malit Koritnik në afërsi me kufirin shqiptar. Qendra e fshatit të epërm (në perëndim) shtrihet në një rrafshnaltë të vogël, me pjesë të rrëpura malore përfundi dhe mbi vendbanim. Ky peizazh është më i rrafshët në pjesën e ulët, me pak hapësirë mes shpateve.

Ka zona të vogla të propozuara për ndërtim në të dyja pjesët e fshatit, që gjenden në hapësirat e mbetura të përshtatshme. Zgjerimi i mëtutjeshëm përgjatë rrugës është problematik, për shkak të shpateve dhe shtratit të lumit, të cilat duhen ruajtur nga ndërtimi.

Kukulanë

Ky vendbanim i dendur është i ndërtuar në një rrafshnaltë të vogël, përveç një grupi të vogël të shtëpive të reja në veri. Fshati gjendet në të dyja anët e rrugës nga Dragashi në Brod, në një zonë të rrëpirë malore.

Një pjesë veriore e fshatit është duke u zhvilluar përreth shkollës. Për më tepër, zonat ndërtimore propozohen të lidhura me ndërtesat ekzistuese për të formuar një vendbanim më të dendur. Zgjerimi përgjatë rrugëve nuk duhet të lejohet. Zgjerimi në jug, si dhe zhvillimi i përbashkët i të dyja pjesëve kufizohet nga terreni. Gjithashtu, edhe shtrati i lumit shpallet si brez i gjelbër për t'u ruajtur nga ndërtimi.

Leshtan

Fshati i vogël dhe i largët në malet në juglindje të Dragashit është vendbanim i dendur, i koncentruar që shtrihet mes përrockave dhe një gjeografie mjaft kodrinore. Rruga drejt Dragashit është e shtruar dhe në gjendje të mirë, edhe pse rruga për Radeshë nuk është e shtruar dhe është e vështirë. I shtrirë përreth një sheshi kryesor, me një xhami që duket të jetë renovuar së voni, fshati ka grupe ndërtesash tradicionale lokale në gjendje të ndryshme, të cilat janë të rëndësishme për trashëgiminë kulturore.

Nuk duhet lejuar rritja e mëtutjeshme e fshatit afër lumenjve dhe afër rrëpirave në veri, lindje dhe perëndim të Leshtanit si dhe gjitha këto duhen ruajtur nga banimi. Zonat e ndërtimit gjenden të lidhura me zonat ekzistuese të ndërtimit, si dhe duhen «mbushur hapësirat» për të ruajtur karakterin e dendur të fshatit.

Mlikë

Fshati i vogël dhe kompakt gjendet në malet e ulëta të rajonit të Gorës, ku pjerrësia nuk është aq e madhe. Vendbanimi i dendur ka filluar të zgjerohet drejt veriut. Në jug, vendbanimi përfundon me një hapësirë më të gjerë afër xhamisë. Zona kryesore sociale e fshatit duket të jetë një fontanë në anë të rrugës, në skaj të oborrit të shkollës.

Qendra e fshatit do të mund të zgjerohet mes sheshit në shkollë dhe afër xhamisë, me një projektim të hapësirës së lirë. Ndërtimi duhet të bëhet në «hapësirat» mes ndërtesave ekzistuese afër xhamisë dhe në pjesën veriore të fshatit. Pylli i mbuluar, si dhe zonat e pjerrëta në perëndim e jug, si dhe livadhet e lumit në lindje, duhen ruajtur nga ndërtimi.

Vranisht

Ky fshat i vogël ka një grup shtëpish të reja dhe të vjetra, në rrëzë të maleve të rajonit të Gorës, ku pjerrësia nuk është aq e lartë. Një rrugë e asfaltuar përshkon fshatin, duke u hapur në një zonë qendrore publike. Në disa pjesë, vendbanimi është i dendur, por ai zgjerohet dhe shpërndahet në të dyja pjesët e rrugës.

Në Vranisht nuk është terreni i pjerrët ai që kufizon zgjerimin e banimit, por është vlera e lartë ekologjike e strukturave të peizazhit (lumenjtë e zabelet) si dhe toka pjellore, të dyja këto me disa funksione mbrojtëse. Për t'i ruajtur këto zona nga ndërtimi, ato shpallen breza të gjelbër. Zonat e propozuara ndërtimore janë ato «hapësira» mes zonave të ndërtuara, për të formuar një vijë kufitare të vendbanimit. Qendra e fshatit, sidomos pjesa e rrugës mes sheshit të përmendur dhe shkollës e xhamisë, ka nevojë të avancohet, me projektim të hapësirave të lira.

Pllavë

Gjendet në terren më të rrafshët (edhe pse më i pjerrët kah perëndimi), si dhe shtrihet afër rrugës rajonale mes Prizrenit dhe Dragashit. Ka një numër ndërtesash tradicionale, rurale, si dhe objektesh ndihmëse bujqësore, me fusha e kopshte, si dhe shtëpi më të mëdha me oborre përpara e prapa tyre. Ky vendbanim mjaft i dendur zgjerohet kah jugu dhe lindja. Në verilindje të fshatit, gjendet një fabrikë e mishit përgjatë rrugës rajonale.

Ky vendbanim ekzistues komercial gjendet në zonën komerciale të propozuar në rrugën rajonale, ku nuk duhet të ketë pjesë të banuar. Vendbanimi ka origjinën e tij në rrafshnaltë, kështu që ky është vendi për shtëpi të reja. Për të ndaluar shpërndarjen e mëtutjeshme, ndërtimi duhet të bëhet afër qendrës së fshatit, kryesisht si «mbushje e brendshme» e lagjeve të shpërndara me ndërtesa tjera. Brezat e gjelbër e rrethojnë fshatin në veri, perëndim dhe jug, për të ruajtur strukturën e peizazhit (lumenjtë dhe zabelet) dhe pjesët e rrëpishme nga ndërtimi. Dy sheshet në qendër të fshatit, tek shkolla dhe te bunari, duhen avancuar dhe lidhur me projektim të hapësirave të lira.

Rrenc

Ky është fshat i vogël përgjatë rrugës kryesore Prizren – Dragash, edhe pse gjendet më lart në një rrugë të thyer e të shtruar. Vendbanimi nuk është aq i dendur, me kopshte e fusha mes shtëpive. Shumica e shtëpive janë të ndërtuara rishtazi, edhe pse ka gjurmë të një vendbanimi më të vjetër në nivelet e poshtme të kodrës. Zhvillimet e reja janë duke ndodhur në zonat e rrafshta përgjatë rrugës kryesore në hyrje të fshatit.

Zgjerimi në drejtim të rrugës rajonale në veriperëndim dhe në lindje duhet ndaluar. Shtresa e vegjetacionit (korijet dhe kaçubet) kanë funksione të rëndësishme, si prodhimi i drurit, mbrojtja nga ortekët dhe mbrojtja e larmisë biologjike, si dhe shpallen si breza të gjelbër. Zonat ndërtimore gjenden në «hapësirat» mes zonave ekzistuese të ndërtuara.

Zlipotok

Ky fshat i largët gjendet në malet e Gorës në një pjesë të rrëpishme malore. Një rrugë me zhavorr çon nga Zlipotoku në Krushevë dhe Gllaboçicë, në rrugën Dragash - Restelicë. Përveç qendrës së dendur të fshatit, ku terreni është shumë i pjerrët, ka disa parcela më të mëdha në veriperëndim të fshatit. Kanë mbetur një numër shtëpish të vjetra, bashkë me lokacionin e një xhamie të vjetër, si dhe një pllakë guri.

Zgjerimi i mëtutjeshëm i vendbanimit bazë kufizohet me pjerrësi dhe rreziqe natyrore, kështu që zonat ndërtimore caktohen jashtë vendbanimit. Në vend të rritjes «së rreshtuar» përgjatë rrugëve, duhen krijuar grupime më të dendura. Brezat e gjelbër vendosen përgjatë lumenjve dhe shpateve më të rrëpinjta, si dhe në zonën e propozuar të Parkut Nacional në veri dhe lindje të fshatit.

Zym

Ky është fshati i parë në rrugën përmes luginës së Opojës. Ai ndahet në dy pjesë: një në veri të rrugës kryesore, ndërsa tjetra në jug. Ka një numër shtëpish tradicionale në pjesën veriore të fshatit, që formojnë një kompleks. Topografia është tejet e rrëpishme, ka disa shtëpi tejet të dendura e disa tejet të shpërndara, me fusha e kopshte të vogla. Një zonë e madhe e lirë (rreth një trugu të madh e të vjetër) rrugën jashtë fshatit, afër shkollës, është vendi i festivaleve dhe festave.

Kjo zonë dhe fushat vijuese në veriperëndim të fshatit shpallen si breza të gjelbër, për t'i ruajtur nga banimi, për të siguruar pamjen kah liqeni i Breznës dhe për të formuar një vijë të qartë kufitare të vendbanimit. Zonat e ndërtimit gjenden në lidhje me këtë hapësirë të gjelbër, për të përfituar nga pamjet. Për më tepër, ndërtimi duhet të vazhdojë natyrën e dendur origjinale të fshatit, pra ka «hapësira» për t'u mbushur. Ndërtimet përgjatë rrugës rajonale duhen shmangur, për shkak të trafikut në rritje.

Baçkë [fshat i largët]

Ky është një fshat i vogël i rrethuar me kullosa, shkurre e pyje, me një rrugë për qasje përgjatë gjithë gjatësisë së fshatit, që çon tek rruga kryesore Brod-Dragash. Vendbanimet shtrihen në paralele me rrugën kryesore poshtë pjesës kodrinore, duke krijuar një grup të vogël që lakohet përgjatë konturave të rrëpishme malore. Shtëpitë e pabanuara gjatë pjesës më të madhe të vitit janë problem. Infrastruktura është e dobët. Koncentrimi i shtëpive të vjetra të gurit dhe ahureve është i madh, por ato janë duke u shkatërruar për shkak të mosshfrytëzimit.

Për shkak të pjerrinave të mëdha, rreziqeve të mëdha të fatkeqësive natyrore dhe zonave pyjore me funksione të rëndësishme, i gjithë fshati rrethohet me një brez të gjelbër. Ka një zonë të vogël ndërtimi në jug të fshatit, për shkak të karakterit të fshatit dhe për shkak të gjendjes së vështirë të topografisë dhe popullsisë.

Dikanc [fshat i largët]

Fshati shtrihet pak përtej rrugës drejt Brodit, në rrëzë të luginës së lumit Brod. Dikanci është fshat i vogël i rrethuar me tokë të punuar e kullosa të gjera. Infrastruktura është e dobët. Ka një rënie shumë të rrëpishme drejt luginës pak përtej qendrës së fshatit. Qendra e fshatit është e konsiderueshme, me trungje e ulëse. Ndërtesat e vjetra janë kryesisht në gjendje të dobët.

Si në Baçkë, që gjendet në faqen tjetër të kodrës, pjerrinat e mëdha, rreziqet e mëdha të fatkeqësive natyrore dhe zonat pyjore me funksione të rëndësishme kufizojnë zgjerimin e madh. Por, edhe nevojat për zona banimi janë të vogla aktualisht. Ka një zonë të vogël ndërtimi të caktuar në jug të fshatit, ku topografia mundëson banimin. Zonat përreth caktohen si brez i gjelbër dhe duhen ruajtur nga ndërtimi.

Pllajnik [fshat i largët]

Ky është vendbanim i vogël, i dendur, në një lartësi të madhe në jug të luginës së Opojës. Gjendet mes lumit Pllajnik, me një përrockë që rrjedh drejt fshatit në pjesën kodrinore. Skaji i rrugës bie në mënyrë të rrëpishme kah lugina, ku ka vetëm një vijë të vetme të shtëpive që po ndërtohen. Ekziston një numër ndërtesash tradicionale të gurit, derisa qendra e fshatit është atraktive me format e saj të gurit natyror dhe burime.

Terreni mundëson vetëm një drejtim të zgjerimit - në rrafshnaltë në lindje prej fshatit - ku është propozuar një zonë ndërtimi. Fushat veriore, perëndimore dhe jugore që e rrethojnë vendbanimin janë shumë të rrëpirëta dhe vegjetacioni ekzistues është i një rëndësie të lartë për mbulim të tokës dhe për të minimizuar rreziqet natyrore. Për këtë arsye këto zona janë shpallur si breze të gjelbërta.

Orçushë [fshat i largët]

Ky është fshat i largët në malet afër kufirit me Shqipërinë. Nuk ka ndonjë lidhje mes kufijve me rrugë, por ka një shteg që çon përtej kufirit. Fshati i vogël qëndron në një shpat të rrëpishëm të ekspozuar kah jugu-perëndimi, grupuar përreth fundit të një rruge të pashtuar, e në gjendje shumë të keqe. Në bazën e fshatit, ekziston një koleksion interesant i ndërtesave të vjetra.

Për shkak të shpateve, rreziqeve ekzistuese të fatkeqësive natyrore dhe shtresës bimore që duhet ruajtur, nuk ka shumë hapësirë për zgjerim. Por, nuk ka as nevojë, për shkak të numrit të vogël të banorëve dhe tendencës në zvogëlim. Një mundësi për zona banimi ekziston në perëndim dhe lindje të fshatit, në lidhje me zonat ekzistuese të banuara. Zona përreth shënohet si brez i gjelbër dhe duhet ruajtur nga banimi.

Xërxe [fshat i largët]

Rruga drejt Xërxe është pjesërisht e shtruar, edhe pse pjesët e epërme të fshatit nuk janë të shtruara; këto rrugë janë në gjendje tejte të keqe. Është fshat i vogël dhe i largët në malet në

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

verilindje të Dragashit. Shtëpitë janë të shpërndara në 20 hektarë, me shumë pak ndërlidhje apo afërsi mes tyre.

Ky akumulim i përçarë i shtëpive, sipas situatës së vështirë topografike, duhet ndaluar. Ka pak nevojë për shtëpi të reja, të cilat mund të sigurohen në afërsi të vendbanimit bazë, ku caktohen zonat e ndërtimit. Njësitë tjera banesore pa lidhje me bazën historike të fshatit rrezikojnë të ndahen dhe të humbin unitetin e banorëve. Për më tepër, ato njësi vendosen në shpate të rrëpinjta dhe zona të rrezikshme. Këto caktohen si breza të gjelbër.

8.3 Ekonomia vendore

Synimet e përgjithshme
Përmirësimi i punës së komunës në fushën ekonomike, sa i përket punësimit dhe të ardhurave për popullsinë, përmes valorizimit të pasurive lokale, organizimit të tyre në zinxhirë vlerash, si dhe zhvillimi i kapaciteteve për të konkurruar, duke siguruar mjedis të qëndrueshëm në aspektin afatgjatë, zhvillim shoqëror dhe barazi gjinore.
Qëllimet
<ul style="list-style-type: none">• Krijimi i lidhjeve ndërmjet prodhuesve dhe komunës, ndërmjet drejtorive komunale (ekonomi, bujqësi, arsim, etj.), ndërmjet komunave fqinje me Dragashin dhe mundësisht bashkëpunimi me nivelin qeverisës qendror.• Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrencës së produkteve endogjene, me theks të veçantë produkteve me ndikim potencial për zhvillim afatgjatë, siç janë produktet e bletëve, qumështi, mishi, bimët, produktet malore, frutave malore dhe kërpudhave, si dhe sistemi kulturor dhe turistik.• Themelimi i një mekанизimi për ofrimin e shërbimeve për ndërmarrës, prodhues, qytetarë, organizatat e shoqërisë civile, dhe institucioneve publike, për sigurimin e një zhvillimi socio-ekonomik të qëndrueshëm.• Dizajnimi, realizimi dhe sigurimi i fondeve për projekte me përparësi në fushën e infrastrukturës.• Realizimi i një fushate të suksesshme reklamuese për përmirësimin e imazhit të vendit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar, si dhe për tërheqjen e burimeve të jashtme që duhen përdorur në harmoni me udhëzimet strategjike të përbashkëta.• Përmirësimi i kapacitetit për planifikim të zhvillimit ekonomik.
Veprimet
A) Krijimi i lidhjeve për sistemin ekonomik A1) Mbështetja për shoqatat ekzistuese të prodhuesve dhe promovimi i shoqatave të reja në sektorin e ekonomisë (bletarët, blegtorët, qumështoret, etj.) A2) Promovimi i forumeve të zinxhirëve të vlerës me pjesëmarrje të përfaqësuesve të shoqatave prodhuese dhe tregtare me funksion kryesor të: <ul style="list-style-type: none">• Zhvillimin e vazhdueshëm të udhëzimeve strategjike,• mbajtjen e kohezionit dhe koherencës në mesin e prodhuesve në zbatimin e planit strategjik, A3) Themelimi i një forumi komunal për zhvillim ekonomik dhe planifikim, me përfshirjen e komunës, përfaqësuesve të zinxhirëve të vlerës, ekspertëve, me qëllim të këmbimit/ndarjes së prioriteteve të strategjive vjetore dhe strategjive afatmesme dhe planeve rreth zhvillimit ekonomik lokal, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre. A4) Hartimi i marrëveshjeve për bashkëpunim ndër-komunal me komunat fqinje.
B) Përmirësimi i suksesit dhe konkurrencës ekonomike B1)) Përmirësimi i punës në zinxhirët e vlerës të bletëve, pyjeve, bimëve, mishit dhe qumështit përmes: <ul style="list-style-type: none">i. Përmirësimin të prodhimit, si dhe nëpërmjet prezantimit të inovacioneve dhe teknikave të reja të prodhimit,ii. Shfrytëzimi i të gjitha potencialeve ekonomike, nëpërmjet prezantimit të bizneseve të reja

për diversifikimin e produkteve.

- iii. përmirësimi i strategjive reklamuese për rritjen e pagave në nivel lokal, shtetëror dhe të paktën rajonal (të Ballkanit).

B2) Për zinxhirin e tekstilit dhe rrobave:

- i. Stimulimi për themelimin e ndërmarrjeve të reja për ngritjen e njohurive aktuale dhe potencialin konkurrues, dhe shpërndarjen e njohurive,
ii. shtjellimi i udhëzimeve strategjike të nivelit të parë.

- B3) Përmirësimi i përdorimit ekonomik dhe shoqëror të burimeve turistike të Dragashit përmes sistemit turistik lokal, duke u bazuar në ndërveprimin ndërmjet nënsistemeve të tërheqësve – mikpritjes-shërbimeve-prodhimeve, të udhëhequra prej nënsistemit të kontrollit.

C) Krijimi i një mekanizmi për ofrimin e shërbimeve për zhvillimin ekonomik lokal

- C1) Krijimi i një mekanizmi për ofrim të shërbimeve të vazhdueshme për zhvillim ekonomik, me prioritet për ngjalljen ekonomike (stimulimi i akterëve lokal për përmirësim të shfrytëzimit të resurseve lokale, stimulimi dhe mbështetja e rrjeteve lokale dhe shoqatave, ofrimi i informatave; qasje në financa (për ngritjen e fondeve të bizneseve, pa ndëshkim për komunitetin); asistencën teknike (asistencë për përgatitjen e planeve të biznesit për qasje në kreditë bankare, për përmirësim të prodhimit dhe konkurrencës, komercializimit, higjiena e kafshëve, kontrolli i cilësisë), trajnimet profesionale, zhvillimi i projekteve; mbështetje për inovacione (përmirësimi i kapaciteteve për identifikimin dhe mbështetjen me teknologji informative, si dhe praktikave të mira ekzistuese në Kosovë apo jashtë saj dhe adoptimi i tyre).
- C2) Ky mekanizëm do të jetë i vetë-qëndrueshëm, dhe duhet përfshijë shërbime aktuale si dhe shërbime të reja. Duhet ta ketë një bordh menaxhues (me përfaqësues të partnerëve lokal), dhe strukturë të aftë teknike.
- C3) Mundësimi i një periudhe fillestare të qëndrueshme, duke financuar punën gjatë dy viteve të para, si dhe shtjellimi i planit financiar pesë-vjeçar.
- C4) Krijimi i mekanizmit financiar, si fond garantues, për të lehtësuar qasjen në financa për ndërmarrësit, popullsinë dhe prodhuesit që kanë vështirësi në marrjen e kredive bankare.
- C5) Përmirësimi i kapaciteteve të bordit administrativ dhe strukturës teknike

D) Dizajnimi, realizimi dhe mbledhja e fondeve për projekte me përparësi në fushën e infrastrukturës

Projekte të tilla përfshijnë:

- D1) Hapësira për organizim të panairëve dhe ngjarjeve
D2) Menaxhimi i mbeturinave
D3) Laboratorë për kontroll të cilësisë
D4) Qendra informative turistike
D5) Zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës

E) Realizimi i reklamimit të suksesshëm territorial

- E1) Përkufizimi i personalitetit shoqëror-ekonomik të komunës, përmes përcaktimit dhe harmonizimit të veçorive kryesore territoriale, si pozita gjeografike dhe karakteri morfologjik, kapitali shoqëror, sektori prodhues dhe veçoritë e tregut, shkëmbimet ekonomike dhe kulturore me jashtë, trashëgimia kulturore, fryma vendore, sistemi i vlerave shoqërore dhe qytetare, sistemi i shërbimeve, infrastruktura dhe niveli i njohurive rreth zhvillimit ekonomik e shoqëror.
- E2) Përkufizimi i imazhit që akterët lokalë dëshirojnë të paraqesin brenda dhe jashtë vendit, mundësisht duke e ndarë atë me komunat fqinje dhe duke krijuar llogot përkatëse.

E3) Përkufizimi i instrumentet e komunikimit për përhapje më të mirë të profilit dhe imazhit vendor, për reklamim dhe tërheqje të investimeve nga Balkani dhe Evropa..

E4) Përmirësimi i shkathtësive të teknologjisë informative përmes një marrëveshjeje me ndonjë universitet për një program arsimor rreth kësaj çështjeje.

F) Përmirësimi i kapaciteteve në planifikim të zhvillimit ekonomik

F1) Realizimi i një programi (kursi) 180 orësh të përgatitur nga universiteti mbi Zhvillimin Ekonomik Lokal dhe Planifikim, me synim të përmirësimit të njohurive të shërbyesve civil dhe komunitetit. Kursi i parë të dedikohet për trajnimin e trajnerëve në nivel universitar dhe qeverisës, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Modulet do të ishin si në vijim:

- Moduli 1: Zhvillimi ekonomik territorial (ZhET) dhe globalizimi (10 orë)
- Moduli 2: Strategjitë zhvillimore territoriale: mjetet për analiza, hartëzimi, dhe korniza strategjike (45 orë)
- Moduli 3: Qeverisja për zhvillim ekonomik territorial (25 orë)
- Moduli 4: Planifikimi i zhvillimit ekonomik territorial (30 orë)
- Moduli 5: Shërbimet për zhvillim ekonomik (40 orë)
- Moduli 6. Marketingu territorial (30 orë).

Planifikimi i mëtejshëm

- Qeverisja: Plani zhvillimor vjetor për vitin vijues, nëpërmes themelimit të forumit komunal, dhe krijimi i një sistemi vlerësues dhe monitorues.
- Konkurrenca:
 - Plani për realizimin e udhëzimeve strategjike (sipas zinxhirit të vlerave),
 - Plani i hulumtimit, me qëllim të përditësimit të vazhdueshëm të Analizës së Burimeve, si dhe të udhëzimeve strategjike të nivelit 1 dhe më lart (strategjitë përfshirëse),
 - Cilësia (ONS), ushqimi i sigurt (PKKAR), çertifikimi që dhëshmon se ushqimi është organik dhe hallall.
- Shërbimet: Fuqizimi i mbështetjes së tregtisë ndërkombëtare dhe nismave.
- Reklamimi territorial: Krijimi i markës territoriale dhe konkurrimi në nivel të paktën rajonal dhe evropian.

Përgjegjësia / korniza institucionale

- Komunës së Dragashit i takon përgjegjësia të miratojë planin dhe të bashkërendojë realizimin e tij në harmoni me institucionet pjesëmarrëse në Forum, si dhe me qeverinë e vendit. Komuna gjithashtu duhet të ndihmojë në themelimin e një sistemi përfshirës shërbimesh mbështetëse, mundësisht në bashkëpunim me komunat fqinje.
- Forumi i zhvillimit ekonomik të Dragashit (FoZED), në përbërje të komunës dhe përfaqësuesve të sektorit prodhues dhe civil, më qëllim të vënies së synimeve dhe përparësive të zhvillimit, si dhe të monitorimit.

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<ul style="list-style-type: none"> • Forumet e zinxhirëve të vlerave, që kanë për detyrë të përkrahin angazhimet e përbashkëta të akterëve që marrin pjesë dhe i përfaqësojnë këtë angazhime në FoZED. • Qeveria e vendit (ministritë e bujqësisë, pylltarisë, turizmit, ekonomisë), të cilës i takon të bashkërendojë veprimet me komunitatet. • Sektori privat si forcë shtytëse kryesore e ekonomisë, siç është e përfaqësuar nga asociacionet e sektorëve të ndryshëm. 	
Afati kohor	Implikimi financiar
<p>Projektet prioritare (masat afatshkurta)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkrahja e Shoqatave ekzistuese të prodhuesve dhe promovimi i shoqatave të reja (A2) • Themelimi i FORUMIT KOMUNAL për zhvillim ekonomik dhe planifikim (A4) • Realizimi i projekteve prioritare të infrastrukturës që kanë të bëjnë me hapësirë për evenimente, menaxhim të mbeturinave, kontroll të cilësisë, zhvillim të turizmit dhe zinxhirit të vlerave (D) 	<p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>i lartë</p>
<p>Masat afatmesme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Themelimi i këshillit ndër-sektoral komunal për zhvillim ekonomik (A1) • Promovimi i Forumeve të Zinxhirit të vlerës (A3) • Përmirësimi i performancës të zinxhirëve kryesorë të vlerës (B1, B2) • Përpunimi i strategjive të nivelit të lartë (B3) • Përmirësimi i turizmit (B4) • Sigurimi i përkrahjes për organizim dhe fillim të partneriteteve publike-private (C1-C3) • Themelimi i Fondit Garantues për lehtësimin e qasjes në financa (C4) • Përcaktimi i personalitetit socio-ekonomik komunal dhe imzhit për marketing territorial (E1, E2) 	<p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>i lartë</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>i ulët</p>
<p>Masat afatgjate</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i marrëveshjeve për bashkëpunim ndër-komunal për sinergji në prodhim, marketing dhe kontroll të cilësisë (A5) • Organizimi i Konferencës vjetore Shtet-Komunë (A6) • Vlerësimi i mundësive dhe përpunimi i udhëzimeve strategjike për institucionin e Sistemit Lokal Kulturor produktiv (B5) • Përmirësimi i kapaciteteve të këshillit menaxhues dhe strukturave teknike (C5) • Përcaktimi i instrumenteve të komunikimit dhe përmirësimi i teknologjisë së komunikimit për shpërndarjen e profilit dhe imzhit 	<p>i ulët</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>i lartë</p>

territorial (E3, E4)	
Vlerësim	
<p>Parashihet një lloj ndikimi në mjedis, që ka të bëjë me zhvillimin e mjedisit. Këtu përfshihen projektet infrastrukturore dhe përmirësimi i turizmit. Ruajtja e natyrës nuk duhet të kufizojë zhvillimin komunal në përmirësimin e ekonomisë dhe turizmit, për në pajtim me kornizën e zhvillimit hapësinor, ndikimet negative do të mbahen në minimum. Pastaj, strategjia për zhvillimin lokal ekonomik i merr parasysh çështjet e mjedisit. Përkrahja e traditave ekzistuese bujqësore do të mbrojtë florën dhe faunën e veçantë, si dhe trashëgiminë kulturore në Dragash.</p> <p>Zhvillimi socio-ekonomik do të përkrahet me këtë strategji.</p>	

Arsyet

Komuna e Dragashit mund të karakterizohet më saktë, bazuar në qasjen LEADER të Bashkimit Evropian, si një zonë me biodiversitet, e cila ka disa diferencime, potencial për atraksione kulturore dhe turistike, si dhe si zonë kufitare. Si zonë ka disa probleme në mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin më të mirë të trashëgimisë natyrore dhe njerëzore, probleme me konkurrentshmërinë e produkteve, papunësinë, varfërinë dhe migrimin.

Në përgjithësi, strategjitë e mundshme për zona të ndryshme janë si më poshtë:

- strategjitë plotësuese në zona që veç janë konkurrense;
- strategjitë përfshirëse dhe kritike në vende të copëzuara, pa traditë apo kulturë bashkëpunimi, të dobësuara për shkak të mungesës së instrumenteve të bashkërendimit;
- strategjitë për diversifikim dhe shkrirje në vende ku ka trende negative të konkurrencës (sektorët e zhvilluar me faktorë krahasues, por jo përparësi konkurrense);
- strategjitë e rimëkëmbjes dhe ri-valorizimit në vende ku burimet dhe zanatet tradicionale janë në zhdukje, por ku ka potencial për konkurrencë;
- strategjitë ribalancuese në vende ku zhvillimi është përqendruar në një pjesë të vendit, përderisa në pjesë të tjera ka rënie;
- strategjitë e mbështetjes, përhapjes dhe ngjalljes në vende ku ka shpërngulje masive apo izolim, ku ekziston trendi për braktisje të bujqësisë dhe mbyllje të ndërmarrjeve të mbetura, si dhe ku ka nevojë për të shfrytëzuar strategji krijimtari.

Në rastin e Dragashit është kombinuar strategjia e përfshirjes me atë të ngjalljes, që shprehet përmes realizimit të ekonomisë së qëllimshme (zinxhirët e vlerave), krijimit të lidhjeve ndërmjet akterëve dhe institucionet në nivel komunal dhe me komunat e tjera, si dhe përkrahjes së angazhimeve kolektive përmes ndihmës teknike. Qëllimi është që të ketë dinamizëm të ri, duke i rikthyer popullatës vendëse besimin në vlerën e pasurive dhe aftësinë e tyre për angazhim dhe krijimtari. Përhapja e gjallërimit çon në veprimtari të gjera që synojnë të mbështetin idetë dhe projektet e reja, si dhe t'i japin një imazh të dallueshëm Dragashit dhe vendit të Kosovës. Kjo do të ulte varësinë nga ndryshimet e jashtme dhe do ta rriste konkurrencën përmes ekspertizës në treg, larmisë së prodhimeve dhe shtimit të prodhimit dhe cilësisë.

Kjo strategji duhet të mbështetet nga qasje plotësuese për të pasur sukses afatgjatë, duke përfshirë:

- qasjen pjesëmarrëse, përmes përfshirjes së akterëve publikë dhe shoqërorë në procesin e vendim-marrjes.
- përqendrimin në zhvillimin njerëzor dhe synimet zhvillimore të mijëvjeçarit: kjo nënkupton që "synimi kryesor i zhvillimit është të rritë lirinë e njerëzve me anë të një procesi që rrit shkathtësitë

personale, duke rritur edhe mundësitë që njerëzit të jetojnë një jetë të plotë dhe kreative. Synimet zhvillimore të mijëvjeçarit në veçanti nënkuptojnë jetën e gjatë dhe të shëndetshme, arsimin, qasjen në burimet që nevojiten për jetë të ndershme, si dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të bashkësisë.

- zvogëlimin e pabarazisë dhe përjashtimit, me qëllim të shpërdarjes më të mirë të burimeve, duke marrë për bazë situatën e përjashtimit shoqëror të popullatave të ndryshme.
- zvogëlimin e pabarazisë gjinore: përfshin zvogëlimin e hendekut ndërmjet grave dhe burrave, duke treguar ndikimet e ndryshme të konfliktit në sektorë të ndryshëm të popullsisë, si dhe të mohimit të zgjedhjeve dhe lirive të grave; dhe angazhimin e tyre dhe të shtresave të tjera të dobëta të popullatës, për përmbushjen e nevojave dhe interesave të tyre.
- mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore, që është e nevojshme për të siguruar mirëqenien e popullsisë së tanishme dhe të ardhshme, si dhe zhvillimin e pasurive.

Pasuritë në dispozicion dhe përparësitë garuese

Mundësia e komunës për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe garues qëndron në pasuritë e ndryshme si bletët, bimët, prodhimet e pyllit, blegtoria (qumështi dhe mishi), tekstili, kultura dhe turizmi.

Në përgjithëse, përparësia garuese e saj qëndron në qëndrueshmërinë mjedisore të brendshme; në shanset për prodhimtari të madhe përmes bujqësisë, për shkak të veçorive të brendshme të farave vendëse; në shanset për rritje të llojeve të ndryshme të një prodhimi, për shkak të hapësirave të gjera të bujqësisë që u takojnë ekosistemeve të ndryshme; në cilësinë e njohur të prodhimeve, meqë rajoni i Sharrit njihet për biodiversitetin e tij; dhe në pozitën gjeografike kufitare.

Ka edhe vlera të veçanta për secilin zinxhir të vlerave.

Shërbime për mbështetje të zhvillimit ekonomik ka pak, përveç drejtorisë komunale të bujqësisë dhe turizmit.

Ekziston një grup veprues lokal (GVL), por ai nuk është vërtet funksional. Ai ka vetëm një anëtar, që realizon disa projekte në baza vullnetare. Në letër thuhet që ai përbëhet prej 25 anëtarësh, por ata janë individë dhe jo përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Kjo varet nga komuna, por drejtoria komunale nuk e mbështet fare. Ai i ka realizuar disa projekte të vogla, por puna e tij nuk e ndihmon edhe aq zhvillimin ekonomik dhe rural.

Pengesat

Pengesat kryesore janë:


- niveli i ulët i prodhimtarisë, për shkak të numrit të vogël të banorëve, ndërmarrësve dhe prodhuesve; vëllimit të vogël të prodhimtarisë; dhe vështirësisë në organizimin e shërbimeve të përshtatshme.
- njohuritë e pakta rreth ekosistemeve;
- mungesa e shkathtësive teknike të përshtatshme;
- mungesa e pajisjeve të përshtatshme;
- cilësia e dobët e kapitalit territorial ndërveprues;
- mungesa e organizimit të sipërmarrjeve;
- cilësia e dobët e marrëdhënieve të brendshme;
- mungesa e marrëdhënieve të jashtme (me zinxhirët e tjerë të vlerave);

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

- mungesa e njohurive për tregun;
- niveli i ulët të çertifikimit (ONS, PKKAR, vlerat organike, hallall) të prodhimeve;
- mungesa e sistemit të njësuar për administrim të mbeturinave;
- mungesa e sistemit të njësuar për administrim të ujit; dhe
- mungesa e shërbimeve për përmirësim të punës ekonomike lokale.

Strategjia e mësipërme e zhvillimit ekonomik synon zvogëlimin e pengesave të valorizimit të plotë të pasurive të brendshme, si mjet për përmbushjen e synimeve të rritjes së punësimit dhe të të ardhurave të popullatës, si dhe të përmirësimit të kapacitetit garues, duke i kushtuar rëndësi ruajtjes së mjedisit dhe barazisë shoqërore e gjinore.

4 hapat strategjikë për realizimin e këtyre synimeve paraqiten në ilustrimin e mëposhtëm; në bazë të tyre është përgatitur plan-veprimi strategjik.



8.4 Rrjeti rrugor, Transporti

Qëllimet e përgjithshme
<p>Përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit rrugor dhe transportit publik janë elemente kyçe në tejkalimin e largësisë gjeografike të Dragashit/Dragaš në tërësi dhe të fshatrave të tij. Kjo do të përmirësojë jetesën, do të përkrahë ekonominë lokale duke ofruar qasje më të mirë në tregje, si dhe do të promovojë turizmin. Mirëmbajtja e përmirësuar e rrugëve do të sigurojë që investimet të jenë afatgjata. Lidhur me mjedisin dhe parkun nacional në Dragash, disa rrugë të caktuara, që do të prodhonin ndikim të madh, nuk do të realizohen.</p>
Objektivat
<ul style="list-style-type: none">• Rrjeti i përmirësuar rrugor lokal do të ofrojë qasje të sigurt, të shpejtë dhe të qëndrueshme në fshatra.• Rrjeti rrugor dhe transporti publik në drejtim të Prizrenit, si qendër rajonale, do të forcohet.• Vijat kufitare për në Shqipëri dhe iRJM do të lejojnë qarkullim të kontrolluar ligjor të mallrave dhe njerëzve; lidhjet e reja ndërkufitare do ta lidhin Dragashin me rrjetin rrugor të të dyja vendeve.• Transporti publik do të ofrojë lidhje të rregullta, të leverdishme dhe të rehatshme mes qytetit të Dragashit, nënqendrat komunale dhe Prizrenit.• Mirëmbajtja e përmirësuar e rrugëve do të sigurojë që investimet janë afatgjata dhe të qëndrueshme.• Procesi i planifikimit dhe vendimmarrja për projektet rrugore do të përfshijë analiza të ndikimit mjedisor dhe pajtueshmëri me parkun nacional.
Veprimet
<p>Të nisen konsultime me autoritetet nacionale dhe lokale nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia lidhur me alternativat për përmirësimin e rrjetit rrugor ndërkufitar.</p> <p>Të koordinohen proceset e planifikimit për rrjetin rrugor, duke i konsideruar planet e përgjithshme zhvillimore në të gjitha komunat. Të kryhen studime ndërnacionale të fizibilitetit për projekte të tilla.</p> <p>A) Rrjeti lokal rrugor:</p> <ul style="list-style-type: none">A1) Të shtrohen rrugët që lidhin fshatrat Leshtan dhe RadeshëA2) Të shtrohet rruga që lidh fshatin Lubovishtë me rrugën rajonale Dragash – BrodA3) të ndërtohet një rrugë e re lokale që lidh Brodin dhe Restelicën: Të elaborohet planifikimi për një rrugë të re ndërmjet Brodit dhe Zlipotokut, të funksionalizohet rruga nga Zlipotoku për në rrugën rajonale Dragash – RestelicëA4) Të ndërtohet një rrugë anësore për në Brrut dhe Zgatar <p>B) Rrjeti rajonal rrugor:</p> <ul style="list-style-type: none">B 1) Të zgjerohet rruga rajonale ekzistuese Dragash – Prizren përmes Zhurit, të përmirësohet shpejtësia dhe siguria e udhëtimit përmes zgjerimit të pjesshëm në tri korsi dhe përmirësimin të pjesshëm të balancimit të rrugës(përshtatjes).B 2) Të zgjerohet rruga ekzistuese rajonale Dragash – Brod deri në dy korsiB 3) Të ndërtohet një qasje e dytë në rrugë në mes Dragashit dhe Prizrenit përmes Zaplluxhes

dhe Lez duke e përmirësuar dhe shtruar rrugën ekzistuese të shtruar me zhavorr

B 4) Të elaborohet planifikimi për dhe të ndërtohet një rrugë anësore për në Restelica/Restelicë

B 5) Ndërtimi i rrugës së re që lidh Brodin dhe Restelicën: Elaborim i planifikimit të rrugës së re Jug të Brodit drejt Restelicës përgjat shtigjeve tradicionale

C) Lidhjet ndërkufitare:

C 1) Të krijohet një lidhje ndërkufitare afër Orçushës duke e shtruar rrugën ekzistuese për Orçushë dhe duke e mbyllur boshllëkun me pikën ekzistuese kufitare në kufirin e Shqipërisë

C 2) Të shtrohet rruga ekzistuese nga Krusheva për në pikën ekzistuese kufitare në kufirin e Shqipërisë.

C 3) të shtrohet rruga ekzistuese me zhavorr nga Restelica për në kufirin e Maqedonisë

C 7) të vlerësohet fizibiliteti i një lidhjeje ndërkufitare nga rruga rajonale Dragash – Prizren përgjatë Lumit Plavë për në kufirin e Shqipërisë, duke e shfrytëzuar lartësinë e ultë mbidetare 800 – 900 m (potencialisht lidhje e rëndësishme rajonale për në autostradën ndërkombëtare).

D) Rrjeti rrugor bujqësor:

D 1) të zgjerohen rrugët lokale / shtigjet që çojnë në toka punuese për ta ngritur efikasitetin e përdorimit të tokës dhe bujqësinë.

E) Mirëmbajtja:

E 1) Të krijohet një njësi në administratën komunale që është përgjegjëse për mirëmbajtje të rrugëve dhe që ka buxhet dhe ekspertizë teknike për ta përmbushur detyrën me kujdes.

E 2) të monitorohet situata e rrugëve rregullisht; të kryhen punë riparuese sapo të jetë e nevojshme për të shmangur dëmtime në të mëdha.

F) Transporti publik

F 1) të përmirësohet shpeshtësia dhe oraret e autobusëve publik me bashkërendim përmes komunës

F 2) të përmirësohet lidhja me transportin publik veçanërisht në rajonin e Gorës, të përkrahet sistemi ekzistues i udhëtimit të përbashkët duke krijuar një sistem rezervimi të udhëtimit të asistuar nga interneti ndërmjet Dragashit - Restelicës dhe Dragashit – Brodit. (që mund të shfrytëzohet nga turistët gjithashtu)

F 3) të ndërtohen stacione (vendndalime) autobusi në pika të rëndësishme (në Dragash/Dragaš, në udhëkryqin Dragash - Prizren / Dragash – Zaplluxhe, ...)

G) Projektet e rrugëve që nuk duhet të realizohen:

G 1) projekti i rrugës për lidhje ndërkufitare nga Brodi për në Maqedoni që kalon nga Liqeni Shutmann

G 2) Projekti i rrugës për kalim kufitar nga Zaplluxhe në drejtim të kufirit të Maqedonisë (në Malin Skarpë në lartësi prej 2474 m)

G 3) Projekti për rrugë nga kufiri në kufi nga kufiri i Shqipërisë afër Krushevës (pika kufitare ekzistuese) për në kufi të Maqedonisë në jug të Restelicës (trase e re pa shfrytëzim të rrugëve ekzistuese, që kalon në përfundim të Restelicës në lartësi më të madhe)

Planifikimi i mëtejshëm	
<ul style="list-style-type: none"> Planifikimi për rrugë rajonale ka nevojë për bashkërendim me autoritetet nacionale. Zhvillimi komunal mund vetëm t'i shprehë dëshirat komunale, por përgjegjësia qëndron tek Ministria e Transportit dhe Komunikacionit. Planifikimi i rrugëve ndërkufitare ka nevojë për konsultime si me autoritetet nacionale dhe lokale nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Bashkërendimi i procesit të planifikimit për rrjetin rrugor, duke i pasur parasysh planet e përgjithshme zhvillimore në të gjitha komunat. Të kryhet studimi ndërnacional i fizibilitetit për projekte të tilla. Krijimi i rrugëve të reja kërkon planifikim të hollësishëm, duke filluar me studime të fizibilitetit. Të hartohen plane për një sistem efikas të transportit me bashkërendim të destinacioneve, drejtimeve, orareve të autobusëve. 	
Përgjegjësia	
<p>Përmirësimi i rrjetit të rrugës dhe transportit publik do të ketë nevojë për bashkëpunim në nivel nacional dhe komunal, si dhe partneritet publik-privat</p> <ul style="list-style-type: none"> Rrjeti i rrugëve lokale është nën përgjegjësi të komunës. Rrjeti i rrugëve rajonale është nën përgjegjësi të Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit. Dispozitat ligjore lidhur me trafikun ndërkufitarë duhet të miratohet në nivel nacional. Transporti publik kryhet nga kompani private, por komuna do të luajë një rol të madh në bashkërendim. 	
Afati kohor	Implikimi financiar
<p>Projktet priritare (masat afatshkurta)</p> <ul style="list-style-type: none"> Zgjerimi i rrugës ekzistuese rajonale (Dragash – Prizren përmes Zhurit) (B1) Ndërtimi i hyrjes së dytë rrugore në mes Dragashit dhe Prizrenit via Zaplluxhes (B3) Hapja e rrugës ekzistuese nga Krusheva drejt stacionit ekzistues kufitar në kufirin e Shqipërisë (C2) Hapja e rrugës ekzistuese me zhavorr prej në Restelicë drejt kufirit me iRJM. (C3) Instalimi i njësisë administrative të Komunës, përgjegjëse për mirëmbajtje (E1) 	<p>mesatar i ulët i ulët i lartë mesatar</p>
<p>Masat afatmesme</p> <ul style="list-style-type: none"> Hapja e rrugëve lokale (A1, A2) Zgjerimi i rrugës ekzistuese Dragash – Brod (B2) Elaborimi i planifikimit për ndërtim të rrugës tranzitore për Restelicë (B4) 	<p>i ulët mesatar i lartë</p>

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<ul style="list-style-type: none"> • Përpunim i planifikimit për ndërtimin e një lidhjeje të re rrugore Brod – Restelicë (B5) • Kryerja e një studimi të mundësive (fizibilitet) për lidhjen ndërkufitare përgjat lumit të Plavës (C4) • Organizim dhe realizim i mirëmbajtjes së vazhdueshme (E2) • Përmirësimi i transportit publi në rajonet Opojë dhe Gorë (F1, F2) 	<p>i lartë</p> <p>i lartë</p> <p>mesatar</p> <p>i ulët</p>
<p>Masat afatgjata</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtim i një lidhjeje të re rrugore Brod – Zlipotok – Restelicë (A3) • Ndërtimi i një rruge tranzitore ëpr Brrut dhe Zgatar (A4) • Krijimi i lidhjes ndër-kufitare pranë Orçushës (C1) • Përmirësimi i rrjetit rrugor bujqësor (D) • Ndërtimi i stacioneve të autobusit në ndalesa të rëndësishme (F3) 	<p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p>
<p>Vlerësim</p>	
<p>Në kuadër të projekteve rrugore, ndikimi i mjedisit është i pashmangshëm. Megjithatë, ndikimet negative mund të zvogëlohen kur merret parasysh aspekti i mjedisit, ashtu siç është bërë edhe në këtë strategji.</p> <p>Në rastin e zhvillimit socio-ekonomik, përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve do të shtojë qasjen në Dragash dhe lëvizshmërinë e qytetarëve të tij. Ndikimet negative që kanë të bëjnë me zhurmën e trafikut nuk priten për momentin por duhet të merren parasysh.</p>	

Arsyet

Gjendja fizike e rrugëve ekzistuese është përmirësuar mjaftë gjatë viteve të kaluara. Është jetike që të sigurohet ky sukses dhe që ka mirëmbajtje të vazhdueshme të rrjetit të rrugëve. Gjendja me kalimet ndërkufitare është ende e vështirë; Dragashi po vuan nga vijat e gjata kufitare që nuk lejojnë qarkullim të ligjshëm të njerëzve dhe mallrave. Për më tepër, e vetmja rrugë për qasje në Prizren nuk është në gjendje të mirë (shih gjithashtu Kapitulli 3, Profili Komunal).

Një listë e gjatë e projekteve rrugore është raportuar nga komuna. Veç kësaj, ka nevojë për kalime anësore në rrugë për në Restelicë dhe për Brrut dhe Zgatar. Të gjitha këto projekte janë vënë në hartë dhe janë vlerësuar. Nuk ka qenë e mundur të kryhen studime të hollësishëm të fizibilitetit për këto projekte për shkak të nivelit të planifikimit të rrugëve. Në mënyrë që të jepet rekomandim gjithëpërfshirës rreth asaj se sa praktike janë projektet dhe për prioritetet për zbatim, projektet rrugore u vlerësuan bazuar në pozitën e tyre në rrjetin rrugor, nivelin e kostos, ndikimin mjedisor dhe efektet e tyre ndarëse Brenda Parkut nacional.

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Tabela 1: Vlerësimi i projekteve rrugore.

Pro- jekti	Emri	Tipi	Larësia mbidetare	Gjatësia	Vlera e shtuar	Kosto ja	Mospajti met Parku Nacional	Mospajtim et Biodiversitet	Vlerësimi final	Rekomandim	Prioritet
B1	Prizren-Dragash	Përmirësi m	920-1020	11.844	1	3	1	3	2	Realizim	x
B3	Zaplluxhe-Prizren	Përmirësi m	1170-1250	2.524	2	2	1	3	2	Realizim	x
C2	Krushevë-Shqipëri	Përmirësi m	1140-1405	3.226	1	2	3	3	2	Realizim	x
A1	Radeshë-Leshtan	Përmirësi m	1050-1100	449	4	2	1	1	2	Realizim	
A2	Lub-REG	Përmirësi m	1144-1150	1.948	4	1	1	1	2	Realizim	
A4	Tranzit_Zgatar	Përmirësi m	1280-1360	2.497	3	2	1	2	2	Realizim	
B2	Dragash-Brod	E re / përmirësi m	950-1120	3.174	2	3	2	3	2	Realizim	
C1	Orçushë-Shqipëri	Përmirësi m	1020-1380	12.420	2	2	2	3	2	Realizim	
C3	Restelicë-IRJM	Përmirësi m	1440-1900	16.705	1	4	4	5	3	Kontrollim	x
A3	Gorë	E re	1380-1480	6.978	2	3	3	4	3	Kontrollim	
B5	Brod-Resticë	E re / përmirësi m	1400-1920	12.463	2	4	4	5	3	Kontrollim	
B4	Tranzit_Resticë	E re	800-850	5.136	3	4	3	4	3	Kontrollim	
B4t	Tunel_Resticë	E re / Përmirësi m	1350-1400	950	3	5	2	2	3	Kontrollim	
C7	Lumi-Plavë	E re	1200-1520	11.090	2	3	3	4	3	Kontrollim	
C4	Brod-IRJM	E re / përmirësi m	1160-2470	11.650	4	4	5	5	4	Largim	
C5	Zaplluxhe-IRJM	E re / përmirësi m	1420-2200	12.744	4	3	4	4	4	Largim	
C6	Shqipëri-IRJM	E re	1400-1940	23.055	5	5	5	5	5	Largim	
				1	Shumë e lartë		Shumë e ultë		Shumë e lartë		
				2	E lartë		E ultë		E lartë		
				3	Moderuar		E moderuar		Moderuar		
				4	E ultë		E lartë		E ultë		
				5	Shumë e ultë		Shumë e lartë		Shumë e ultë		

Hartat e Vlerësimit në vijim sigurojnë të dhënat për Udhëzuesin e Zhvillimit:

- A1.1 dhe A1.2 Vlerësimi i biodiversitetit
- A3 Vlerësimi i burimeve të ujit - rigjenerimi, kërcënimet dhe cilësia
- A4.1 - A4.3 Vlerësimi i rreziqeve natyrore
- A10.1 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë – rrugët dhe transporti

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i kriterit “vlerë e shtuar” përkufizon kuptimin e projektit rrugor për përmirësimin e rrjetit ekzistues të rrugëve. Ai bazohet në pozitën e projektit në rrjetin ekzistues të rrugëve, lidhjen e tij gjeografike me vendbanimet ekzistuese, lartësinë mbidetare, si dhe qasjen në rrugët ekzistuese, në

veçanti lidhjet me jashtë. Vlerësimi shfrytëzon shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i lartë.

Kostoja e një projekti varet nga lloji i ndërtimit (përmirësim i rrugës ekzistuese apo ndërtim i rrugës), konfigurimin (rrugë, urë, tunel) dhe gjatësia e saj. Në fazën aktuale të planifikimit, nuk është e mundur të llogaritet kostoja e saktë e projektit, kështu që vlerësimi bën dallim midis atyre me kosto shumë të ultë (1), të ultë, të mesme, të lartë dhe kosto shumë të lartë (5).

Vlerësimi i ndikimit mjedisor të projekteve të rrugëve përmban analizë të ndjeshmërisë së mjedisit dhe nivelit të dëmit të shkaktuar nga ndërtimi i rrugëve. Zonat me ndjeshmëri të lartë mjedisore janë shoqëri vegjetacioni me rëndësi të madhe⁴, disa lloje vegjetacioni⁵, habitatet e gjitarëve të mbrojtur sipas Direktivës Evropiane për Habitata dhe zona për rigjenerimin e burimeve ujore⁶. Niveli i dëmit të shkaktuar nga ndërtimi i rrugëve varet nga lloji i ndërtimit (përmirësim i rrugëve ekzistuese ose ndërtim i ri) dhe gjatësia e projektit të rrugës. Nisur nga niveli aktual i planifikimit, nuk është e mundur të llogaritet ndikimi mjedisor në hollësi. Vlerësimi vë në përdorim një shkallë vlerësuese deri në pesë pikë, ku 1 përbën vlerësimin më të mirë (me ndikim shumë të ulët mjedisor).

Vlerësimi i kriterit "Park Nacional" bazohet në llojin e ndërtimit dhe gjatësinë e projekteve të rrugës brenda Parkut Nacional. Projektet, të cilat nuk e prekin zonën apo hapësirën e Parkut Nacional të Sharrit, marrin vlerësimin më të lartë "1". Vlerësimi i projekteve tjera shqyrton secilin projekt ndaras duke mos e marrë parasysh ndikimin nga projektet e tjera. Në procesin e mëtejshëm të planifikimit, kur të jetë e qartë se cilat projekte do të zbatohen, duket të ketë një vlerësim të hollësishëm, i cili gjithashtu përmban ndikimet e ndërlidhura të të gjitha projekteve të zbatuara së bashku.

Rekomandimet e PZhK

Grumbullimi i vlerësimeve të ndara mundëson arritjen e vlerësimit përfundimtar. Bazuar në këtë vlerësim të grumbulluar, PZhK formulon rekomandime lidhur me atë se cilat projekte duhet të zbatohen dhe cilat nuk do të duhej të realizohen.

Përmirësimi i rrjetit rrugor lokal dhe rajonal është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të Dragashit. Prandaj, PZhK rekomandon realizimin e projekteve të përmendura më sipër (Veprimi A dhe B). Në rastin e kalimit anësor për Restelicën, projektin B 4t (versionin me tunel) preferohet për shkak të ndikimit më të ulët në mjedis, por kostoja është shumë e lartë. Prandaj, duhet të bëhet një studim fizibiliteti. Gjithashtu, është e nevojshme të elaborohet planifikimi në projektin A3, që kalon përmes rajonit të Gorës, për të arritur në përfundim final.

Edhe projektet për lidhje ndërkuftare janë shumë të rëndësishme, por duhet të bëhet diferencimi mes projekteve të propozuara për rrugë. Projektet C1 dhe C2 janë të dobishme për të krijuar lidhje të mirë dhe të ligjshme me Shqipërinë. Rruga nga Krusheva duket si plan më lehtë i realizueshëm sepse ajo tashmë ekziston, por ka më shumë ndikim në Parkun Nacional dhe distanca me veriun (Dragashin, Prizrenin) është më e largët. Prandaj, duhet të bëhet një studim fizibiliteti se cili projekt do të realizohet, ose të realizohen që të dy. Gjithashtu, është e nevojshme të provohet nëse lidhja rrugore për Shqipëri përgjatë Lumit Plavë (Projekti C7) është e dobishme.

Drejtimet që jepen nga PZhK sjellin tek përfundimi që në Komunën e Dragashit do të duhej të realizohet vetëm një projekt rrugor ndërkuftar për në iRJM: Projekti C3, përmirësimi i rrugës ekzistuese nga Restelica për në kufirin me Maqedoninë. Derisa Plani Hapësinor i Kosovës përcakton një linjë, duke treguar një lidhje të mundshme me iRJM që mund të interpretohet si projekti C4, Brod – Liqeni Shutman, PZhK arrin në gjetje tjetër:

⁴Shoqëritë e renditura në Direktivën e BE-së të Florës dhe Faunës, Shtojca I, endemike në Kosovë ose Ballkan, ose relikte nga periudha glaciare ose terciare, ose e rrallë.

⁵Pyll me gjethe të gjëra, shkurre dhe/ose shoqëritë me vegjetacione barishtore, sipërfaqe të hapura me pak ose aspak vegjetacion dhe toka ujore.

⁶Varësisht nga gjeologjia dhe toka.

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Për shkak të kostove të larta të tyre, ndikimin shumë të madh në mjedis dhe gjatësinë totale brenda parkut Nacional, si dhe për shkak të mungesës së lidhjes me rrugët e jashtme, projekti rrugor C4 (Nga Brodi për në Maqedoni), C5 (Nga Zaplluxha për në Maqedoni) dhe C6 (Kufiri i Shqipërisë për në Kufirin e Maqedonisë) nuk janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe nuk duhet të merren parasysh.

Rezultatet dhe rekomandimet janë pasqyruar në Hartën Udhëzuese G5: Udhëzim për rrugët dhe transportin.

8.5 Shëndeti dhe mireqënia sociale

Sistemi i shkallëzuar i shëndetësisë (qendra kryesore e mjekësisë familjare në Dragash, qendrat e mjekësisë familjare nëpër nën-qendra dhe ambulantat/ordinancat në disa fshatra) do të organizohen për të ofruar shërbime shëndetësore të mira. Personeli dhe pajisjet teknike e fizike të njësive të shëndetësisë duhet të jenë harmoni standardet shëndetësore shtetërore. Kurset e vazhdueshme profesionale për personelin mjekësor dhe përmirësimi i pajisjeve do të rrisin cilësinë e shërbimeve shëndetësore në Dragash. Komuna u ndihmon invalidëve sa më shumë që mundet. Është propozuar edhe shërbimi mjekësor i lëvizshëm, që do të mbulojë largësinë ndërmjet fshatrave të largët dhe ambulantave. Do të organizohen veprimtari vetëdijësuese për shëndetin nëpër fshatra. Në të ardhmen, qytetarët do të mund të lexojnë për tema të ndryshme që ndërlidhen me shëndetin (vetëdijësimi rreth sëmundjeve të ndryshme dhe këshilla të dobishme për të gëzuar shëndet më të mirë) në një uebfaqe informuese në internet. Mireqësia sociale e organizuar mirë do të çojë në përmirësimin e shëndetit dhe të jetës.

Synimet

- Hapja e qendrave të reja të mjekësisë familjare në nën-qendrat që ndodhen larg prej Dragashit apo prej qendrës më të afërt të mjekësisë familjare.
- Standardet shtetërore në lidhje me numrin e njësive të shëndetësisë dhe personelit mjekësor (specialistëve) për kokë banori do të përmbushen në çdo qendër mjekësore dhe ambulante. Për shkak të strukturës së shpërndarë të vendbanimeve, nevojitet personel më i madh nga se mund të mbulojë fondi shtetëror. Prandaj kërkohet grumbullimi i fondeve për të mbuluar shpenzimet e personelit shtesë.
- Personeli mjekësor do të jetë i kualifikuar dhe i motivuar për të ofruar shërbime mjekësore të cilësisë së lartë.
- Pajisjet teknike dhe fizike do të përmirësohen rregullisht për të qenë në hap me kohën.
- Auto-ambulanca me pajisjet e domosdoshme dhe një mjek e një infermiere do të vizitojë pacientët e palëvizshëm / fshatrat e largët të paktën dy herë në muaj.
- Organizimi i transportit të sigurtë urgjent të pacientëve deri në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash
- Organizimi i mirëfilltë i transportit të rregullt të pacientëve deri në Prizren
- Do të ketë barnatore në secilën nën-qendër.
- Tema rreth higjienës dhe shëndetësisë do të jenë pjesë e planprogramit, si dhe e projekteve informuese për të rriturit.
- Do të ketë një uebfaqe për njoftime në dy gjuhë rreth sëmundjeve aktuale dhe përkujdesjes për to.
- Brigada zjarrfikëse komunale dhe vullnetare do të jetë në gjendje t'i fikë zjarret shpejt dhe me sukses.

Veprimet

A) Rregullimi i shpërndarjes hapësinore të njësive të shëndetësisë

- A1) Shëndrrimi i ordinancës në Restelicë në qendër të mjekësisë familjare, sigurimi i infrastrukturës së nevojshme
- A2) Hapja e barnatoreve në Blaç, Brod dhe Restelicë

B) Rritja e personelit

- B1) Secila qendër e mjekësisë familjare do të ketë të paktën 1 mjek, 1 infermiere, 1 mami dhe 1 teknik dhëmbësh (personeli shtesë do të përcaktohet varësisht prej banorëve të zonës që duhet mbuluar)

B2) Punësimi i gjinekologëve shtesë (parapëlqehen të jenë femra) C) Përmirësimi i punës së personelit mjekësor C1) Arsimim i vazhdueshëm profesional për personelin mjekësor C2) Rritja e motivimit D) Përmirësimi i infrastrukturës D1) Përmirësimi i përgjithshëm i pajisjeve fizike dhe teknike, në harmoni me standardet bashkëkohore D2) Përmirësimi i përdorimit të energjisë dhe furnizimit me ujë të nxehtë, me anë të ngrohësve diellorë E) Shtimi i shërbimeve shëndetësore E1) Sigurimi i auto-ambulancës të pajisur me mjetet e nevojshme, si dhe me një mjek e një infermiere, për të vizituar fshatrat e largët një herë në javë E2) Organizimi i transportit të sigurtë urgjent të pacienteve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash E3) Organizimi i transportit të rregullt të pacientëve me sëmundje të veçanta nga shtëpia në Prizren E4) Përfshirja e higjienës dhe shëndetit në planprogramin e shkollave (sidomos në shkollat fillore) E5) Organizimi i projekteve informative për të njoftuar të rriturit rreth sëmundjeve aktuale, sanitarisë dhe ushqimit E6) Digjitalizimi i sistemit informativ të shëndetësisë E7) Krijimi dhe mirëmbajtja e uebfaqes dygjuhësore lidhur me sëmundjet aktuale dhe kujdesin e shëndetit E8) Rritja e financimit të shëndetësisë dhe mbështetja e vendim-marrjes bazuar në dëshmi	
Planifikimi i mëtejme	
<ul style="list-style-type: none"> • Inventar i hollësishëm i pajisjeve ekzistuese në njësitë shëndetësore të Dragashit, si dhe vlerësimi dhe planifikimi i përmirësimit të tyre • Planifikimi i përmirësimit të izolimit termal dhe furnizimit me ujë të nxehtë përmes ngrohësve diellorë • Planifikimi i shërbimit mjekësor lëvizës dhe mjeteve për transportim të pacientëve 	
Përgjegjësia / Korniza institucionale	
<ul style="list-style-type: none"> • Sipas Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040) dhe Ligjit mbi shëndetësinë në Kosovë (nr. 2004/4), komuna është përgjegjëse për ofrimin e përkujdesjes shëndetësore parësore. • Ministria e shëndetësisë është përgjegjëse për nxjerrjen e rregulloreve, si dhe mbikëqyrjen profesionale dhe ligjore të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë edhe caktimin e standardeve shtetërore. Këto standarde e kufizojnë numrin e personelit për përkujdesje shëndetësore parësore. 	
Afati kohor	Implikimi financiar
Projektet prioritare (masat afatmesme) <ul style="list-style-type: none"> • Avancimi i Ambulantes Restelicë/Restelica në Qendër Mjekësore Familjare (QMF) duke siguruar infrastrukturë adekuate. • Hapja e barnatoreve in nen-qendrat Blaç/Bljać, Brod and Restelicë/Restelica. 	mesatar mesatar i ulët
Masat afatmesme <ul style="list-style-type: none"> • Hapja e barnatoreve në nën-qendra (A4) • Punësimi i gjinekologëve plotësues (B2) • Përmirësimi i pajimeve fizike dhe teknike sipas standardeve moderne (D1) • Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe furnizimit me ujë të nxehtë 	i ulët mesatar i lartë i lartë

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

përmes ngrohësve solarë (D2) • Organizimi i transportit urgjent të pacientëve në QMF kryesore në Dragash (E2) • Organizimi i transportit të rregullt të pacientëve për në Prizren (E3) • Përfshirja e temave të higjienës dhe shëndetit në planprogramet shkollore (E4) • Instalimi i uebfaqes dygjuhësore për temat e shëndetit (E7) • Rritja e financimit për shëndetin (E8)	mesatar mesatar i ulët mesatar i ulët mesatar
Masat afatgjata • Çdo QMF duhet të sigurojë së paku 1 mjek, 1 motër medicinale, 1 mami dhe 1 teknik dhëmbësh (B1) • Përmirësimi i performancës së personelit mjekësor (C) • Krijimi i shërbimit të autoambulancës (E1) • Organizimi i projekteve informative shëndetësore për të rriturit (E5) • Digjitalizimi i Sistemit Informativ Shëndetësor (E6)	i lartë mesatar mesatar mesatar mesatar
Vlerësimt	
Nuk janë paraparë ndikime negative në mjedis për shkak se masat e planifikuara të ndërtimit ndikojnë vetëm zonat e ndërtuara ekzistuese. Ngarkesa e trafikut dhe emisionet e gazërave nuk do të rriten në nivel problematik për shkak të shërbimeve të lëvizshme mjekësore (auto-ambulanca). Mirëpo këto do të përmirësojnë jetesën. Nëse implementohen efikasiteti i energjisë dhe masat zjarrëfikëse, veprimet shëndetësore do të kenë një efekt pozitiv edhe në mjedis.	

Arsyet

Harta e Vlerësimit në vijim mundëson të dhënat elementare për Udhëzuesin e Zhvillimit:

- *A8 Vlerësimi i shëndetësisë, shërbimeve mjekësore dhe mborjtjes civile*

Struktura e veçantë e vendbanimeve të Dragashit, me 36 fshatra të vogla larg njëra tjetrës, kërkon përshtatje të standardeve shëndetësore shtetërore. Duhet të ketë më shumë specialistë, sidomos gjinekologë/mami, të arritshëm për invalidët dhe shtatzënat. Për të zgjidhur këtë çështje, duhet të punësohen më shumë specialistë, të përmirësohet transporti i pacientëve apo të ketë shërbime mjekësore lëvizëse. Numri i specialistëve në Dragash nuk është sipas standardeve shtetërore, prandaj të shtohet, edhe nëse e arrin kuotën e nevojshme për numër të banorëve. Nevojitet përmirësimi i transportit të pacientëve përbrenda komunës dhe deri në Prizre, ku bëhen trajtime të specializuara. Edhe nëse përmbushen standardet shtetërore dhe përmirësohet shërbimi lëvizës, largësia ndërmjet fshatrave të largët dhe qendrave mjekësore/ambulantave mbetet e madhe. Për ta mbuluar këtë largësi, janë disa mjekë që punojnë me orar të pjesshëm në një numër fshatrash. Megjithatë, ende kërkohen vizita shtëpiake për fshatarët e dobët dhe të paaftë. Një auto-ambulancë e pajisur me mjetet e nevojshme, si dhe një mjek e një infermier/e do të mundësonte vizitat te pacientët e paralizuar / në fshatra të largët. Një tjetër mjet për të arritur pacientët është interneti, që do të zgjidhte problemin e shpërndarjes hapësinore. Për shembull, uebfaqja dy-gjuhëshe ku qytetarët mund të informohen rreth sëmundjeve aktuale dhe mënyrave si të ruajnë shëndetin; letërkëmbimi elektronik me mjekët; dhe digjitalizimi i sistemit informativ shëndetësor do të përmirësonin ofrimin e shërbimeve mjekësore.

Përveç përkujdesjes themelore shëndetësore që ofrohet nëpër ambulanca/ordinanca, qendrat e mjekësisë familjare ofrojnë një gamë më të gjerë shërbimesh. Qendra të tilla duhet të ketë në secilën nën-qendër, për shkak të madhësisë dhe funksionit të këtyre të fundit. Ambulanta ne

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Restelicë/Restelica duhet të shëndrohet në Qendër të Mjekësisë Familjare për arsye të numrit të madh të popullatës (4200 banorë).

Zhvillimi hapësinor i Shëndetësisë dhe mbrojtjes civile është i shënuar në Hartën Udhëzuese G7: Udhëzim për shëndetësi, shërbimet mjekësore dhe mbrojtjen civile.

8.6 Arsimimi

Qëllimet e përgjithshme
<p>Arsimi është çelësi i një jete më të mirë. Ai e shtyn zhvillimin shoqëror drejt vlerave si toleranca dhe mirëkuptimi ndërmjet kombeve, ndërsa individëve ua çel udhën drejt suksesit. Niveli i shkollimit në Dragash do të vazhdojë të rritet. Si rrjedhojë, sistemi arsimor duhet të jetë në hap me kërkesat e ndryshuara. Dragashi është pjesë e shtetit të pavarur të Kosovës, prandaj shkollat, mësimdhënësit dhe nxënësit e tij duhet të përfshihen në sistemin arsimor të vendit, duhe përfshirë edhe ato ku mësimi zhvillohet në serbisht. Sistemi arsimor në Dragash do të jetë i suksesshëm dhe i larmishëm, i organizuar në bazë të parimit “shkollimi në pikën më të afërt”. Klasët e larta të fillores dhe ato të parashkollës do të rriten, ndërsa në disa fshatra të largëta do të zvogëlohet numri i tepërt i mësimdhënësve. Përhapja hapësinore e shkollave fillore dhe sigurimi i transportit për në shkollë do ta lehtësojë shkollimin për të gjithë fëmijët e kësaj komune. Vajzat e kanë më të lehtë të mbarojnë shkollën fillore, si dhe të vazhdojnë më tej. Arsimimi i mëtejshëm (në fakultet apo shkollë profesionale) e rrit nivelin e arsimimit dhe i jep shtysë zhvillimit në komunë. Tregu i punës në këtë komunë përbëhet prej të rinjsh dhe të rriturish të aftë. Kurset e ndryshme profesionale, sidomos ato që prekin gratë dhe të papunët, në fushat kryesore të zhvillimit ekonomik (bujqësia, pylltaria, mbledhja e bimëve, përpunimi i ushqimit, trashëgimia kulturore dhe turizmi) shtojnë mundësitë e përparimit në Dragash, si dhe fuqizojnë rolin e tij në rajonin e Sharrit.</p>
Synimet
<ul style="list-style-type: none">• Në aspektin afatgjatë, sistemi arsimor kosovar duhet të shtrihet në gjithë Dragashin. Mësimdhënësit dhe lëndët e sistemit serb duhet të përfshihen në sistemin kosovar, natyrisht, duke e respektuar mjedisin kulturor të goranëve dhe gjuhën serbe. Për ta përmbushur këtë synim, duhet të fillohet dialogu ndërmjet palëve përkatëse të nivelit komunal dhe shtetëror. Objektet e shkollave të mesme do të shtohen. Shumica e të rinjve të Dragashit do ta kryejnë shkollën e mesme. Nuk do të ketë dallime gjinore.• Do të ketë një sistem të organizuar shkollash amë dhe satelite, si dhe transport deri në shkollë.• Do të realizohen programe arsimimi për të rriturit, me qëllim që t’u lehtësohet atyre punësimi, qofshin burra, gra, të papunë apo të pakualifikuar, si dhe që komuna të zhvillohet më tej.• Prodhimtaria vendore do të jetë pjesa kryesore e sektorit ekonomik të Dragashit.• Deri më 2015, nuk do të ketë asnjë shkollë me më pak se 10 nxënës, pasi që mirëmbajtja e këtyre objekteve shkollore nuk është ekonomike dhe i tejkalon fondet e komunës.• Do të rritet komunikimi ndërmjet prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve, si dhe do të ndihmohet përfshirja aktive e prindërve në procesin mësimor.• Të gjithë djemtë dhe vajzat e Dragashit duhet të kryejnë shkollë aq sa kanë aftësi, jo të varen nga faktorët financiarë, shoqërorë apo etnikë ose nga nevojat specifike.• Hapja e institucioneve parashkollë do t’i lehtësojë prindërit, ndërsa fëmijëve do t’u ndihmojë të përgatiten për shkollë.• Arsimi do të përfshijë tema aktuale (shëndetësia, trashëgimia kulturore, energjia, ndotja e mjedisit).

Veprimet
<p>A) Sistemi arsimor paralel (Sistemi shkollor serb)</p> <p>A1) Përfshirja e mësimdhënësve të sistemit serb në sistemin kosovar</p> <p>A2) Motivimi i një diskutimi në shoqërinë civile për integrimin e sistemit paralel (serb) në sistemin kosovar; Dialogu, sidomos me prindërit e fëmijëve që ndjekin shkolla serbe</p> <p>A3) Nxitja e veprimtarive të përbashkëta ndërmjet dy bashkësive</p> <p>A4) Shtrirja e sistemit arsimor kosovar në rajonin e Gorës (posaçërisht në Restelicë)</p> <p>B) Shkollat e mesme</p> <p>B1) Hapja e shkollës së mesme/profesionale në qytetin e Dragashit</p> <p>B2) Rritja e numrit të nxënësve të shkollës së mesme dhe studentëve (nga të dyja gjinitë), si dhe përcjellja e mungesave të të gjithë nxënësve</p> <p>B3) Hapja e shkollave të mesme satelite në rajonin e Gorës (Restelicë, Brod)</p> <p>C) Të mësuarit gjatë gjithë jetës</p> <p>C1) Hapja e shkollës së mesme/profesionale në Dragasg si qendër arsimore për të rinjtë mbi 15 vjeç</p> <p>C2) Realizimi i programeve arsimore për të rritur – burra, gra, të papunë dhe të pakualifikuar; Tërheqja e mjeteve plotësuese financiare dhe organizimi i kurseve nga specilaistët për edukimin e të rriturve</p> <p>C3) Mbatja e kurseve për fushat kryesore të zhvillimit ekonomik (bujqësia, pylltaria, mbledhja e bimëve, përpunimi i ushqimit, kultura dhe turizmi)</p> <p>C4) Sigurimi i mundësive për komunitetet lokale të të vepojnë dhe të marrin pjesë në strategjitë ekonomike, me anë të trajnimit në planifikimin e biznesit, menaxhim, mikpritje dhe sigurim të shërbimeve, kontabilitet dhe marketing</p> <p>C5) Lejimi i mundësive të barabarta për femrat për të qasur këto mundësi me trajnim të caktuar. Projektet duhet të përqendrohen në zhvillimin e shkathtësive dhe kapitalit shoqëror të grave për të marrë pjesë në veprimtari tradicionale si përgatitja e ushqimit, strehimi, rritja dhe përpunimi i prodhimeve bujqësore, si dhe qepja e rrobave dhe cohëve, që ndërlidhen me turizimin dhe fusha të tjera fitimprurëse.</p> <p>D) Përshtatjet në arsimin fillor</p> <p>D1) Zvogëloni numrin e tepërt të mësimdhënësve (për shkak të numrit të vogël të nxënësve)</p> <p>D2) Nëse mund të organizohet transporti deri në shkolla të tjera fillore, do të mbyllen shkollat që kanë më pak se 10 nxënës.</p> <p>E) Procesi mësimor</p> <p>E1) Stërvitja e vazhdueshme profesionale e mësimdhënësve</p> <p>E2) Mbatja e takimeve ndërmjet prindërve dhe mësimdhënësve; dhe mundësia që prindërit të luajnë rol aktiv në procesin arsimor (ditët e punës për mjedisin, për ruajtjen e traditave/trashëgimisë kulturore, etj.)</p> <p>E3) Shkëmbimi i përvojës dhe njohurive me shkolla të tjera në Kosovë dhe më gjerë</p> <p>E4) Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim</p> <p>F) Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të tjera</p> <p>F1) Përmirësimi i infrastrukturës nëpër shkolla (objektet, fushat sportive, laboratorët, teknologjia, materialet mësimore, etj.)</p> <p>F2) Organizimi i transportit për shkolla të mesme, si dhe për shkolla fillore ku është e nevojshme</p> <p>F3) Përkrahja financiare (bursat, transporti, librat)</p> <p>G) Zhvillimi i fushave të tjera</p> <p>G1) Hapja e një institucioni parashkollor (çerdhe dhe klasë parafillore)</p> <p>G2) Përfshirja e temave aktuale në planprogramin e shkollës (shëndetësia, trashëgimia kulturore, energjia, mjedisi dhe mbledhja e mbeturinave)</p> <p>G3) Përfshirja e teknologjisë bashkëkohore (kompjuteri, interneti) në jetën shkollare. (Kjo do ta zgjidhte edhe problemin e largësisë ndërmjet fshatrave)</p>

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Planifikimi i mëtejme	
<ul style="list-style-type: none"> Duhet të planifikohet procesi afatgjatë i shtrirjes së një sistemi arsimor të vetëm Në harmoni me Ligjin mbi shkollimin e detyrueshëm të mesëm, kërkesa për klasa të shkollës së mesme duhet të vlerësohet dhe plotësohet në kuadër të komunës 	
Përgjegjësia / Korniza institucionale	
<ul style="list-style-type: none"> Përgjegjësitë e nivelit komunal dhe kombëtar në lidhje me arsimin përcaktohen me Ligjin mbi arsimin në nivel komune nr. No.03/L-068 dhe me Ligjin mbi arsimin parauniversiter nr. 04/L – 032. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka për detyrë, ndër të tjera, të hartojë rregulloret për fushën e arsimit, të mbikëqyrë udhëheqjen e sistemit arsimor, si dhe të ndihmojë në zhvillimin e tij. Sipas platformës ligjore, komunat kanë fuqi të plotë në udhëheqjen e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë liçencimin e institucioneve arsimore, punësimin, dhënien e pagave dhe stërvitjen e mësimitdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave. Ligji mbi arsimin e detyrueshëm të mesëm pritet të miratohet. Vendimet rreth të ardhmes të sistemit paralel nuk janë përgjegjësi e komunës; ato kërkojnë angazhimin e instancave shtetërore. 	
Afati kohor	Implikimi financiar
Projektet prioritare (masat afatmesme) <ul style="list-style-type: none"> Motivimi i diskutimit me shoqërinë civile, përfshirë këtu prindërit, lidhur me integrimin e sistemit paralel në sistemin kosovar (A2) Të merret vendim për themelimin e klasave të shkollës së mesme në nën-qendrat e rajonit të Gorës (B3) Hapja e shkollës së re të mesme/ profesionale në qytetin Dragash (B1, C1) Tërheqja e mjeteve plotësuese financiare dhe organizimi i kurseve nga specialistët për edukimin e të rriturve (C2) Realizimi i trajnimit në vend të punës për fushat kryesore të zhvillimit ekonomik (C3) 	i ulët i ulët i ulët mesatar mesatar
Masat afatmesme <ul style="list-style-type: none"> Motivimi i këmbimit të aktiviteteve mes rajoneve të Opojës dhe Gorës (A3) Shtimi i kapaciteteve dhe mundësive për pjesëmarrjen e femrave nësektorin ekonomik (C5) Angazhimi i mësimitdhënësve në trajnimet e rregullta profesionale (E1) Themelimi i takimeve prind-mësimitdhënës (E2) Përmirësimi i infrastrukturës shkollore (F1) Organizimi i transportit rrugor (F2) Themelimi i institucioneve parashkollore (G1) Përfshirja e çështjeve aktuale në planprogramin shkollor (G2) Integrimi i teknologjive moderne në përditshmërinë shkollore (G3) 	i ulët mesatar mesatar mesatar i lartë mesatar i lartë i ulët mesatar-i lartë
Masat afatgjate <ul style="list-style-type: none"> Integrimi i mësimitdhënësve të sistemit serb në sistemin e Kosovës në rajonin e Gorës (A1, A4) Shtimi i numrit të nxënësve në shkollën e mesme (B2) Integrimi i bashkësive në startegjitë ekonomike (C4) Përmirësimi i efikasitetit të arsimit shkollor me zvogëlimin e numrit të shkollave dhe mësimitdhënësve (D) Këmbimi i përvojës dhe njohurisë me shkollat e tjera në Kosovë dhe 	i lartë mesatar mesatar i ulët mesatar

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

jashtë vendit (E3) • Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta (E4) • Tërheqja dhe sigurimi i mbështetjes financiare (bursa, transport, libra) (F3)	mesatar i lartë
Vlerësim	
Nuk priten ndikime negative në mjedis për shkak se masat e planifikuara të ndërtimit ndikojnë në zonat e ndërtuara ekzistuese. Ngarkesa e trafikut dhe emisionet e gazërave nuk do të shtohen në nivel problematik për shkak të transportit të nxënësve në shkollë. Veç kësaj, disa masa educative do të rrisin vetëdijen për ruajtjen e natyrës, kështu që strategjia arsimore do të ketë efekt pozitiv mbi mjedisin. Pasi që arsimit është baza e zhvillimit ekonomik dhe standardit të mirë jetësor, çështjet socio-ekonomike do të ndikohen në mënyrë pozitive.	

Arsyet

Struktura e veçantë e vendbanimeve të Dragashit, me 36 fshatra të vogla larg njëra tjetrës, e vështirëson sigurimin e objekteve shkollore për të gjithë. Vlerësimi i gjendes aktuale nxori në pah që disa shkolla fillore në fshatra të largëta me popullsi të pakët kanë tepricë të personelit arsimor, ndërsa në sektorin parafillor dhe të mesëm ka mungesë personeli.

Harta e Vlerësimit në vijim ofron të dhënat elementare për Udhëzuesin e Zhvillimit:

- *A9 Vlerësimi i arsimit*

Rezultatet dhe rekomandimet janë pasqyruar në Hartën e Udhëzimit G10 Udhëzimi mbi arsimin.

Një tjetër faktor që e vështirëson shfrytëzimin e arsyeshëm të burimeve është ekzistenca e sistemit paralel. Strategjia e PZhK-së propozon njësimin e dy sistemeve në aspektin afatgjatë.

Parimi i “shkollimit në pikën më të afërt” nuk mund të zbatohet pa disa përjashtime. Dendësia e ulët e popullsisë në fshatrat e vogël të Dragashit kërkon shpërdarje të mirë të shkollave, si dhe transport për stinën e dimrit. Kjo nuk vlen vetëm për shkollat fillore, por edhe për ato të mesme dhe profesionale. Teprica e personelit në sektorin fillor mund të zvogëlohet, krahas rritjes në sistemin parashkollor dhe të mesëm. Një fuqi punëtore e kualifikuar dhe e aftë është themel i zhvillimit të Dragashit.

8.7 Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Qëllimet e përgjithshme
<p>Pasuritë e shumta turistike dhe kulturore, natyra, larmia e popullsisë, si dhe trashëgimia materiale e shpirtërore e begatojnë Dragashin me mundësi për zhvillim të turizmit dhe të ekonomisë. Parku Nacional Malet e Sharrit në Dragash ofron një mundësi të veçantë për zhvillim të turizmit në komunë, pasi që mund të organizohen veprimtari shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe vizita, duke respektuar mjedisin dhe kulturën vendore. Dragashi si pjesë e Ballkanit perëndimor dhe Evropës, i kushton rëndësi të madhe listimit të pasurive të trashëgimisë kulturore, si dhe ndërmerr masa për ruajtjen, mbrojtjen dhe riparimin e tyre. Falë bashkëpunimit ndërmjet zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe turizmin, komuna arrin të ruajë pasuritë natyrore dhe vërtetësinë burimore të objekteve kulturore, duke rritur vetëdijesimin e jashtëm dhe të brendshëm për bukurinë dhe veçantinë e tyre, gjë që i bën ato të dobishme për ekonominë. Investimet strategjike në infrastrukturën e turizmit (në aspektin fizik dhe njerëzor) do të rrisin cilësinë e shërbimeve, duke i përmbushur kështu kërkesat e turistëve. Dragashi do të zhvillojë një ekonomi të qëndrueshme turizmi përmes bashkëpunimeve ndër-komunale, si dhe një bashkëpunimi të gjerë ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë për mbrojtjen e mjedisit, rritjen e nivelit të punësimit dhe të ndërmarrësisë, përfitimet shoqërore, fitimin industrial dhe të hyrat komunale. Shpërndarja hapësinore e qendrave turistike do të barazpeshojë fitimin nga turizmi për gjithë komunën, si dhe përkujdesjen për natyrën dhe trashëgiminë kulturore në gjithë Dragashin. Themelimi i administratës së parkut nacional do të shërbejë si shtytës për zhvillimin e një infrastrukture turistike të qëndrueshme.</p>
Synimet
<ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi i turizmit do të ndihmohet përmes përmirësimit të infrastrukturës fizike dhe burimeve njerëzore.• Zhvillimi i turizmit në Dragash do të bëhet në harmoni me ministrinë e tregtisë dhe industrisë, Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), qytetarët e Dragashit dhe shtetet fqinje.• Turizmi do të zhvillohet përmes mundësive ekzistuese (p.sh., shtigjet e ngjitjes, festivalet) dhe hapjes së mundësive të reja (p.sh., rrëshqitja me ski, muzeu etnologjik).• Qyteti i Dragashit do të shërbejë si “kamp i qendror i turizmit” – vendi ku arrijnë turistët dhe marrin të gjitha të dhënat e nevojshme rreth komunës.• Fshatrat me pasuri të rëndësishme që ndërlidhen me pasuritë kryesore turistike të Dragashit do të shërbejnë si “qendra turistike” – pikënisje për veprimtari të caktuara.• Zhvillimi i turizmit do të ndihmojë në mbrojtjen e mjedisit, mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore dhe përmirësimin e infrastrukturës (rrugët, administrimi i mbeturinave dhe furnizimi me rrymë dhe ujë).• Plani administrues i parkut kombëtar do të rregullojë aspekte të ndryshme të infrastrukturës turistike, si dhe do të ndihmojë në përmirësimin e tyre.• Do të rritet vetëdijesimi i qytetarëve të Dragashit rreth trashëgimisë kulturore dhe natyrore.• Do të organizohen veprimtari për mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore, duke u bazuar në hulumtime profesionale dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.• Shfrytëzimi i përshatshëm i ndërtesave të trashëgimisë kulturore do të ruajë ndërtesat e zbrazëta nga shkatërrimi.• Kërkimet profesionale rreth trashëgimisë arkeologjike, monumentale, natyrore dhe shpirtërore të Dragashit do ta nxjerrin në pah vlerën historike, si dhe potencialin për zhvillim turistik të kësaj komune.• Botimi i një katalogu të pasurive kulturore (dhe natyrore) do të jetë përparësi e drejtorisë së

<p>kulturës, në bashkëpunim me qendrën rajonale të trashëgimisë kulturore në Prizren, qytetarët dhe grupet punuese të fshatrave.</p> <ul style="list-style-type: none">• Banorët vendorë do të përfshihen aktivisht në hartimin dhe realizimin e strategjive vendore për turizmin kulturor dhe natyror.
Veprimet
A) Mbështetja e zhvillimit të turizmit <p>A1) Përgatitja e planit të veprimit për realizimin e strategjisë së turizmit që mbështetet në natyrë, si dhe përfshirja e turizmit kulturor</p> <p>A2) Shfrytëzimi i themelimit të parkut nacional për krijimin e një qendre për vizitorë dhe vende të tjera turistike</p> <p>A3) Zhvillimi dhe rritja e standardeve të infrastrukturës teknike (uji, ujërat e zeza, menaxhimi i mbeturinave)</p> <p>A4) Caktimi i një zyrtari të veçantë për turizëm, në kuadër të administratës komunale (p.sh. në suaza të Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit)</p> <p>A5) Heqja e vend-grumbullimit të mbeturinave të Prizrenit nga hyrja e Dragashit, si dhe e pikave tjera të paligjshme ku hidhen mbeturinat</p> <p>A6) Realizimi i fushatave vetëdijesuese rreth rëndësisë së një mjedisi të pastër, për t'i mësuar banorët të mos hedhin mbeturina rrugëve apo nëpër lumenj</p> <p>A7) Rritja e bashkëpunimit ndër-komunal; shfrytëzimi i përvojës së projekteve/komunave të tjera</p> <p>A8) Stërvitja për ofrimin e mikpritjes dhe shërbimeve cilësore, si dhe stërvitja për ciceronë për qytetarët e Dragashit</p> <p>A9) Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe atij publik për rritjen e investimeve në sektorin e turizmit</p> <p>A10) Reklamimi i Dragashit në nivel rajonal, shtetëror dhe ndërkombëtar (p.sh. me kartolina, broshura, libra për Dragashin dhe në internet)</p> <p>A11) Krijimi i Uebfaqes për Turizëm... Krijimi i uebfaqes së turizmit që u mundëson vizitorëve të planifikojnë udhëtimin para se të arrijnë, si dhe të bëjnë rezervimin në bujtinat me pension</p> <p>A12) Rritja e rrjetit të rrugëve, duke i lënë disa prej tyre që janë rreth ndërtesave të trashëgimisë kulturore / bashkësive të ndërtesave tradicionale ashtu siç janë, në aspektin e formës, por edhe të materialit (p.sh., gurët e rrumbullakët)</p> B) Shqyrtimi i disa fushave (të reja) të turizmit <p>B1) Sigurimi i Vlerësimeve për Ndikimin e Mjedisit lidhur me infrastrukturën për ski, p.sh. në majë të malit në afërsi të Brodit ose Zaplluxhes</p> <p>B2) Realizimi i një studimi të mundësive për turizmin me ski në kodrat pranë Pllajnikut</p> <p>B3) Shqyrtimi i mundësisë për peshkim, lundrim dhe veprimtari të tjera në ujë; si dhe çiklizëm malor, ngjitje në shkëmbinj dhe veprimtari të tjera në natyrë</p> <p>B4) Përfshirja e turizmit kulturor në strategjinë e turizmit natyror, si dhe shfrytëzimi i festivaleve tradicionale për turizëm</p> <p>B5) Zhvillimi i turizmit të gjuetisë në bashkëpunim me shoqatën e Gjuetarëve për zonat jashtë PN</p> <ol style="list-style-type: none">Vendimi për planet e gjuetisë së kafshëve të egraEdukimi i gjuetarëve në nivel adekuatRregullimi dhe përgjegjësia e qartë, si dhe procedurat në rast të ankesave dhe vëzhgimin e<ol style="list-style-type: none">Prerjeve të paligjshmePeshkimit ose shkeljen e kodit dhe rregullave të gjuetisë C) Zhvillimi i qendrave turistike në Dragash <p>C1) Caktimi i qytetit të Dragashit si “kampi qendror i turizmit”, duke hapur një zyrë informuese turistike që do t'u ofrojë vizitorëve të dhëna dhe do t'i ndihmojë të gjejnë strehim, transport dhe ciceronë; si dhe duke siguruar bujtina (hoteli)</p> <p>C2) Caktimi i fshatit Bellobrad si “qendër turistike” dhe pikënisje për ecje, çiklizëm, udhëtim me veturë në luginën e Opojës</p> <p>C3) Caktimi i fshatit Bresanë si “qendër turistike” dhe pikënisje për ecje, çiklizëm, udhëtim me veturë në</p>

luginën e Opojës

- C4) Caktimi i fshatit Brezne si “qendër turistike” dhe pikënisje për ecje, pikniqe, etj. në liqenin e Breznes; bujtina (hotele, pushimore)
- C5) Caktimi i fshatit Zaplluxhe si “qendër turistike” dhe pikënisje për ecje, çiklizëm, vozitje me veturë, etj. në luginën e Opojës; për alpinizëm, pikniqe, etj. në malet e Sharrit; pikë ndërlidhëse ndër-shtetërore për alpinizëm jashtë vendit; vend skijimi; bujtina (hotele, pushimore)
- C6) Caktimi i fshatit Brod si “qendër turistike” dhe pikënisje për alpinizëm, pikniqe, etj. në malet e Gorës; bujtina (hoteli 'Arxhena', pushimoret); vend për rrëshqitje me ski; pikë ndërlidhëse ndër-shtetërore për alpinizëm jashtë vendit
- C7) Caktimi i fshatit Rapçë si “qendër turistike” dhe pikënisje për alpinizëm në malin Koritnik; pikë ndërlidhëse ndër-shtetërore për alpinizëm jashtë vendit
- C8) Caktimi i fshatit Radeshë si “qendër turistike” dhe pikënisje për alpinizëm në malet e Gorës dhe deri në luginën e Opojës; bujtina (hotele, pushimore)
- C9) Caktimi i fshatit Restelicë si “qendër turistike” dhe pikënisje për alpinizëm; pikë ndërlidhëse ndër-shtetërore për alpinizëm jashtë vendit; me mundësi që në të vendoset një “qendër për vizitorë të parkut nacional”

D) Zhvillimi i shtigjeve të alpinizmit

- D1) Caktimi dhe shenjimi i shtigjeve të ecjes/alpinizmit
- D2) Mirëmbajtja e shtigjeve
- D3) Botimi i hartave, përgatitja e strategjive të reklamimit
- D4) Hapja e shtigjeve të ndryshme për t'iu përshtatur larmisë së vizitorëve (familje me fëmijë, persona më pak të aftë, alpinistë ekspertë dhe turistë kulturore). Shtigjet duhet të jenë të dredhura. Ato mund të lidhin disa fshatra, si dhe të çojnë në zona me interes kulturor apo natyror, apo të ndjekin shtigje të vjetra.
- D5) Nevojitet zhvillimi i infrastrukturës turistike, duke përfshirë banjot, pikat freskuese, shenjat rrugore, hartat e ngjitura në pika të caktuara, tryezat për piknik, shportat për mbeturina, shenjat njoftuese, rrethojat, e kështu me radhë, për të siguruar rehati dhe siguri shtigjeve, si dhe mbrojtje të mjedisit dhe ndihmë për gjetjen e rrugës

E) Ndërlidhja e turizmit dhe trashëgimisë kulturore/natyrore

- E1) Hapja e muzeut etnologjik në Dragash
- E2) Angazhimi drejt realizimit të projektit të parkut nacional
- E3) Realizimi i projekteve që ndihmojnë zhvillimin e turizmit burimor vendor, duke u ndihmuar grave të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për veprimtari që ndërlidhen me turizmin (përgatitja e ushqimit tradicional, mikpritja, bujqësia dhe përpunimi i prodhimeve bujqësore, si dhe qepja e rrobave dhe cohëve)
- E4) Meremetimi i bashkësive ekzistuese të ndërtesave tradicionale për strehim të turistëve. Caktimi i tyre si ‘qendra për vizitorët’ në disa pika në komunë, prej nga mund të vizitohen pasuri të tjera kulturore dhe natyrore
- E5) Përshtatja e mullinjve për të shërbyer si pikë ekspozimi për historinë e fshatit dhe për vendosjen e komoditeteve të mikpritjes; mirëmbajtja e tyre si peisazhe (duke përfshirë masat për mbrojtjen e lumenjve/pyjeve)
- E6) Shqyrtimi i një koncepti të themelimit të një muzeu të jashtëm në Zlipotok

F) Vetëdijësimi rreth trashëgimisë kulturore

- F1) Fushata për rritjen e vetëdijes së qytetarëve rreth trajtimit të drejtë të trashëgimisë kulturore (bie fjala, çfarë duhet bërë në rast se hasin në ndonjë objekt arkeologjik, çfarë është ‘trashëgimia’, etj.), në mënyrë që ata të respektojnë dhe mbrojnë trashëgiminë e vlefshme
- F2) Formimi i grupeve punuese për trashëgimi kulturore/natyrore dhe turizëm, në përbërje të qytetarëve shqiptarë dhe goranë, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë
- F3) Përfshirja e temës së trashëgimisë kulturore/traditave në planprogramin shkollor dhe organizimi i veprimtarive të përbashkëta ndërmjet popullatës shqiptare dhe asaj gorane
- F4) Stërvitja e personelit komunar të departamenteve të ndryshme rreth pasurive natyrore dhe kulturore,

vlërës së tyre, problemeve që hasen gjatë mbrojtjes së tyre, si dhe metodave për ruajtjen e tyre

G) Mirëmbajtja e trashëgimisë kulturore

- G1) Punime urgjente të mbrojtjes në të gjitha zonat që janë të mbrojtura apo përkohësisht të mbrojtura nga shteti, derisa vazhdojnë kërkimet që do të ndihmojnë në hartimin e strategjisë së mbrojtjes
- G2) Shenjimi i varreve, mullinjve, objekteve fetare dhe monumenteve si pasuri kulturore
- G3) Mbajtja e kurseve profesionale mbi teknikat e restaurimit të pasurive të trashëguara, zejtarinë tradicionale – punën artizanale dhe punë-doren, si dhe veprimtari të tjera tradicionale
- G4) Shfrytëzimi i objekteve të trashëgimisë si skena për manifestime, festivale dhe organizime të tjera të qytetarëve, duke respektuar këshillat profesionale rreth ruajtjes së tyre

H) Kërkimet në fushën e trashëgimisë kombëtare

- H1) Përpilimi i inventarit të trashëgimisë kulturore të Dragashit: verifikimi i fakteve, kërkimet e reja, përfundimi i pjesëve që flasin për peisazhet kulturore dhe trashëgiminë materiale dhe shpirtërore
- H2) Mbështetja e kërkimeve profesionale në zona arkeologjike (dhe në zona të tjera ku mund të zbulohen rrënoja të vendbanimeve të mëparshme); hulumtimi profesional dhe angazhimi qytetar për krijimin e një baze të dhënash rreth artefakteve arkeologjike
- H3) Mbështetja e kërkimeve profesionale, në bashkëpunim me institucionet vendore dhe shtetërore, për klasifikimin përfundimtar të zonave të mbrojtura arkitekturore
- H4) Mbështetja e hulumtimeve pjesëmarrëse për regjistrimin dhe ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore
- H5) Mbledhja e të dhënave më të plota rreth 'gojëdhënave popullore' që flasin për, bie fjala, bollshmerinë e ujit në Dragash, rrugët tregtare historike dhe lidhjet me shtetet e tjera, vendet që përmenden nëpër përralla dhe legjenda, si dhe zhvillimin dhe punimin e rrobave tradicionale

Planifikimi i mëtejshëm

- Përgatitja e planit të veprimit për realizimin e strategjisë së turizmit që mbështetet në natyrë, si dhe përfshirja e turizmit kulturor
- Përfshirja e aspektit të infrastrukturës turistike në planin administrativ të parkut nacional
- Përgatitja e strategjisë për zonat arkeologjike: planifikimi i hulumtimeve të mëvonshme dhe masat për mbrojtje të menjëhershme
- Përgatitja e strategjisë për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve fetare, mullinjve, varreve, bashkësive të ndërtesave tradicionale, objekteve bujqësore dhe shtëpive me *çardak*. Mund të nevojiten punime urgjente për mbrojtjen e këtyre objekteve

Përgjegjësia / Korniza institucionale

- Roli i sektorit publik në zhvillimin e turizmit është të përcaktojë kushtet e nevojshme për zhvillimin e prodhimeve, infrastrukturën, informimin e turistëve dhe reklamimin e Dragashit si vend turistik. Përgjegjësia kryesore e sektorit publik është të krijojë kushtet e nevojshme për zhvillim e turizmit dhe hapjen e sipërmarrjeve private, si dhe të përmirësojë infrastrukturën e përgjithshme, reklamimin dhe shërbimet publike. Komuna duhet të marrë parasysh planet e qeverisë gjatë hartimit të strategjisë për zhvillimin e turizmit. Duke harmonizuar përdorimin e pasurive natyrore me strategjinë turistike të Kosovës, Dragashi do t'ia lehtësojë ministrisë së tregtisë dhe industrisë reklamimin dhe kompletimin e ofertave turistike të Dragashit.
- Roli i sektorit privat është t'i shndërrojë pasuritë turistike të Dragashit në prodhime të tregtueshme. Duhet theksuar se sektori privat është shtytësi kryesor i fushës së turizmit; ai siguron mbi 90% të të ardhurave në këtë fushë, si dhe investon për zhvillimin e burimeve njerëzore.
- Qytetarët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në hartimin dhe realizimin e strategjive vendore të turizmit kulturor dhe natyror.
- Regjistrimi i të gjitha pasurive kulturore dhe natyrore, si dhe mirëmbajtja e tyre, është përgjegjësi e drejtorisë së kulturës dhe qendrës rajonale të trashëgimisë kulturore në Prizren.
- Ministria e tregtisë dhe industrisë i përcaktoi katër shtylla të zhvillimit turistik në strategjinë për

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

turizimin në Kosovë 2011-2020. • AKK-ja ndihmon zhvillimin turistik në rajonin jugor; ajo i përcaktoi fushat kryesore të zhvillimit me anë të rregullores për turizmin. Plani përfundimtar që përfshin edhe reklamimin dhe veprimet e nevojshme, do të miratohet së shpejti.	
Korniza kohore	Implikimi financiar
Projektet prioritare (masat afatshkurta) <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i Planit të Veprimit (A1) • Zhvillimi i infrastrukturës teknike (A3) • Caktimi i një zyrtari të veçantë për turizëm (A4) • Largimi i Depos së Mbeturinave të Prizrenit në hyrje të Dragashit dhe depove të tjera të paligjshme të mbeturinave (A5) • Realizimi i programeve për rritjen e vetëdijes lidhur me vlerën e një mjedisi të pastër, sidomos për zvogëlimin e fëlliqjes së rrugëve ose lumenjve (A6) • Mikpritja, shërbimet dhe trajnimi për cilësi si dhe trajnimi për udhëzuesin e ecjes/alpinizmit për qytetarët e Dragashit (A8) • Rritja e rrjetit rrugor dhe ruajtja e formave tradicionale të ndërtimit (A12) • Vendosja e qytetit të Dragashit si “kamp qendror turistik” (C1) • Programet e vetëdijësimit për bashkësitë (dhe qytetarët) mbi trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore (F1) • Krijimi i grupeve punuese për trashëgiminë kulturore / natyrore dhe turizmit, përfshirë këtu femrat dhe rininë. (F2) • Punimet emergjente për ruajtjen e të gjitha vendeve nën Mbrojtje Kombëtare (G1) 	i ulët i lartë i lartë mesatar mesatar mesatar i lartë mesatar mesatar i ulët mesatar
Masat afatmesme <ul style="list-style-type: none"> • Avancimi i themelimit të Parkut Nacional për krijimin e pikave të interesit (A2) • Themelimi i partneriteteve ndër-komunale (A7) • Inkurajimi i Partneriteteve Private-Publike (A9) • Marketingu i Dragashit (A10) • Krijimi i Uebfaqes për Turizëm (A11) • Përfshirja e turizmit kulturor në Strategjinë e Turizmit të bazuar në Natyrë (B4) • Zhvillimi i turizmit të gjuetisë (B5) • Themelimi i qendrave turistike (C2-C9) • Identifikimi, mirëmbajtja dhe përcaktimi i shtigjeve të ecjes (D1-D3) • Themelimi i muzeut etnologjik në Dragash (E1) • Përqëndrimi i përpjekjeve për realizimin e Parkut Nacional (E2) • Krijimi i projekteve që përqëndrohen në “originalitetin e bazuar sipas vendit” (E3) • Shqyrtimi i konceptit për themelimin e një muzeu të jashtëm në Zlipotok (E6) • Përfshirja e temës së trashëgimisë kulturore në planprogramin shkollor dhe këmbimi i aktiviteteve mes komuniteteve të Dragashit (F3) • Trajnimi i personelit komunal lidhur me vlerën dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (F4) 	mesatar mesatar mesatar mesatar mesatar i ulët mesatar mesatar i ulët i ulët i ulët mesatar i ulët mesatar mesatar

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimet profesionale për teknikat e ndërtimeve të trashëguara (G3) • Përpilimi i inventarit të trashëgimisë kulturore (H1) • Lejimi i hulumtimit dhe grumbullimi i informatave më të plota për trashëgiminë e prekshme dhe tregimet kulturore (H4, H5) 	i lartë mesatar mesatar
Masat afatgjate <ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis për projektet e rrëshqitjes me ski (B1) • Studimi i mundësive për turizmin me ski pranë Pllajnikut (B2) • Vlerësimi i mundësive për aktivitetet e jashtme dhe në ujë (B3) • Zgjerimi i sistemit të shtigjeve të ecjes me zhvillimin e sistemit kierarkik dhe rritjen e komoditeteve dhe infrastrukturave të tjera (D4, D5) • Rinovimi i kompleksit ekzistues të objekteve tradicionale autoktone në akomodime për vizitorët (E4) • Shndërrimi i mullinjve historikë në objekte të dobishme turistike (E5) • Shenjat/tabelat e trashëgimisë së prekshme (arkitektonike) heritage (G2) • Ndërrimi i qëllimit të objekteve të trashëguara si vend dhe sfond për ngjarjet e përbashkëta dhe private (G4) • Mundësimi i hulumtimit profesional në trashëgiminë arkeologjike dhe arkitektonike (H2, H3) 	mesatar i ulët mesatar i lartë i lartë i ulët mesatar i ulët
Vlerësimi	
Janë të parapara ndikimet në mjedis për shkak të zhvillimit të turizmit. Megjithatë, ndikimet negative mund të zvogëlohen kur pozicionimi do të marrë parasysh aspektet e mjedisit ashtu siç është bërë në këtë strategji. Strategjia e turizmit komunikon se një mjedis i pastër dhe i mbrojtur është vlera kryesore dhe baza për sukses, prandaj, do të ketë efekt pozitiv mbi mjedisin. Në rast të trashëgimisë kulturore, strategjia nuk do të dëmtojë mjedisin, por do të ruajë traditat dhe pasuritë kulturore. Ndikimet socio-ekonomike të strategjisë janë paraparë të jenë pozitive për shkak se do të mbështesë zhvillimin ekonomik në fushën e turizmit dhe do të ruajë traditat kulturore dhe identitin e Dragashit.	

Arsyet

Hartat e Vlerësimit në vijim ofrojnë të dhëna themelore për Udhëzimin e Zhvillimit:

- *A1.1 dhe A1.2 Vlerësimi i biodiversitetit*
- *A3 Vlerësimi i burimeve të ujit – rigjenerimi, kërcënimet dhe cilësia*
- *A6 Vlerësimi i mbeturinave të ngurta*
- *A7 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe potencialit turistik*
- *A10.1 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë – rrugët dhe transporti*

Dragashi po fillon prej zeros sa i përket planifikimit dhe rregullorëve të turizmit, ka infrastrukturë të kufizuar, si dhe njihet pak, jo vetëm në nivel ndërkombëtar, por edhe vetë brenda Kosovës. Për më tepër, megjithëse pasuritë natyrore të Dragashit përshtaten mirë me planifikimin e turizmit në nivel qendror, ai nuk përmendet posaçërisht në planet shtetërore për zhvillimin e turizmit. Rrjedhimisht, i takon komunës, pa buxhet të posaçëm për turizëm, ta udhëheqë këtë sektor.

Vërtetësia burimore është komponentë e rëndësishme e planifikimit të turizmit. Krahasuar me pikat turistike vendore dhe rajonale, Dragashi i ka tri gjëra të veçanta:

1. Bukurinë natyrore (malet, larmia e bimëve/kafshëve)
2. Kulturën dhe trashëgiminë (kultura dhe mënyra e jetesës në Gorë dhe Opojë)

3. Mikpritjen dhe ushqimin (ushqimi vendor; mikpritja në fshatra)

Duke u mbështetur në këta faktorë, është e udhës që zhvillimi i turizmit në Dragash të bëhet përmes kombinimit të natyrës dhe kulturës fshatare. Kjo mënyrë natyrore e jetesës, me mikpritjen tradicionale, bujqësinë dhe blegtorinë e saj, është zhdukur në pjesën më të madhe të Evropës, prandaj do të ishte një përvojë e veçantë për turistët.

Kushti kryesor për zhvillimin e turizmit në Dragash është që të ruhet mjedisi natyror dhe trashëgimia kulturore. Turizmi masiv bie ndesh me këto synime, prandaj strategjia e turizmit duhet të drejtohet kah këto grupe:

1. Turistët vendorë që janë të interesuar të përjetojnë natyrën, kulturën dhe jetesën e shëndetshme
2. Bashkatdhetarët që vijnë nga diaspora gjatë muajve të verës
3. Ndërkombëtarët që jetojnë në Kosovë dhe dëshirojnë ta njohin vendin
4. Tursitët ndërkombëtarë që janë të interesuar për përvoja të veçanta natyrore dhe kulturore

Popullata vendore duhet të përfshihet aktivisht në hartimin dhe realizimin e strategjive për turizmin vendor kulturor dhe natyror, duke përfshirë shtrirjen e veprimtarive turistike me qëllim të mbrojtjes së pasurive natyrore dhe kulturore nga ndryshimi apo shfrytëzimi që mund të pësojnë nga veprimtaritë tregtare. Vetëdijesimi rreth pasurive natyrore dhe kulturore të Dragashit, vlerës së tyre dhe mënyrës si duhen trajtuar është një faktor i rëndësishëm për mbrojtjen e tyre. Duhet të realizohen fushata vetëdijesuese të përbashkëta për rajonet e Gorës e të Opojës, me nxënës, të rinj dhe të gjitha shtresat e popullatës.

Përpilimi dhe mirëmbajtja e inventarit të pasurive të trashëgimisë kulturore, si dhe ndërmarrja e masave aktive për ruajtjen dhe restaurimin e tyre, është detyrim ligjor dhe çmohet lart në nivel evropian dhe më gjerë. Trashëgimia kulturore është dëshmi e kulturës së përbashkët evropiane dhe ballkano-perëndimore; ruajtja e saj është tejet e rëndësishme për gjithë shoqërinë, për shkak se është pjesë e historisë së përbashkët të maleve të Sharrit dhe gjithë Kosovës. Ruajtja e pasurive të tilla mundëson kërkime arkeologjike dhe të tjera në të ardhmen, të cilat do të mund të rrisnin njohuritë historike, shoqërore dhe shkencore për këtë rajon.

Formimi i grupeve punuese i jep mundësinë popullatës të hartojë strategji për përdorimin e burimeve natyrore dhe kulturore për turizëm dhe veprimtari të tjera fitimprurëse. Këto grupe gjithashtu mund të shërbejnë si forume për diskutimin dhe regjistrimin e rrëfimeve vendore, gjë që do ta lehtësonte kërkimin e nevojshëm rreth pasurive kulturore/natyrore. Duhet të organizohen stërvitje për aspekte të ndryshme të trashëgimisë dhe turizmit, administrim dhe veprimtari më teknike (si meremetimi i përshtatshëm i ndërtesave) me qëllim të shtimit të kapaciteteve.

Dragashi është gjithashtu në garë të drejtpërdrejt me qendra të tjera fshatare të turizmit natyror në rajon, të cilat janë zhvilluar jo vetëm falë investimeve më të mëdha nga donatorët, por edhe për shkak të punës së bordeve shtetërore në hartimin e strategjive të qëndrueshme të zhvillimit. Angazhimi AKK-së dhe përforcimi i 'kulturës së Maleve të Sharrit', ku marrin pjesë bashkësi komunash (bile edhe vendesh) të ndryshme që kanë të përbashkëta vargmalet dhe ngjashmëri kulturore, janë faktorë kyçë për zgjerimin e tregut të turizmit dhe prodhimeve vendore. Këta dy faktorë mund të ndihmojnë edhe rritjen e kërkimeve rreth zhvillimit historik dhe kulturor të rajonit. Në Kosovë ka pasur një numër nismash për zhvillimin e turizmit rural (Hoça e Madhe, Novobërda, Rugova), që janë treguar të suksesshme në shkallë të ndryshme. Do të ishte e udhës që të merreshin për bazë mësimet dhe përvojat e fituara nga projektet e realizuara në komuna të ndryshme të Kosovës, si dhe në rajon e më gjerë. Kjo duhet të përfshihet në stërvitjen dhe fushatat vetëdijesuese për administratën dhe popullatën vendore, si dhe duhet të shërbejë si udhëzues gjatë përgatitjes së strategjisë zhvillimore.

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

AKK-ja gjithashtu mund të ndihmojë në përgatitjen e një strategjie turistike rajonale, planit përfundimtar dhe sistemit bashkërendues; kështu do të përfitonin të gjitha komunat e rajonit jugor e sidomos ato që bien në territorin e parkut nacional të Sharrit. Ky i fundit duhet të shihet si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në këtë zonë, sidomos për turizmin natyror. Natyrisht, veprimtaritë duhet të bashkërendohen me zyrtarët e parkut, si dhe me strategjinë për administrimin e tij.

Zhvillimi hapësinor i Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore është pasqyruar në Hartën e Udhëzimit G8: Udhëzimi për Turizëm dhe Trashëgimi Kulturore.

8.8 Bujqësia

Qëllimet e përgjithshme
<p>Përmirësimi i performancës së sistemeve të bujqësisë dhe blegtorisë të komunës, kryesisht sa i përket punësimit dhe të ardhurave për popullatën, përmes përmirësimit dhe shfrytëzimit të resurseve lokale në mënyrë të përshtatshme për ambientin, organizimin e tyre mbi zinxhirin e vlerës dhe përmirësimin e kapaciteteve për të qenë konkurrues gjersa ruhet një ambient i qëndrueshëm, paanësi gjinore dhe shoqërore, në afat të gjatë.</p> <p>(shihni gjithashtu Strategjinë e Zhvillimit Lokal Ekonomik, PKZH-në: për integrim në Forumin për Zhvillim Ekonomik të Dragashit (FZHED) dhe aktivitetet)</p>
Objektivat
<p>Themelimi i një qeverisjeje të shëndoshë të sistemeve të bujqësisë dhe blegtorisë në përgjegjësi të komunës, përmes ofrimit të ndihmës rrjeteve të niveleve të shumta në nivel qeveritar (në mesin e drejtorive/departamenteve komunale për ekonomi, bujqësi, arsim, etj.), në nivel të shoqërisë lokale civile (përmes shoqatave dhe rrjeteve të shoqërisë civile dhe institucioneve publike), në nivel ndër-komunal (në mes të komunave fqinje), në nivel vertikal (koordinimi me qeverinë kombëtare).</p> <ul style="list-style-type: none">• Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrenca e zinxhirëve të vlerave me potencial të lartë ndikimi mbi zhvillimin afatgjatë, si:<ul style="list-style-type: none">○ mishi i bagëtime të vogla;○ leshi dhe lëkura;○ qumështi dhe produktet e qumështit;○ patatet;○ pemët dhe frutat e shkurreve (manaferrat);○ kultivime të posaçme (barishte, bimë mjekësore, fidane) dhe○ bletët dhe produktet.• Përmirësimi i përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore, përmes efektshmërisë dhe konkurrencës së rritur;• Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së produktit përmes dispozitës së objektit dhe mundësive për trajnim në nivel certifikimi• Krijimi i të ardhurave shtesë për bujqit dhe banorët ruralë, posaçërisht për femra, që shpijnë në përmirësimin e standardeve jetësore dhe kushteve të punës në zonat rurale, duke përdorur produkte të cilat nuk janë të prodhuara nga druri i pyllit, dhe tek turizmi/tregjet lokale të bujqve;
Veprimet
<p>A) Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrencës së zinxhirëve të vlerës, duke u përqëndruar në:</p> <ul style="list-style-type: none">• Mishi (përqëndrimi në rritjen e gjedhëve lokale të vogla, dele dhe dhi);• Qumështi dhe produktet e qumështit;• patate (sidomos patatet për farë);• pemë dhe frute të shkurreve dhe kultivime të posaçme (barishte). <p>përmes</p> <p>A1) përmirësimit të blloqeve prodhuese;</p> <p>A2) trajnimit profesional për teknikat moderne të prodhimit, marketing dhe kontroll të cilësisë/nivel certifikimi;</p> <p>A3) përmirësimit të strategjive të marketingut për të rritur shitjet lokale, kombëtare e së paku në nivel regjional (Ballkan) (shihini gjithashtu B3).</p>

B) Zhvillimi, së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZH) dhe Drejtorinë e Parqeve Nacionale/MMPH

- B1) Lehtësimi i mbështetjes për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZH) (për shembull me "Programin mbi Mbështetjen Direkte për Bujqësinë 2012")
- B2) Sistemi për menaxhimin e kullotave për të përmirësuar prodhimin dhe për të ruajtur ekosistemin malor;
- B3) Zhvillimi i objekteve për procesin e certifikimit sipas standardeve ndërkombëtare;
- B4) Krijimi i një "Emri markë/dallues" për rajonin Dragashit dhe mjedisin, si dhe promovimi i përdorimit të tij për produktet lokale.

C) Shtjellimi i strategjive të niveleve të larta në mënyrë që të rritet dhe përmirësohet integrimi i produkteve lokale

- C1) Për: PPD (Pemë, Perime dhe Drithëra) në sistemin prodhues të Dragashit;
- C2) Mbështetja e Qeverisë Kombëtare në inicimin e një procesi për të njohur Dragashin si një "Rezervat zyrtar i Biosferës" së UNESCO-së" (Programi për Njeriun dhe Biosferën i UNESCO-së, 2012).

Planifikimi i mëtutjeshëm

Fuqizimi i Drejtorisë Komunale për Bujqësi në aftësitë e tyre teknike dhe kompetencat e menaxhimit për të mbështetur dhe udhëhequr ndryshimet në strategjitë e prodhimit bujqësor, cilësinë e vetë dhe në qasjen në treg. Këtu kërkohet përpjekje e fortë dhe e përbashkët për të drejtuar fushën bujqësore në një zonë të veçantë të afarizmit që përdor të gjitha resurset e veta natyrore në mënyrë të mençur dhe jo shkatërruese.

Prandaj, planifikimi i mëtejshëm përfshin zhvillimin e Planit Komunal të Veprimit – së bashku me ata që mbajnë bagëti, me bujqit, dhe elementet kyç:

- Çfarë mund të bëjnë bujqit/shoqatat e bujqve për të përmirësuar performancën dhe konkurrencën e tyre?
- Çfarë mbështetje u duhet?
- Çfarë përkrahje dhe ndihme mund të ofrojë komuna?

Përgjegjësia /korniza institucionale

Përfshirja e drejtpërdrejtë:

Drejtoria e Bujqësisë , Turizmit, Zhvillimit Rural dhe Inspektimit është përgjegjëse për:

1. Përpilimin e planeve për analizë të informatave dhe programeve, të cilat më tej shërbejnë si bazë për përcaktimin e politikave në fushën e bujqësisë;
2. Kryerjen e të gjitha punëve të cilat më tej do të kontribuojnë në progresin e përgjithshëm për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë dhe blegtorisë;
3. Përgatitjen e draft rregulloreve, e urdhrave administrativë dhe e vendimeve në mënyrë që të rregullohen çështjet e ndryshme në bujqësi dhe blegtori, si dhe në sektorët privatë dhe ata shoqërorë;
4. Mbajtjen e të dhënave mbi të gjitha sipërfaqet e patundshmërisë dhe në fushën e blegtorisë;
5. Analizën e situatës në terren sa i përket fushës së bujqësisë dhe blegtorisë;
6. Dhënien e lejeve për regjistrimin e mekanizmave bujqësorë;
7. Përpilimin e planeve dhe programeve për zhvillimin e turizmit, veçanërisht për fshatra;
8. Përpilimin e planeve dhe programeve për infrastrukturë dhe zhvillim rural në komunë;
9. Punët për zhvillimin e infrastrukturës së fshatrave rurale dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit është përgjegjëse për:
 1. Përpilimin e rregulloreve komunale mbi çështjet financiare;
 2. Ofrimin e këshillave profesionale në fushën e buxhetit komunal për organet komunale;
 3. Krijimin e planeve konkrete për zhvillim të qëndrueshëm të komunës;
 4. Krijimin e planeve konkrete për zhvillim të industrisë artizanale;

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

5. Përpilimin e planit për përdorim të resurseve ekonomike të komunës;
6. Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Përfshirja indirekte:

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjëse për:

1. Përpilimin e planit zhvillimor të komunës në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
2. Përpilimin e planit për zhvillim hapësinor, urban dhe rural të komunës, në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
3. Kryerjen e vlerësimit mbi prona, sipas kriterit të kërkuar dhe standardeve të caktuara nga legjislacioni;
4. Mbajtjen e të dhënave mbi pronat e pasurive të patundshme dhe të regjistrit të tokës komunale, përditësimin e pronave në bazë të verifikimit të dokumenteve, mbrojtjen e pronës nga uzurpimi prej komunave të tjera;
5. Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit dhe për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta

Në nivel kombëtar:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, infrastrukturës ligjore, inspektimit dhe për kapacitetet njerëzore për zhvillim mbi çështjet e lidhura me bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural në nivel qendror.
- Agjenci dhe shoqëri të ndryshme (shihni “Referencat”) të përgjegjshme për shërbime ushqimore dhe veterinarë, për rritje të bagëtive, për çështje të përpunimit të prodhimeve qumështore, për bujqësi dhe zhvillim rural.

Afati kohor	Implikimi financiar
Projektet prioritare (masat afatshkurta) <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i Planit Komunal të Veprimit • Lehtësimi i mbështetjes së Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (B1) 	i ulët i ulët
Masat afatmesme <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i performancës ekonomike dhe konkurrencës së zinxhirëve bujqësorë të vlerës (A) • Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e kullotave (B1) • Zhvillimi i një “marke” për rajonin (B3) 	i lartë i ulët i ulët
<ul style="list-style-type: none"> • Masat afatmesme Krijimi i instrumenteve për procesin e çertifikimit (B2) • Përmirësimi i integritetit të produkteve lokale (C1) • Përkrahja e Qeverisë Kombëtare në inicimin e procesit të njohjes së Dragashit si “Reservë Biosfere” e UNESCO-s (C2) 	i ulët mesatar i ulët
Vlerësim	
Strategjia për bujqësinë do të dëmtojë mjedisin. Përkrahja e traditave ekzistuese bujqësore do të mbrojë florën dhe faunën speciale nëpër male dhe trashëgiminë kulturore në Dragash. Zhvillimi socio-ekonomik do të përkrahët nga kjo strategji.	

Arsyet

Zhvillimi i qëndrueshëm në Dragash është i mundur nëse kushtet rurale të jetesës dhe gjenerata e re përkrahen dhe kanë qasje në mundësi tërheqëse për krijimin e standardit të mirë jetësor. a.

Komuna duhet të kryesojë në mënyrë të dedikuar krijimin e mundësive për të:

- Ndihej shoqatat bujqësore dhe qasjen e tyre në treg
- Përkrahja e trajnimit dhe ndërtimi i kapaciteteve për të rinjtë në fushat e reja bujqësore (bimët mjekësore, manaferrat, pemët etj.) si dhe “bujqësia ekologjike dhe mbarështimi i kafshëve”
- Hetimi i mundësisë për rezervë biosfere, e përshtatshme për ekonominë lokale, produktet lokale dhe vënia e “brendit” për Dragashin.

Sipas Planit të Kosovës për Strategji të Zhvillimit (PKSZH) vizion i përgjithshëm për bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë gjatë 2007–13 është të

“bëhet një kontribut i balancuar në mirëqenien ekonomike, mjedisore, shoqërore dhe kulturore të zonave rurale dhe të Kosovës si tërësi, përmes partneriteteve efektive dhe përfituese ndërmjet sektorit privat, qendror/qeverisë lokale dhe komuniteteve lokale brenda kontekstit evropian.”

Për ta bërë këtë vizion real për zonat malore të Dragashit është me rëndësi që për së afërmi të merren parasysh potencialet dhe kufizimet e kushteve mjedisore dhe mundësitë e tyre:

- a. Në përgjithësi (mund të jenë të mundshme disa përjashtime për shkak të kushteve specifike lokale klimatike) bujqësia është konkurruese vetëm deri në një lartësi prej 1300 metrash. Kushtet klimatike për kullota intensive dhe pemë janë të përshtatshme gjer në 1600 metra dhe më lartë, gjersa në përgjithësi kushtet klimatike (periudha vegjetative) janë optimale për kullosa të gjera.
- b. Është me rëndësi të theksojmë, që shumica e peizazhit të Dragashit është rezultat i praktikave shekullore të përdorimit, të cilat gjithashtu janë prejardhja e biodiversitetit (llojlojshmërisë biologjike) ekzistues dhe e peizazhit atraktiv. Ndryshimi i stilit të përdorimit të tokës do të ndërhynte në biodiversitet.

Hartat Vlerësuese “A5.3 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve – kapaciteti produktiv i tokave” dhe “A5.4 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve -blegtoaria dhe përshtatshmëria për të korrat (të lashtat)” ofrojnë të dhëna themelore për Udhëzime Zhvillimore dhe përshkrime:

- përshtatshmëria e tokave për lloje të ndryshme të bujqësisë nën 1600m lartësi;
- menaxhimi ekzistues për kullosa (të dhëna të kufizuara në dispozicion);
- tokë e përshtatshme për të korra (nën 1300 m lartësi dhe më pak se 30^o të pjerrësisë në katër (4) kategori);
- tokë e përshtatshme për kullosa (nën 1600 m lartësi, 3 kategori);
- tokë e përshtatshme për kullosa të gjera mbi 1600 m lartësi;
- për çdo hektar të fshatit të tokës punuese (lërueshme), për çdo hektar të tokës punuese heterogjene , për çdo hektar të kullosave dhe për çdo hektar të gjelbërimit natyror;
- për çdo fshat numri i njësive të lopëve/bagëtive, numri i njësive të deleve/bagëtive.

Harta “G2.2 Udhëzime për Bujqësi” karakterizon zonat e preferuara si në vijim:

- jo të përshtatshme për kullota dhe menaxhim të kullotave (vetëm vegjetacioni i rrallë ose shkëmbinj);
- të përshtatshme për menaxhim të gjerë të kullotave – të mbrojtura për kullota (mbi 1600 m)

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

- të përshtatshme për kullosa të gjera ose intensive, duke përfshirë prodhimin e sanës – zhvillimi është i mundshëm (në mes të 1300 dhe 1600 m)
- të përshtatshme për bujqësi, kultura të veçanta dhe kullota intensive – zhvillimi është i mundshëm (për toka më të mira dhe nën 1300 m)

Për më tepër, zonat të cilat momentalisht kanë kryesisht kullota, rekomandohen për pyllëzim, për shkak të masave për reduktimin e rrezikshmërisë tokësore (gjeo-rrezikshmërisë).

Agjencitë dhe shërbimet përkatëse:

- A)** Shërbimet Veterinare të Kosovës
- B)** Shoqata Kosovare e Prodhuesve të Qumështit (SHKPQ)
- C)** Shoqata Kosovare për Përpunim të Produkteve të Qumështit (SHKPPQ)
- D)** Shërbimet Veterinare dhe Ushqimore të Kosovës (SHVUK)
- E)** Qendra Kosovare për Mbarështim të Bagëtisë (QKMB)
- F)** Programi mbi Mbështetjen Direkte të Bujqësisë 2012 – Sektori i prodhimit (Drithërat: grurë dhe misër) – dhe të Sektorit të Blegtorisë (Gjedhe: lopë qumështore; Bagëti të vogla: dele dhe dhi)
- G)** Projekti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Kosovë (PBZHRK 2007–13), Banka Botërore dhe MBPZHR

8.9 Pylltaria

Synimet e përgjithshme
<p>Mirëmbajtja dhe zgjerimi i zonës ekzistuese të pyjeve, si dhe përmirësimi i menaxhimit të tyre me qëllim të shtimit të prodhimit të dhe furnizimit me drunj për ngrohje, veçanërisht përmes shfrytëzimit më produktiv dhe të qëndrueshëm të burimeve ekzistuese të zabeleve. Mbështetja dhe lehtësimi i aftësive të përmirësuar të menaxhimit të pyjeve mund të jetë ndihmesë për të shtuar prodhimin dhe për të ruajtur biodiversitetin e zonave pyjore.</p> <p>Mbështetja dhe lehtësimi i menaxhimit teknik të pyjeve në pajtim me standardet e Këshillit Drejtues të Pyjeve (Forest Stewardship Council - FSC) dhe Certifikimi për Menaxhim të Pyjeve në Kosovë.</p> <p>Pyllëzimin e tokës së përshtatshme dhe të braktisur, e cila cilësohet për produktivitet të ulët bujqësor Në periudhën afat-mesme, pyllëzimi është një mundësi reale për të rritur zonën pyjore me drunj autokton gjethegjërë (me teknikat aktuale të ngrohjes, haloret nuk mund të përdoret për dru zjarri për shkak të përmbajtjes së rrushirw) ekziston një potencial i konsiderueshëm.</p> <p>Pyjet e reja në zonat e pjerrëta do të mund të kontribuonin në mbrojtjen nga orteqet, gërryerjet e tokës dhe rrëshqitja e dheut.</p> <p>Përgjithësisht, pyjet e reja do të zgjerojnë burimet produktive për prodhimet jo drurore, siç janë kërpudhat.</p> <p>Rreziku i djegies së pyjeve duhet të merret seriozisht dhe ekziston nevoja për përmirësimin e paralajmërimit të hershëm dhe për procedurat e masat e kontrollit të zjarrit dhe zjarrfikjes. Praktikrat e këqija të djegies së zonave të kullosave dhe mbetjeve të korrje-shirjeve në tokën bujqësore rrisin rrezikun e zjarreve të egra, sidomos në periudha të thata të vitit.</p>
Objektivat
<p>Krijimi i një qeverisjeje të shëndoshë të sistemit pyjor përkatës në përgjegjësi të komunës, përmes lehtësimit të rrjeteve shumë-nivelëshe në nivel qeveritar (ndërmjet departamenteve komunale të ekonomisë, të bujqësisë, të arsimit, etj), në nivel lokal të shoqërisë civile (përmes shoqatave dhe rrjeteve të shoqërisë civile dhe institucioneve publike), në nivelin ndër-komunal (ndërmjet komunave fqinje), në nivel vertikal (bashkërendimi me qeverinë kombëtare).</p> <ul style="list-style-type: none">• Përmirësimi i strukturës së zabeleve përmes trajtimeve pyjore (krasitja, pastrimi përreth drunjve, intervalet adekuate të prerjes, mbjellja e drunjve)• Lehtësimi/ndihmesa e certifikimit të pyjeve publike në pajtueshmëri me standardet e FSC-së për të mundësuar hyrjen në tregun ndërkombëtar, rritjen e vlerave të drurit për ngrohje dhe, në të njëjtën kohë, për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve pyjore• Rritja e zonës pyjore me specie autoktone të drunjve gjethegjërë në tokat e braktisura dhe në zonat e pjerrëta, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimtari bujqësore• Pyllëzimi me drunj autoktonë halorë në zonat që nuk janë të përshtatshme për drunj gjethegjërë, me qëllim të kontrollit të gërryerjes së tokës dhe orteqeve dhe për prerjen e drunjve industrialë në të ardhmen• Shtimi i prerjeve ligjore të drunjve për ngrohje dhe atyre industrial do të ndihmojë përmirësimin e strukturës aktuale të pyjeve dhe do të rrit gjenerimin e të hyrave për komunën (Me aprovimin e planit Hapsinore të Parkut do të percaktohen veprimet ekonomike të menaxhimit të pyjeve sipas zonave. Prerjet fitosanitare, rrallimet para tregtare dhe tregtare të pyjeve, veprimtarite të lejuara ndikojnë në permisimin e struktureve të pyllit)• Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve publike.• Rritja e vetëdijësisë mbi rrezikun nga zjarret e djegies së kullosave dhe mbetjeve bujqësore,

nëse ato digjen në mënyrë të pakontrolluar
Veprimet
<p>A) Përmirësimi i strukturës pyjore</p> <p>A1) Aplikoni dhe rritni në masë të gjerë rrallimin e pyjeve cungishte (te ulta) që dominohen nga pyjet e ahut dhe specieve tjera gjethegjerë; aplikoni interval të përshtatshme të prerjes dhe mbjellni drunj të rinj, ku kërkohet</p> <p>A2) Ofrimi i mundësisë për komunitetet për prerjen e drunjve të zjarrit nën kontrollin e Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe sektorit pyjor të komunës, me anë të rojtarëve të pyllit, të cilët do të përgjigjen për një zonë të caktuar të pyllit dhe çdo qark i pyllit të komunës ka rojen e vet. Kjo mund të ndihmojë në mirëmbajtjen e pyllit dhe të sigurojë burime për komunitetin.</p> <p>A3) Përgatitni një plan pyllëzimi për komunën, në bashkëpunim të ngushtë me fshatrat, Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe Drejtoratin Kombëtar të Parqeve</p> <p>A4) Mbështetni krijimin e fidanishteve vendore për riprodhimin e popullatave vendore të cilësisë së lartë për mbëltim dhe pyllëzim</p> <p>A5) Mbjellja me specie vendore, autoktone, e zonave të cilat kanë mbetur të papërdorura për shkak të prodhimitarisë së ulët, në lartësi më pak se 1500m dhe me fokus në zonat që janë me prirje për fatkeqësi (erozioni, ortekët dhe shkarja e tokës)</p> <p>A6) Fillimi dhe/ose përkrahja e procesit të çertifikimit për pyjet me produktivitet të lartë sipas standardeve të FSC të Kosovës. Sigurimi i menaxhimit të pyjeve të vjetra në pajtueshmëri me standardet e FSC-së</p> <p>A7) Rritja e prerjes së pyjeve të larta me kusht që të jenë siguruar praktika të mirëfillta të menaxhimit pyjor. Kjo do të mund të përmirësonte strukturën e pyjeve dhe produktivitetin e tyre në të ardhmen dhe do të prodhonte drunj industrialë për të shtuar të hyrat në buxhetin komunal</p> <p>A1) Increase harvesting in high forests if good forest management practices can be assured. This can improve the forests and their future productivity, and produce technical wood to increase income for the municipality budget</p> <p>A8) Vendosni mekanizma efektivë të paralajmërimit të hershëm të zjarreve</p> <p>A9) Përmirësoni kualifikimet dhe aftësitë kontrolluese të rojtarëve të pyjeve. (delete)</p> <p>B) Përmirësimi i strukturave administrative</p> <p>B1) Përforsimi i rolit të zyrarrit të pylltarisë në “Drejtorinë Komunale për Bujqësi, Turizëm, Zhvillim Rural dhe Inspektion”.</p> <p>B2) Përkrahja e bashkëpunimit të ngushtë të zyrtarit komunal për pylltari, zyrtarit për ruajtje të natyrës dhe sektorin turistik (zyrtari për zhvillim të turizmit)</p> <p>C) Rritja e vetëdijësimit</p> <p>C1) Përgatitni fushata vetëdijësimi, duke paraqitur efektet negative nga dhe rreziqet që u shkaktojnë pyjeve dhe diversitetit të tyre zjarret pyjore</p> <p>C2) Diskutoni me komunitetin planet vjetore ashtu që t’i inkorporoni nevojat e tyre dhe t’i integroni ata në procesin planifikues</p> <p>C3) Hulumtoni mundësitë për të përdorur halorët për teknologjitë e reja të ngrohjet (kokërra apo pelete, etj.)</p> <p>D) Programet stërvitore</p> <p>D1) Stërvitjet dhe ushtrimet në rast emergjencash për paralajmërimin e hershëm të zjarreve dhe për fikjen/luftimin e zjarreve pyjore</p> <p>D2) Stërvitja e rojtarëve të pyjeve</p> <p>D3) Praktikrat menaxhuese për pronarët privatë të pyjeve (veçanërisht menaxhimi i zabeleve)</p>
Planifikimi i mëtutjeshëm
<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e planit të pyllëzimit për komunën në bashkëpunim të ngushtë me fshatrat, APK dhe Drejtorinë e Parkut Nacional • Shtjellimi i një strategjie të përbashkët për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve, mbrojtjes së

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

tyre dhe menaxhimit pyjor të parqeve nacionale me Ministrinë e Bujqësisë: Departamenti i Pylltarisë, Agjencia Kosovare e Pylltarisë dhe Drejtorati Kombëtar i Parqeve, si dhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor	
Përgjegjësia / Korniza institucionale	
<ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësitë komunale dhe kombëtare në lidhje me menaxhimin e pyjeve janë rregulluar me Ligjin Nr. 2003/3 Pyjet e Kosovës dhe me Amandamentin e Ligjit Nr. 2003/3 Pyjet e Kosovës (Mars, 2010): Viti V / Nr. 67/29 • Një zyrtar i “Drejtoratit Komunal për Bujqësi, Turizëm, Zhvillim Rural dhe për Inspektim” është përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve dhe është mbikëqyrës i shtatë (7) rojtarëve të pyjeve (këta janë në listën e pagave të komunës) • Ky zyrtar punon ngushtë me dhe bashkërendon me Agjencinë Rajonale të Pylltarisë (Prizren) – Agjencia Kosovare e Pylltarisë • Komunat kanë përgjegjësi për mbrojtjen e pyjeve dhe për sigurimin e procedurave korrekte tenderuese për prerjen e pyjeve. Komuna është përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve nga prerja ilegale e drunjve dhe nga rreziqet tjera. Në shtesë, është poashtu përgjegjësi e saj të sigurojë një proces korrekt të vlerësimit të tenderave për prerjen e drunjve <p>Komuna ka këto kufizime për sa i përket politikës së pyjeve dhe menaxhimit të tyre: Në komisionin për vlerësim duhet të marrin pjesë përfaqësuesit nga Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (MBPZHR). Tenderimi inicohet në pajtim me planet vjetore të përgatitura nga MBPZHR – Agjencia Pyjore e Kosovës (APK). APK është e hapur për diskutim publik përpara se të miratohet dhe të përmbahet plani. Praktikant aktuale të diskutimeve publike nuk janë treguar efektive, mendohet për shkak të mungesës së kapaciteteve teknike në Komunë në planifikimin si dhe në përdorimin e planeve menaxhuese (planet 10 vjeçare), të cilat ofrojnë shifra mbi kapacitetet prodhuese të pyjeve. Kryesisht në mungesë të kapaciteteve dhe shkaqeve tjera APK nuk merr kurrfarë propozim komentesh, verejtjesh, sugjerimesh dhe plotësime dhe planet gjithnjë miratohen pa marrë parasysh nevojat e komunitetit dhe shfrytëzimin maksimal të pyjeve në baza të qëndrueshme.</p>	
Afati kohor	Implikimi financiar
Projektet priprite (masat afatshkurta) <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e furnizimit me dru zjarri për komunitetin me një program për pyjet cungishte (te ulta), me anë të aplikimit të masave të silvikultures pylltarisë – (duke përfshirë shërbimin këshillues, bashkëpunimin me APK dhe Drejtorinë e Parkut Nacional dhe kurset për trajnim të pronarëve të pyjeve) (A1, D3) • Dhënia e mundësive për komunitetin që të organizojnë prerjen e drunjve aty ku planifikohet prerja e drunjve të zjarrit (A2) • Pyllëzimi i tokës së braktisur me fokus në zonat që janë me prirje të fatkeqësive (A5) • Fillimi dhe/ose përkrahja e procesit të çertifikimit të pyjeve me produktivitet të lartë sipas standardeve FSC të Kosovës. (A6) 	i lartë i ulët i lartë mesatar
Masat afatmesme <ul style="list-style-type: none"> • krijimi i mekanizmave për paralajmërim të hershëm nga zjarri (A8) • Përmirësimi i kualifikimit dhe shkathtësive kontrolluese të rojtarëve të pyllit (A9) • Përmirësimi i strukturave administrative (B) • Përgatitja e fushatave të vetëdijësimit (C1) • Diskutimi i planeve vjetore të pylltarisë me komunitetet (C2) • Stërvitja e dhe ushtrimet emergjente për zjarrfikës (D1) 	mesatar mesatar i ulët mesatar mesatar i ulët

<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi i rojtarëve të pyjeve (D2) 	i ulët
Masat afatgjate <ul style="list-style-type: none"> • Përkrahja e krijimit të çerdheve lokale (A4) • Përmirësimi i prerjes së pyjeve të larta nëse sigurohen përvojat e mira të menaxhimit të pyjeve (A7) • Hulumtimi i mundësive për përdorimin e drunjve halor për teknologjitë e reja të ngrohjes (C3) 	i lartë mesatar mesatar
Vlerësim	
Strategjia për pylltari nuk do të dëmtojë mjedisin. Pyllëzimi dhe pylltaria sipas standardeve FSC do të zhvillojë dhe ruajë habitatet me vlera të larta mjedisore. Masat zjarrfikëse do të ndikojnë pozitivisht në mjedis. Zhvillimi socio-ekonomik do të përkrahet me këtë strategji duke shtuar cilësinë e produkteve të bagëtisë dhe përkrahja e qytetarëve që kanë dru zjarri.	

Arsyeshmëria

Hartat vlerësuese në vijim ofrojnë të dhënat bazë për Udhërrëfyesin Zhvillimor:

- *A4.1 deri në A4.3 Vlerësimi i rreziqeve natyrore*
- *A5.1 deri në A5.2 Vlerësimi i bujqësisë dhe i pylltarisë – gjendja e pyjeve dhe funksionet pyjore*

Harta “Pylli G2-1” karakterizon zonat preferenciale për përdorimin e pyjeve dhe mbrojtjen e tyre si:

- Zonat që nuk duhet të kenë çfarëdo përdorimi pyjesh dhe duhet të jenë zona pyjesh të mbrojtura (kryesisht pyjet me qasje shumë të vështirë dhe zonat në linjen ndarese të pyjeve me habitat tjera dhe pyjet pranë lumenjve, të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen e rrjedhës së ujit dhe të qëndrueshmërisë
- Zonat, të cilat do të mund të gëzonin menaxhim pyjor sipas *Krierve të FSC-së*
- Zonat, të cilat kërkojnë plane rehabilitimi e menaxhimi për të rritur prodhimtarinë dhe njëkohësisht për të mirëmbajtur dhe për të përmirësuar funksionet e tyre mbrojtëse ekologjike (ruajtja e ujit dhe zvogëlimi i rrezikut gjeografik)
- Zonat, të cilat mund të zhvillohen me konsideratë të veçantë të funksioneve mbrojtëse ekologjike (ruajtja e ujit dhe zvogëlimi i rrezikut gjeografik)
- Zonat, të cilat mund të zhvillohen pa kufizime

Tutje, zonat të cilat aktualisht janë kryesisht me kulloza sugjerohen për pyllëzim me qëllim të aplikimit të masave për zvogëlimin e rrezikut gjeografik.

- 1) Dragashi ndodhet në një zonë të lartë malore, subalpine, e cila karakterizohet me dimra të gjatë. Pyjet janë një burim i rëndësishëm për njerëzit e Dragashit, për furnizim me drunj zjarri por, deri në një masë, edhe për drunj industrialë. Pyjet kanë një rëndësi të madhe për biodiversitetin si habitate/vendbanime dhe korridore ekologjike, si dhe funksionet e pyjeve të lidhura me minimizimin e rrezikut dhe mbajtjen e baraspeshës ujore në mbarë Dragashin janë qenësore për ekuilibrin ekologjik dhe social të Komunës.

Ekziston një kërkesë e lartë për dru zjarri gjatë dimrave të gjatë, zakonisht për llojet e drunjve gjethegjërë. Tash për tash, furnizimi kryesor vjen nga komunat tjera dhe vetëm pjesërisht nga burimet vetanake pyjore të Dragashit. Megjithatë, potencialet e burimeve pyjore mund të

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

përmirësohen nëse aplikohet menaxhimi dhe trajtimi i duhur. Struktura e pyjeve në Dragash ka kapacitetet për të gjeneruar dru zjarri kryesisht nga aktiviteti i masave të silvikultures (pastrime pyjore, clirime dhe rrallime).

Prodhimi i pyjeve aktuale me zabele në krahasim me ato më mirë të menaxhuara tregon dy herë më shumë shtim në vit (1.3 m^3 kundrejt 3 m^3 në zabele standarde dhe kundrejt $5-7 \text{ m}^3$ rritje në pyje të larta) (shih MBPZHR-APK 2009 dhe 2010).

- Në pyjet publike janë përafërsisht $17\,300 \text{ m}^3$ në vit që mund të priten në mënyrë të qëndrueshme (në bazë të të dhënave zyrtare të menaxhimit të pyjeve, MBPZHR-APK 2009 dhe 2010)
- Në pyjet private janë përafërsisht $4\,400 \text{ m}^3$ në vit që mund të priten në mënyrë të qëndrueshme (sipas vlerësimit nga Arneni, N.SH.T, 2011) Shih Tabelën 1

Tabela 1: Vëllimi i prerjeve dhe të hyrave nga pyjet publike dhe private të Dragashit

Njësitë nën menaxhim	Të hyrat nga prerjet të shprehura në Euro	Shpenzimet nga prerjet dhe nxjerrjet me rrënjë	Të hyrat neto vjetore të shprehura në Euro	Vëllimi potencial vjetor i prerjeve /m ³
Koritniku II	229 858	83 067	146 791	5 358
Opoja	184 685	55 085	129 600	4 879
Bredhiku	260 717	80 553	126 164	7 104
Shuma	675 260	218 705	402 555	17 341
Pyjet private	92 925	35 407.74	57 517.3	4425.97
Gjithsejt	768 185	254 112.74	514 072.3	21 766.97

(MBPZHR-APK 2009 dhe 2010 dhe Arneni, N.SH.T, 2011)

- 2) Këto aktivitete në shtesë do të ndihmonin në përmirësimin e kushteve aktuale dhe të prodhimit të pyjeve me zabele (kryesisht në pronë private) dhe në krijimin e vendeve të punës për banorët vendas. Vlerësim i kryer ky nga MBPZHR-APK 2009 dhe 2010:

Tabela 2: Mundësi punësimi në rrallime dhe pastrim

Komunat	Zona për rrallime	Normat e rrallimes/nxjerrjes/transportit			Ditë pune
Dragash	2 000	606	400	200	1 206

- 3) Për shkak të kërkesave të larta për drunjtë zjarri, madje edhe një rritje në prodhimtarinë pyjore nuk do t'i plotësonte nevojat vjetore. **Rritja e zonave pyjore** për prodhimtari të drunjve për ngrohje me specie autoktone të drunjve gjethegjere do të ishte një mundësi e mirë. Në periudhë afatmesme, pyllëzimi është një mundësi reale për të rritur zonat pyjore me drunjtë autoktone gjethegjere (halorët tradicionalisht shumë pak shfrytëzohen për ngrohje nga komuniteti lokal për shkak të përmbajtjes së rrëshires dhe përdorimit të druveve të Ahut, Dushqeve dhe llojeve të tjera të drurit).

Lokacionet e përshtatshme për pyllëzim janë në dispozicion (shih Hartën udhërrëfyese për pylltari dhe bujqësi), përfshirë zonat që kanë nevojë për pyjet si kontrollues të rreziqeve (orteqet, gërryerjet dhe rrëshqitjet e dheut). Përvojat aktuale tregojnë se ka pasur pyllëzime por kryesisht me halorë, të cilët komuniteti nuk i përdorë për ngrohje. Pyjet e reja gjithashtu do të kontribuonin në fushën e prodhimeve jo drurore siç janë kërpudhat.

- 4) **Certifikimi** i pyjeve sipas standardeve të FSC-së siguron menaxhim të qëndrueshëm të burimeve pyjore, i garanton komunitetit përfitim nga pjesëmarrja në planifikim duke ju ofruar mundësinë për dhe vende të reja të punës për banorët lokalë. Prodhimet, të cilat dalin nga pyjet e certifikuara mund t'ju qasen tregjeve ndërkombëtare dhe çmimet e prodhimeve të tilla janë më të larta.
- 5) Pasojat e zjarreve pyjore të kohëve të fundit në Malin e Koritnikut kanë shënuar humbje dhe kanë rezultuar në shkatërrimin e një hapësire të konsiderueshme të Koritnikut, e cila cilësohet për vlera të larta të drurit për ngrohje dhe biodiversitet, si dhe ato do afektojnë edhe rreziqet nga gërryerjet dhe funksionet tjera pyjore. Rreziku i djegies së pyjeve duhet të merret seriozisht. Praktikrat e menaxhimit të keq të djegies së kullosave dhe mbetjeve të korrje-shirjeve në tokat bujqësore rrisin rrezikun, veçanërisht në periudhat e thata të vitit.
- 6) Kërkohet një rregullore dhe kontroll i rreptë dhe efikas përmes bashkëpunimit me fshatrat, me rojtarët e pyjeve, me Drejtoratin e Parqeve dhe me Agjencinë Rajonale të Pylltarisë. "Problem kronik i pyjeve të Kosovës mbetet ndikim negativ i prerjeve ilegale dhe, sipas vlerësimeve, diku 40% e pyjeve publike dhe 29% të atyre private kanë qenë subjekt i aktiviteteve të pakontrolluara apo ilegale të prerjes së drunjve." (FSC 2010).
- 7) Sipas legjislacionit aktual, të gjithë drunjt nga pyjet publike (drunjt për ngrohje dhe ata industrialë) shiten përmes tenderimit dhe komuniteti nuk ka të drejtë të aplikojë. Shpesh, kompanitë të cilat janë në pronësi të tenderit vijnë nga komunat tjera dhe të gjithë drunjt merren nga komuna dhe shiten në vendet tjera të Kosovës. Në këtë situatë, komuniteti nuk ka kurrfarë përfitimesh dhe atyre u duhet të blejnë drunj për ngrohje me çmime të larta nga zonat tjera të Kosovës. Procedurat tenderuese mund të aplikohen për drunj industrial meqë prerja e këtyre drunjve kërkon teknika speciale dhe kujdes të veçantë. Prerja e drunjve për ngrohje nuk kërkon teknologji special dhe prerja mund të bëhet lehtësisht nga punëtorë të pakualifikuar për punën. Druri për ngrohje plotëson një nevojë të rëndësishme elementare për komunitetin.

8.10 Energji

Synimet kryesore
<p>Furnizimi me energji elektrike, shfrytëzimi i energjisë termike dhe masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin publik dhe privat të Komunës së Dragashit, duhet të pasoj një Strategji afatmesme për Energjinë e komunës së Dragashit [SEKD]. Komuna e Dragashit do ta shfrytëzojë potencialin e vet për prodhimin e energjisë (kapacitet formal prodhues nën 10 MW për elektranë), bazuar në Teknologjitë Ripërtëruese të Energjisë [TRE] për të rritur furnizimin lokal me energji, për të mbështetur ekonominë lokale dhe për t'i ikur ndikimeve negative në mjedis duke përfshirë dëmtimin e mjediseve të lumenjëve dhe biodiversitetit. Mbështetja Komonale e investimeve private në TRE do të rris zhvillimin shoqëror dhe ekonomik; do të gjenerojë vende pune dhe të ardhura për popullatën lokale derisa garanton furnizim të vazhdueshëm me energji dhe të padëmshëm për mjedisin. Zhvillimi Komunal i Energjisë do të inkurajojë kompanitë vendore dhe ndërkombëtare që të inkuadrojnë burimet vendore dhe fuqinë punëtore vendore në planet e tyre të biznesit në mënyrë që të mbështetet Zhvillimi i Komunës.</p>
Qëllimet
<ul style="list-style-type: none">• Planifikimi komunal i energjisë është në pajtim me politikën kombëtare qeveritare për ofrimin e më shumë kapaciteteve për prodhimin e energjisë në fund të linjave të gjata shpërndarëse, bazuar në Teknologjitë Ripërtëruese të Energjisë [TRE] dhe në përmirësimin e Efikasitetit të Energjisë [EE] në sektoret private dhe publike• Strategjia për Energji e komunës së Dragashit [SEKD] është e drejtuar kah sigurimi, mbështetja dhe promovimi i<ul style="list-style-type: none">- Furnizimit të sigurtë, të besueshëm, të padëmshëm për mjedisin dhe të cilësisë së lartë të energjisë elektrike për të gjithë shfrytëzuesit në Komunë të bazuar në standardet teknike të pranuara ndërkombëtarisht, me tarifa të pranueshme dhe të dakorduara me Operatorin Kombëtar [KEK-un]- Përfshirja e TRE në përzierjen energjetike të Komunës- Shfrytëzimi efikas i energjisë elektrike dhe termike në sektorin publik dhe privat, si dhe në shtëpi- Zëvendësimi i shfrytëzimit të paqëndrueshëm të materieve organike(druve) për ngrohjen e hapsirave përmes përmirësimit të Efikasitetit Energjetik të sobave dhe përmes mbeturinave të industrisë së drurit- Zëvendësimi i ngrohësve elektrik të ujit me Sisteme Solare për Ngrahjen e Ujit- Iniciativat e sipërmarrësve dhe kompanive ose konsorciumeve vendore ose ndërkombëtare për të investuar në kapacitetet prodhuese elektrike që kanë të bëjnë me energji• Intervenimet EE në shtëpitë private (poçe elektrike që kursejnë energjinë dhe paisje efikase elektrike), auditime të Energjisë dhe intervenime EE në ndërtesat publike• SEKD do të krijohet në bashkëpunim të ngushtë me banorët e Komunës së Dragashit përmes Grupit Punues të Komunës dhe Grupeve punuese të Fshatrave, si dhe Kuvendit Komunal të Dragashit, administratës komunale dhe ministrive.• Implementimi i Strategjisë për Energjinë do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat të komunës, duke forcuar kapacitetet energjetike të ndërmarrjeve vendore, duke përfshirë krijimin e vendeve të punës dhe tërheqjen e punëtorëve të edukuar respektivisht të shkathtë, më mirë sesa të tolerohet emigrimi i fuqisë punëtore vendore.

- Strategjia komunale për Energjinë do të inkurajojë kompanitë vendore dhe ndërkombëtare të përfshijnë pasuritë vendore dhe fuqinë punëtore vendore në planet e tyre të biznesit në mënyrë që të mbështesin zhvillimin e Komunës.

Veprimet

A) Integroni Komunën në Strategjinë e Kosovës për Energjinë

- A1) Krijoni Zyrën komunale për Energji [ZKE] (e cila harton planifikimin për zhvillim të energjisë, mbikqyrë kontrollet teknike dhe punimet, etj.)
- A2) Krijoni Strategjinë për Energji të Komunës së Dragashit [SEKD], Planin komunal për Veprimet Energjike [PKVE] dhe Planin Komunal për Efeksatitetin e Energjisë [PKEE]
- A3) Merruni me banorët e Komunës së Dragashit Municipality përmes Grupeve Punuese Komunale dhe Grupeve Punuese të Fashatrave
- A4) Implementoni Strategjinë për Energjinë në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat
- A5) Bashkëpunimi i ZKE me Agjencitë Donatore Ndërkombëtare në të gjitha intervenimet që lidhen me energjinë

B) Në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë të Mbështet Prodhimi i Energjisë nën 20 MW⁷ (Hidroenergjinë dhe energjinë me erë)

- B1) Ofroni kompanive ose konsorciumeve private për investim, instalim dhe funksionim elektranat me kapacitet formal prodhues nën 10MW.
- B2) Stimulimi i investimeve private për Teknologjitë premtuese të Energjisë Ripërtëritëse (TER) - Hidrocentralet e Vogla (HV), Konvertuesit e Energjisë së Erës (KEE) si dhe përdorimin e biomasave (p.sh. Gazifikimi) – të cilat ndjekin direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian /Komisionit Evropian dhe t'i shmangen ndikimeve negative mbi mjedisin, duke përfshirë dëmtimin e habitatve etë lumenjvebiodiversitetin.
- B3) Angazhoni investitorët dhe kompanitë/konsorciumet private për vëzhgimin e kualitetit ndërkombëtar dhe standardeve mjedisore gjatë ndërtimit dhe funksionimit të këtyre elektranave në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Rregulluese të Energjisë [ZRE].

C) Analiza e Nevojës/Furnizimit dhe Kapacitetet Prodhuese shtesë për Komunën e Dragashit

- C1) Azhurimi i të dhënave ekzistuese për vlerësimin e nevojës dhe furnizimin me energji në të ardhmen
- C2) Vlerësoni kapacitetet e mëtutjeshme të prodhimit të energjisë brenda kufijve të komunës së Dragashit bazuar në hulumtimet e potencialit hidroelektrik, energjisë solare, energjisë nga era dhe potencialit gjeotermik
- C3) Hulumtime të veçanta të potencialit të erërave dhe energjisë solare duke përfshirë vlerësimin e zonave të mundëshme për elektranat që bazohen në TRE brenda kufijve të Dragashit që duhet të kryhen në bashkëpunim me MZHE dhe të financuara p.sh. nga agjencitë donatore, si dhe të krijohet një bazë e të dhënave për propozimin e objekteve shtesë për prodhimin e energjisë në Komunë.

D) Plani komunal për Aplikimin Solar Termik

- D1) Të kryhen analiza potenciale për Sisteme Solare Termike [SST] për sektorin publik dhe privat (spitalet, barnatoret, shkollat, xhamitë, stacionet policore; Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme [NVM] dhe shtëpitë private)
- D2) Inicimi i i seminarëve për vetëdijësimin e shfrytëzuesve të mundshëm privat dhe komercial rreth kostos-dobisë nga SST-së, funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre
- D3) Inicimi i zhvillimit të kapaciteteve dhe trajnimeve për sipërmarrësit vendorë siç janë instaluesit e ujësjellësit dhe instaluesit e nxemjes qendrore
- D4) Shqyrtoni mundësitë e projekteve financuese për investimet private në SST duke përfshirë mundësitë për kredi të vogla në bashkëpunim me MZHE

E) Plani Komunal i Efikasitetit të Energjisë dhe Strategjia e Menaxhimit të fushës së Kërkesës

- E1) Prezantoni zbatimin e Efikasitetit të Energjisë [EE] në sektorin publik, sektorin komercial dhe në shtëpi
- E2) Menaxhimi i fushës së kërkesës me qëllim të shmangjes së ngarkesave maksimale të energjisë duke caktuar orarin e shfrytëzimit të energjisë në atë mënyrë që të minimizohen ngarkesat maksimale
- E3) Përmirësimi i efikasitetit të energjisë termike duke izoluar muret, kulmet dhe duke prezantuar dritaret me humbje të zvogluara të nxehtësisë

⁷ Ligji mbi Ndërtimin i Republikës së Kosovës, Nr. 2004 / 15, Neni 35, pika b

<p>E4) Përmirësimi i efikasitetit të Energjisë në ndriçimet e rrugëve të komunës dhe vendosja e ndriçimeve shtesë në të gjitha fshatrat vetëm përmes teknologjisë EE.</p> <p>E5) Stimulimi dhe ngritja e vetëdijes së grupeve shfrytëzuese duke përfshirë vendimmarrësit e sektorit publik, shfrytëzuesit lokal komercial (pronarët e dyqaneve, restoraneve, kafiterive, etj.), stafi vendor i NVM-ve (elektroteknikët, hidrosanitarët, instaluesit dhe montuesit e tubave, etj.), si dhe qytetarët duke përfshirë nxënësit e shkollave publike</p> <p>E6) Inicimi i rritjes së kapaciteteve dhe trajnim profesional për shfrytëzuesit lokal duke përfshirë vendimmarrësit e sektorit publik, shfrytëzuesit komercial lokal, stafi vendorë i NVM-ve si dhe qytetarët duke përfshirë edhe nxënësit e shkollave publike</p>	
<p>Planifikimi i mëtutjeshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> Të krijohet Strategjia për Energjinë e Komunës së Dragashit [SEKD], Plani Komunal për Veprimet Energjike [PKVE] dhe Plani Komunal për Efikasitetin e Energjisë [PKEE] Vlerësimi i nevojës dhe furnizimit të energjisë në të ardhmen si dhe ngritja e kapacitetit të prodhimit të energjisë brenda kufijve të komunës së Dragashit do të bazohet në hulumtimet e potencialeve të hidroenergjisë, energjisë solare, energjisë nga era, burimeve nga materiet organike dhe potencialit gjeotermik, të kryer nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare dhe institucionet vendore të pranuar dhe me përvojë. Analizat për Sistemet Solare Termike [SST] për sektorin publik dhe privat 	
<p>Përgjegjësia</p> <ul style="list-style-type: none"> Aktivitetet nën SEKD do të rregullohen nga Zyra Rregulluese e Energjisë [ZRE] ose nga Agjencia Kosovare e Efikasitetit të Energjisë [AKEE], respektivisht nën kornizën politike të caktuar nga Qeveria e Kosovës/Ministria e Zhvillimit Ekonomik [MZHE] – Departamenti i Energjisë i Republikës së Kosovës. SEKD-ja e tillë formon një pjesë të dokumenteve për zhvillimin e komunës sipas Ligjit për Energjinë i Republikës së Kosovës (No 03/L – 184), Kapitulli II “<i>Strategjia për Energjinë, Programet Implementuese dhe Bilanci Energjetik</i>”, Neni 6 “<i>Rroli i Qeverisë lokale</i>”, 2010 Komuna ka një rol vendimtarë në çështjet që kanë të bëjnë me energjinë sepse ajo duhet të vendosë për “...të drejtën për qasje në tokat për vendosjen e pasijeve të energjisë dhe objekteve të energjisë” (Ligji për Energjinë, Kapitulli II, Neni 6, paragrafi 2) si dhe duke implementuar një Plan Veprimi të EE-së (Ligji mbi Efikasitetin e Energjisë i Republikës së Kosovës, Neni 9, No 04/L – 016, 2011) Një Zyrë Komonale e Energjisë (ZKE) do të krijohet për <ul style="list-style-type: none"> Të marrur përgjegjësinë brenda administratës komunale për implementimin e SEKD në bashkëpunim me të gjitha autoritetet kombëtare të sektorit energjetik të Kosovës dhe për t’i raportuar kryetarit të komunës. Të qenë adresues dhe homolog i MZHE-së, ZRE-së dhe AKEE-së për çështjet që kanë të bëjnë me energjinë që bien nën strategjinë kombëtare për energjinë dhe legjislacionin kombëtar për energjinë. Si dhe është pike kryesore për Kuvendin Komunal, Grupin Komunal Punues dhe grupet punuese të fshatrave të komunës për të inicuar dhe raportuar zhvillimin energjetik të Komunës dhe propozimin e PKVE-ve. Agjencitë ndërkombëtare donatore duhet të bashkëpunojnë me Zyrën Komonale të Energjisë për të gjitha intervenimet në fushën e energjisë. 	
<p>Afati kohor</p>	<p>Implikimi financiar</p>
<p>Projektet prioritare (masat afatshkurta)</p> <ul style="list-style-type: none"> Themelimi i Zyrës Komonale për Energji (ZKE) (A1) Hartimi i planifikimit energjetik si është përmendur më lartë (A2) Situmulimi i investimeve private në Teknologjitë për Energji Ripërtëritëse (TER) (B2) 	<p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p>

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

<ul style="list-style-type: none"> • Analiza potenciale për Sistemet Termale Diellore (STD) për sektorin publik dhe privat (D1) • Përmirësimi i efikasitetit të energjisë termale me izolimin e mureve, kulmeve, dhe përdorimin e dritareve me humbje minimale të ngrohjes (E3) • Prezantimi i nxitësve dhe rritja e vetëdijësimit për Efikasitetin e Energjisë (EE) të të gjitha grupet e përdoruesve (E5) 	<p>i ulët</p> <p>i lartë</p> <p>i ulët</p>
<p>Masat afatmesme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi i banorëve të Dragash (A3) • Bashkëpunimi i ngushtë me sektorin privat dhe Agjencitë Ndërkombëtare Donatore (A4, A5) • Mbikqyrja e cilësisë ndërkombëtare dhe standardeve të mjedisit (B3) • Azhurnimi i të dhënave ekzistuese për të vlerësuar kërkesën e ardhshme (C1) • Inicimi i seminareve të vetëdijësimit mbi Sistemet Termale Diellore (STS) (D2) • Inicimi i zhvillimit të kapaciteteve dhe trajnimi i ndërmarrësve lokalë (D3) • Prezantimi i pajisjeve me Efikasitet Energjetik (EE) (E1) • Përmirësimi i EE të ndriçimit rrugor në çdo fshat (E4) • Inicimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimet profesionale për përdoruesit lokalë (E6) 	<p>i ulët</p> <p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>i lartë</p> <p>mesatar</p> <p>i lartë</p> <p>i lartë</p>
<p>Masat afatgjata</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i centraleve elektrike me kapacitet nominal të gjenerimit nën 10 MË (B1) • Vlerësimi i kapacitetit të mëtejshëm të gjenerimit të energjisë elektrike përbrenda Komunës (C2) • Realizimi i studimeve speciale mbi potencialin e erës dhe rezerve diellore (C3) • Hulumtimi i mundësive të skemave të financimit për investime private në STS (D4) • Kërkimi i menaxhimit anësor lidhur me shmangien e kulmit të energjisë elektrike (E2) 	<p>i ulët</p> <p>mesatar</p> <p>mesatar</p> <p>i ulët</p> <p>i lartë</p>
<p>Vlerësimi</p>	
<p>Strategjia e energjisë bazohet në efikasitetin gjithnjë e më të madh të energjisë (termale) dhe përdorimin e energjisë ripërtëritëse. Kjo vjen si rrjedhojë e qasjes mjedisore. Megjithatë, ndikimet negative mbi mjedisin nuk mund të përjashtohen sepse janë të pritura dhe duhet të merren parasysh , p.sh. në lidhje me Hidrocentralet e Vogla dhe ndikimet e tyre në florën dhe faunën e brigjeve të lumenjve.</p> <p>Zhvillimi i energjisë do të përmirësojë çështjet ekonomike, siç janë sigurimi i punësimit dhe trajnimi, dhe çështjet sociale siç është zvogëlimi i shpenzimeve familjare.</p>	

8.11 Uji dhe Kanalizimi

Synimet e përgjithshme
<p>Sektori i ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Komunën e Dragashit do të marrë parasysh standardet e BE-së për mjedisin. Do të sigurohet mbrojtja e burimeve të ujit; do të zvogëlohen humbjet në sistemet e distribuimit të ujit të pijshëm dhe shërbimet e ujërave të zeza do të ofrohen me tarifa të pranueshme për banorët e Komunës.</p> <p>Lidhja 100% me sistemet e tubacionit për furnizim me ujë, në pajtim me Direktivën e Ujit të Pijshëm, do të arrihet brenda 10 viteve të ardhshme. Të gjitha shtëpitë, madje edhe ato që nuk janë të banuara përkohësisht, do të lidhen me sistemet e ujit dhe ujërave të zeza.</p> <p>Shërbimet e ujit dhe grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza , qoftë pa pagesë apo të paguara, qeverisen nga parimi i njëjëtë: Përfituesit e Shërbimeve duhet të jenë të kënaqur.</p> <p>Lidhur me këtë parim, synohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. dispozicioni i ujit me cilësi dhe sasi të duhur në çezmë 2. grumbullimi dhe trajtimi i duhur i ujërave të zeza. <p>Strategjia e zbatimit të projekteve të vendosura dhe me prioritet për ujë dhe ujërat e zeza, rrjedh drejtpërsëdrejti nga më lartë: Radhitja e implementimit të masave të identifikuar duhet të ndjekë drejtimin e kundërt të rrjedhës së ujit, duke filluar nga konsumatori ose përdoruesi më i ulët dhe të përfundojë me burimin e ujit.</p>
Objectives
<ul style="list-style-type: none"> • Arritja e një rehabilitimi të qëndrueshëm të infrastrukturës ekzistuese. • Krijimi i operimit të mirefillt të sistemeve bazuar në mirëmbajtje dhe preventive; • Arritja e pranimin të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit bazuar në parimet ekonomike, si e vetmja zgjidhje e qëndrueshme; • Sugjerimi i zgjidhjeve për të përmirësuar performancën ekonomike të ofruesve ekzistues të shërbimeve për ujë dhe kanalizim dhe krijimi i njësive shtesë për mirëmbajtje të sistemeve në zonat ku këto nuk ekzistojnë; • Monitorimi dhe zbatimi i principit të mbrojtjes dhe konzervimit të mjedisit; • Sigurimi i planit të përgjithshëm për implementimin e projekteve të reja dhe sigurimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe afatgjatë për zhvillimin socio-ekonomik; • Kordinimi i masave të propozuara dhe projekteve në zbatim ose të miratuara për zbatim; • Arritja dhe zbatimi i një modeli efektiv për promovimin e imazhit territorial në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe për tërheqjen e burimeve të jashtme që do të përdoren në mënyrë koherente me udhëzimet e dhëna strategjike; • Përmirësimi i kapaciteteve komunale në zhvillimin ekonomik të infrastrukturës urbane/rurale
Actions
<p>A) Përmirësimi i sistemit të ujit dhe ujërave të zeza</p> <p>A1) Përmirësimi i planifikimit të hollësishëm (Masterplan) për ujë dhe ujëra të zeza për rehabilitimin e objekteve ekzistuese infrastrukturore</p>

<p>A2) Zgjerimi i sistemeve ekzistuese dhe operative në të gjitha fshatrat</p> <p>A3) Ndërmarrja e masave për trajtimin e duhur të ujit sipas madhësisë së fshatrave dhe numrit të përfituesve (furnizimi i ujit me gypsjiellës dhe trajtimi i ujërave të zeza; rrjeti i kanalizimit dhe trajtimi biologjik, etj.)</p> <p>A4) Krijimi i njësive të përhershme të shërbimit për mirëmbajtje dhe riparime preventive në çdo fshat</p> <p>B) Informimi dhe trajnimi</p> <p>B1) Implementimi i një fushate të vetëdijësimit për të bindur popullatën mbi nevojën e implementimit të operacioneve, mirëmbajtjes dhe menaxhimit profesional të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të zeza: uji është pasuri e trashëguar dhe nuk duhet të harxhohet kot.</p> <p>B2) Programet e vetëdijësimit mbi rreziqet e mjedisit dhe ato shëndetësore si pasojë e mostrajimit të ujërave të zeza</p> <p>B3) Inicimi i projekteve për të arritur pranimin e tarifave</p> <p>B4) Inicimi i zhvillimit të kapaciteteve dhe trajnimin për ndërmarrësit lokalë siç janë hidraulikët, personat që i vendosin dhe ata që i montojnë gypat e kanalizimit</p> <p>C) Përmirësimi i planifikimit</p> <p>C1) Përkatësia e njësive të shërbimit me Hidrorajonin Jugor (HRJ) së bashku me miratimin e Masterplanit nga Komuna dhe MMPH.</p> <p>C2) Përmirësimi i kapaciteteve komunale në planifikim</p> <p>C3) Themelimi i një sistemi për të siguruar një plan të përgjithshëm për implementimin e projekteve të reja</p> <p>C4) Financimi për rinovimin, rehabilitimin dhe modernizimin p.sh nga agjencitë donatore</p> <p>C5) Implementimi i një mekanizmi institucional për sigurim të financimit</p>	
Planifikimi i mëtejshëm	
<ul style="list-style-type: none"> • Përkatësia e njësive të shërbimit ,me Hidrorajoni Jugor (HRJ) së bashku me miratimin e Masterplanit nga Komuna dhe MMPH. • Epërmirësimi i planifikimit të hollësishëm (Masterplan) të ujit dhe ujërave të zeza për rehabilitimin e objekteve ekzistuese infrastrukturore 	
Afati kohor	Implikimi financiar
Projektet prioritare (masat afatmesme) <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i planifikimit të detajuar (Masterplan) për ujë dhe ujëra të zeza, për rehabilitimin e objekteve ekzistuese infrastrukturore (A1) • Programet për ngritjen e vetëdijes lidhur me rreziqet e mjedisit dhe ato shëndetësore si pasojë e mos trajtimit të ujërave të zeza (B2) • Përkatësia e njësive të shërbimit me Hidrorajonin Jugor (HRJ) së bashku me miratimin e Masterplanit nga Komuna dhe MMPH (C1) 	mesatar mesatar i ulët
Masat afatmesme <ul style="list-style-type: none"> • Zgjerimi i sistemeve ekzistuese dhe operative në të gjitha fshatrat (A2) • Marrja e masave për trajtimin e duhur të ujit sipas madhësisë së fshatit dhe numrit të përfituesve(A3) • Fushata e vetëdijësimit për nevojën e implementimit të operacioneve 	i lartë mesatar mesatar

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

profesionale, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza (B1) <ul style="list-style-type: none"> • Inicimi i projekteve për arritjen e pranimit të tarifave (B3) • Inicim i zhvillimit të kapaciteteve dhe trajnimi i ndërmarrësve lokalë, si hidraulikët, personat që vendosin dhe montojnë gypat e kanalizimit (B4) • Përmirësimi i kapaciteteve komunale në planifikim (C2) • Financimi i rinovimit, rehabilitimit dhe modernizimit p.sh. nga agjencitë donatore (C4) • Implementimi i mekanizmit institucional për sigurimin e financimit (C5) 	mesatar mesatar i ulët i ulët mesatar
Masat afatgjata <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i njësive të shërbimit të përhershëm për mirëmbajtje dhe riparimin preventiv në çdo fshat (A4) • Krijimi i një sistemi që siguron një plan gjithëpërfshirës për implementimin e projekteve të reja (C3) 	i lartë i ulët
Vlerësimi	
Strategjia për ujë dhe kanalizim nuk do të dëmtojë mjedisin por do të zvogëlojë ndotjen e tij . Strategjia do të përmirësojë gjithashtu çështjet ekonomike dhe sociale duke zvogëluar humbjen e ujit të pijshëm dhe duke përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimit.	

Arsyet

Në lidhje me shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza, nevojat e mëposhtme janë identifikuar gjatë fazës fillestare të përgatitjes Master Planit:

- Rehabilitimi / rindërtimi / rinovimi i mjeteve ekzistuese
- Zgjerimi i shërbimeve për zonat e vendbanimeve që aktualisht nuk kanë qasje në shërbime
- Zbatimi i koncepteve të përmirësuar teknike;
- Organizimi i njësive operative profesionale që janë në gjendje për të siguruar riparime dhe mirëmbajtje parandaluese
- Zbatimi i një mekanizmi institucional për sigurimin e financimit të nevojave të mësipërme.

Investimi me kohe dhe i përpiktët në asete nuk do të çojë në zgjidhjen e problemeve në afat të mesëm dhe të gjatë, e cila është e vetmja mënyrë e të menduarit për zhvillim të qëndrueshëm. Për shkak të ciklit jetësor të aseteve, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe të ndikimit të faktorëve të mjedisit, degradimi do të nodh përsëri në qoftë se koncepti i strategjise se investimit nuk trajtohen në kohën e duhur.

Objektet

Një përmbledhje e objekteve të identifikuar si të nevojshme për korrigjimin e situatës aktuale është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Uji

Vëllimi i rezervoarit- zgjerimi [m ³]	508
Rrjeti i distribuimit - zgjerimi [m]	2 650
Zonat sanitare Mbrojtjes [# of 20mx20m rrethoja]	177
Rehabilitimi i kaptazhes se ujit [#]	75
Trajtimi (ose klorifikimi) [1kaptazh për secilin lum /liqen]	4
Rezervoar [m ³]	1 961
Rehabilitimi i rrjetit të transmisionit [m]	13 553
Rehabilitimi /zëvendësimi i distribuimit [m]	79 111
Reduktimi i valvulave te presionit [#]	242
Zëvendësimi i valvulave egzistuese (Nos.)	972
Instalimi i seksionit të ri të valvulave me puseta [#]	890
Riinstalimi i kycjeve shtëpiake [m]	5 421
Ujëmatesit shtëpiak [Nos.]	8 155
Pompat e reja [#]	13
Pompimi [këh]	52
Stacionet e rezervoareve të pumpimit [m ³]	156

Kanalizimi (Ujërat e zeza)

Zgjerimi i kanalizimeve përfshirë edhe pusetat [m]	63 349
Rehabilitimi i kanalizimeve /zëvendësimi [m]	33 214
Përfshirë kolektorin e sipërm kryesor të ri, përfshirë pusetat [m]	25 955
Gropat septike [Nos.] secila për 5 HH	290
Trajtimi i kapaciteteve të kanalizimit, trajtimi primar, vetëm trajtim	22

Operimi dhe Mirëmbajtja

Përmirësimi i pengesave me kohë dhe mbajtja e të njëjtës strukturë në fuqi nuk është zgjidhje. Tre kushte duhet të plotësohen në mënyrë që të mundësohet financimi i qëndrueshëm i projekteve:

- Investimet kapitale duhet të jenë të asaj madhësie që do të ishin me interes për donatorët;
- Ekzistenca e një entiteti unik për të nënshkruar kontratën e financave;
- Qëndrueshmëria duhet të vërtetohet nga të gjitha anët: ekonomike, (strategjia e kthimit të investimeve, teknike, institucionale, sociale dhe ambientale.

Sekuencat e ndikimeve të investimit kapital

Mekanizëm për sigurimin e operimit dhe fondeve për mirëmbajtje në të ardhmen kanë dhe mund të bazohen në mbledhjen e tarifave të shërbimit. Klientët do të paguajnë këto tarifa vetëm nëse ata do të jenë të kënaqur me shërbimet. Për këtë arsye sekuencë e investimeve zbatuese (zgjedhja e fushëveprimit të investimeve) duhet të ndjekin rrugën e kënaqësisë së konsumatorëve 'të pandërprerë me shërbimet si në vijim:

1. Disponueshmëria e ujit me cilësi të mirë në sasi të mjaftueshme që do të kënaqë kërkesat e secilit komunitet (cilësia dhe rendimenti i burimeve ujore, fusha e mbrojtjes sanitare, trajtimit të ujit dhe ruajtjen e Matjes);
2. Disponueshmëria e presionit të mjaftueshme në tua? (rrjetet e shpërndarjes, duke e tundur, kycjet e konsumatorëve, matjes);

3. Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave të ujit (ujërave të zeza nga shtëpitë, për të mbledhur sistem të kombinuar me ujëra atmosferikë apo jo, duke i bashkuar vendbanimet apo komunitet në të njëjtin sistem të mbledhjes, nevojë për të pompuar);
4. Trajtimi i ujërave të ndotura mjedisore në nivele të pranueshme dhe lirim të rrjedhës në marrësit natyrorë (përshtatja e procesit të trajtimit të definuar zgjedhja e solucionit të trajtimit, trajtimi i mbetjeve industriale, zgjedhjen e organeve të rrjedhës ujore pritëse, zgjedhjen e lokacionit për trajtim të ujërave të zeza bimore).
5. Trajtimi i ujërave të zeza llum në Strategjinë e Menaxhimit

Ekzekutimi i investimeve kapitale në ndonjë nga fushat e mësipërme të shërbimit pa zgjidhur paraardhësit e tij, do të vënë në rrezik përdorimin e duhur të fondeve në dispozicion

Fushat që kanë nevojë për investime

Është e qartë që nevojat financiare janë shumë më të mëdha se sa mundësia e çdo granti për t'i plotësuar ato. Për adresimin e nevojave financiare është e pashmangshme që të bëhet një priorizim i komponentëve të përcaktuara për financim përmes granteve, duke marr parasysh kreditë e të ardhmes. Nga më sipër rezulton se 2 fushat kryesore të cilat kanë nevojë për mjete financiare janë:

1. Investimet kapitale fillestare për nevojat e konsumatorëve: (i) duke filluar me nr 1 që është paraqitur më sipër (ii) të tjera 3 pozicione në renditjen e mësipërme duhet të rezultojë nga një analizë e opsioneve të cilat do të kryhen në kuadër të Master Planit të UNDP-së, (iii) ngritjen (përfshirë trajnimin) e njësive të autorizuara profesionale për grupe të fshatrave –apo e pavarur.
2. Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive institucionale: (i) sigurimi i mbledhjes së tarifave (mund të kryhet vetëm nga një ofrues me mandat), (ii) sigurimi i menaxhimit operativ të aseteve dhe mirëmbajtja e tyre, (iii) Zhvillimi i një koncepti institucional që do t'i mundësojë ofruesit e shërbimeve të drejtë për marrje të kredive (duke demonstruar mundësitë për të paguar dhe paraqitjen e një strategjie dalëse).

Çdo investim (nga grantet) që plotëson sekuencat e paraqitura ose avancimin e progresit në përputhje me sekuenca të paraqitura për një grup të komuniteteve (aglomeratet) në 2 fushat e mësipërme të nevojave për investim do të jetë një vlerë e shtuar për Master Planin dhe një përfitim për rajonin e Dragashit.

8.12 Menaxhimi i mbeturinave

Qëllimet e përgjithshme
Përmirësimi i performancës së sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Dragash për të siguruar funksionimin efikas të sistemit të largimit të mbeturinave të ngurta të 100 % të popullatës (banorëve dhe biznesit) në periudhën kohore prej 3 vitesh, duke siguruar që Komuna i plotëson përgjegjësitë e saj të përcaktuara me Ligjin mbi menaxhimin e mbeturinave:
Objektivat
Komuna, në bashkëpunim me KPM “Eco Regjioni” ose ndonjë kompani private lokale do të zgjerojë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në 13 fshatrat e tjerë të rajonit të Gorës.
1.2 Komuna do të themelojë një mekanizëm financues dhe procedurë grumbullimi për të siguruar fonde dhe grumbullim të duhur.
1.3 Komuna do të ndjekë rrugën e riciklimit ose dhe të masave të tjera për efikasitet, ashtu sa lejojnë kushtet ekonomike.
1.4 Komuna do të zbatojë një program për vetëdijësimin e qytetarëve për të siguruar të kuptuar maksimal të qëllimeve dhe objektivave.
1.5 Komuna, në bashkëpunim me KPM EkoRegjioni, ose kompani tjetër private të kontraktuar me përkrahje nga QK do të ndërmarrë veprime për të pastruar deponitë ilegale në fshatrat që planifikohet të përfshihen në sistemin e menaxhimit.
Aksionet
Për Objektivin #1.1 : Komuna përmes KPM “Eco Regjioni” përfton dhe siguron automjetet e nevojshme dhe kontejnerat si përshkruhet në Analizën Financiare.
Arritje kyçe # 1.1.1 –Burimi financues për shpenzime kapital vjen nga mbledhja e të hyrave për shërbimet e ofruara.
Arritje kyçe # 1.1.2 – Orari i shpërndarjes së kontejnerëve gjatë vitit 2013propozohet nga KRM “Eco Regjioni” dhe miratohet nga departamenti komunal i planifikimit urban dhe shërbimit publik.
Arritje kyçe #1.1.3 KRM “Eco Regjioni” zhvillon dhe rishikon çdo vit strukturën e itinerarit që do të bëhet pjesë e planit, si dhe orarin e grumbullimit duke e përshtatur sipas nevojës me rritjen e popullsisë dhe/ose ndërrimet që duhet të miratohen nga departamenti komunal i planifikimit urban dhe shërbimit publik.
Arritje kyçe #1.1.4 Përveç orarit të rregullt të shënuar në pikën 1.1.3 më lart, KRM “Eco Regjioni” do të përgatisë dhe orarin për grumbullimin e mbeturinave të pazakonta (për materiale shumë të mëdha dhe mbeturina të rrezikshme) dhe këtë t’ia shpallë të gjithë shtëpive dhe bizneseve. Komuna, në bashkëpunim me nevojën e komunitetit përcakton vendin në fshat që do të përdoret si zonë e hedhjes për të pritur mbeturina të tilla.
Arritje kyçe #1.1.5 Kuvendi komunal miraton rregulloren që ndalon grumbullimin dhe transferimin e materialeve të mbeturinave solide nga të tjerë që nuk janë entitete të licensuara dhe siguron sistemin e miratimit për largimin e posaçëm të sendeve të tilla si mbeturina ndërtimore, nga ana e kontraktorëve të licensuar.

2. Për Objektivin #1.2. Komuna do të themelojë një mekanizëm financues dhe procedurë grumbullimi për të siguruar se ka fonde në dispozicion dhe se ndiqen procedurat e duhura.

Arritje kyçe # 1.2.1 Në bazë të Ligjit për Mbeturina, Komuna përcakton pagesat dhe mënyrën e mbledhjes së fondeve për shërbime komunale.

Arritje kyçe #1.2.2 Kuvendi Komunal krijon një mekanizëm për mbledhjen e pagesave për Grumbullimin e Mbeturinave Solide që të garantohet grumbullimi, si përcaktohet nga qëllimi i përgjithshëm që duhet të implementohet jo më vonë se qershori 2013.

Arritje kyçe #1.2.3 Komuna do të modifikojë sistemin e vet të taksës dhe pagesave për të parandaluar regjistrimin vjetor të makinës ose taksës pronësore nëse nuk paraqitet dëshmi se është bërë pagesa për menaxhimin e Mbeturinave Solide.

3. 3. Për Objektivin #1.3. Komuna do të punojë për të përfshirë riciklimin sipas kushteve të lejuara ekonomike.

Arritje kyçe #1.3.1 –Kryetari i Komunës çdo vit do të caktojë një komitet që do të hetojë progresin e riciklimit në Republikën e Kosovës dhe do t'i paraqesë raportin Kuvendit Komunal mbi zbatueshmërinë dhe dëshirueshmërinë e përfshirjes në një aktivitet të tillë.

Arritje kyçe #1.3.2 –Komiteti për rishikimin e riciklimit raporton para se të bëhet dorëzimi i buxhetit për vitin e ardhshëm se çfarë veprimesh duhet të ndërmerret komuna drejt avancimit të trajtimit të mbeturinave solide, duke siguruar se është në interesin më të mirë të mjedisit, si dhe i duhur nga ana fiskale për buxhetin komunal.

Arritje kyçe #1.3.3 –Për të promovuar efikasitetin, Kryetari i Komunës do të caktojë çdo vit një individ ose komitet për të hetuar potencialin fiskal dhe operacional për Bashkëpunimin Ndër-Komunal në Grumbullimin, Trajtimin ose Hedhjen e Mbeturinave Solide.

4. Për Objektivin #1.4. Komuna do të zhvillojë një program për ngritjen e vetëdijësimit të qytetarëve për të siguruar të kuptuar maksimal të qëllimeve dhe objektivave.

Arritje kyçe #1.4.1 –Komuna, me përkrahje të drejtorive komunale të shërbimeve Publike, Arsimit dhe Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe në bashkëpunim të ngushtë me KRM “Eco Regjioni” do të zhvillojë dhe implementojë një program për vetëdijësimin e qytetarëve që të maksimizojë të kuptuarit nga ana e nxënësve dhe qytetarëve të tjerë të përmirësimeve në Menaxhimin e Mbeturinave Solide që do të implementohen, të paktën dy muaj para implementimit të Planit.

Arritje kyçe #1.4.2 Kryetari i Komunës do të monitorojë dhe rishikojë dhe raportojë rregullisht mbi efektivitetin e programit për menaxhimin e mbeturinave solide dhe do të ofrojë sugjerime për përmirësim.

Arritje kyçe #1.4.3 – Si pjesë e programit për vetëdijësim të Qytetarëve komuna do të ndërmerret dhe inkurajojë masa për të reduktuar sasinë e plastikës, PET-it, paketimeve në mbeturinat e biodegradueshme nga mbeturinat komunale. Komuna në bashkëpunim me KRM “Eco Regjioni” duhet të nxisë komunitetin për të kompostuar mbeturina të kuzhinës dhe të degradueshme.

5. Për Objektivin #1.5 Komuna, në bashkëpunim me KRM “Eco Regjioni”, ose ndonjë tjetër kompani private të kontraktuar do të ndërmerren veprime për të pastruar deponitë ilegale nëpër fshatra që janë planifikuar të përfshihen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Arritje kyçe #1.5.1 – Komuna do të identifikojë lokacionin e deponive ilegale nëpër fshatrat ku do të

dërgohet sistemi për mbeturina

Arritje kyçe # 1.5.2 – Komuna do të kontraktojë një kompani private ose kompani publike për të pastruar deponinë ekzistuese.

Arritje kyçe #1.5.3- Komuna do të sigurojë fonde nga buxheti komunal, buxheti i QK ose nga përkrahja e donatorëve për të pastruar deponitë.

Planifikimi i mëtutjeshëm

Zhvillimi i udhezuesit për menaxhimin e mbeturinave në Dragash dhe arritja e pajtimit me shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit

Zhvillimi i strategjive për riciklim në bashkëpunim të ngushtë me zhvillimin ekonomik.

Përgjegjësia / Korniza institucionale

Ligji për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087, i datës 13.06.2008) parasheh kornizën ligjore për pronësinë e Ndërmarrjeve Publike dhe për qeverisjen e tyre korporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare të qeverisjes korporative për ndërmarrje publike. Në bazë të Nenit 3, secila ndërmarrje e identifikuar në Shtojcën 1 të bashkëngjitur në ligjin aktual është NP Qendrore. Shtojca 1 përfshin 6 Kompani Rajonale të Ujit. Në bazë të Ligjit për Vetë-Qeverisjen Lokale në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-040 i datës 20. 02. 2008), Neni 17, pika 17.1, komunat janë kompetente për të siguruar dhe mirëmbajtur shërbimet publike, përfshirë furnizimin me ujë, ujërat e zeza dhe kanalizimet, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave etj.

Ligji për Vetë-Qeverisjen Lokale nuk është në përputhje me parimet e qeverisjes korporative si parashtrohet në Ligjin për NP, ndaj harmonizimi i këtyre dy ligjeve është i nevojshëm.

Përparësitë e Ligjit të ri për Mbeturina janë se komunat kanë fituar fuqi dhe përgjegjësi për menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre.

Në vijim, nga Ligji i ri për Mbeturina janë shkëputur përgjegjësitë e organeve që merren me menaxhimin e mbeturinave:

Në bazë të Ligjit të ri për Mbeturina, (Neni 13) autoritetet kompetente për menaxhimin e mbeturinave janë: MMPH dhe institucionet relevante; dhe Komunat.

Në mesin e detyrave të tjera, MMPH është e detyruar të lëshojë licenca për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe të monitorojë menaxhimin e mbeturinave.

Sipas Nenit 15 përgjegjësitë dhe detyrat e komunave për të implementuar dispozitat e këtij ligji janë:

1. Përgjegjësitë dhe detyrat e komunave për të implementuar dispozitat e këtij ligji janë:
 - Krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave sipas parimit të hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave për territorin e tyre, zhvillimi i planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave sipas Nenit 10 të këtij Ligji dhe krijimi i kushteve dhe kujdesi për implementimin e tij;
 - Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave duhet të harmonizohet me planin vendor;
 - Komunat do të jenë përgjegjëse për implementimin e planit komunal;
 - Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave. Raporti vjetor do t'i paraqitet Ministrisë deri me 31 mars të vitit pasardhës;
 - Rregullon përgjegjësitë dhe detyrimet për të kryer shërbimet për menaxhimin e mbeturinave, i implementon dhe organizon menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;

- Mirëmban dhe ruan sistemin e informimit publik dhe raporton për punimet e bëra sipas këtij ligji si dhe akte të tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimi i procedurave të prokurimit, që ndiqen pas përzgjedhjes së personave të licensuar për mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen dhe transportimin e mbeturinave solide, komunale, mbeturinave voluminoze, nga ndërtimi dhe shkatërrimi i ndërtesave dhe ndërtesave komerciale në territorin e tyre;
- Komuna përcakton pagesën dhe mënyrën e mbledhjes së fondeve për shërbime komunale;
- Indetifikimi i vendeve të kontaminuara në territorin e tyre dhe zhvillimi i projekteve për rehabilitimin e tyre, që përfshin shënime për vendndodhjen, tiparet hapësinore gjeometrike, llojine ndotjes dhe sasinë e mbeturinave, afatet për të përmirësuar situatën dhe të dhëna të tjera me rëndësi për implementimin e projekteve.

2. Dy apo më shumë komuna ku është interesi i tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave.

3. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe masat e kontrollit dhe aktivitete të menaxhimit të mbeturinave në territorin e saj përmes inspektorëve komunalë për mjedisin.

4. Me kërkesë të Ministrisë, sigurohet informacioni i kërkuar dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.

5. Komuna është e detyruar të ofrojë përkujdes dhe të largojë mbeturinat e hedhura në hapësira publike ose në deponi jashtë territorit të saj.

6. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me përgjegjësinë ligjore nuk kujdeset për mbeturinat e hedhura nga persona të panjohur, përgjegjësia për ato mbeturina i takon komunës.

7. Për të implementuar dispozitat e këtij Ligji, komunat nxjerrin dhe akte nënligjore që rregullojnë funksionimin e autoritetit kompetent komunal dhe standardet për shërbime të menaxhimit të mbeturinave.

8. Pa paragjykuar paragrafin 1. deri 7. të këtij Neni, performanca e shërbimeve publike dhe ofrimi i infrastrukturës publike në lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale është brenda kompetencës ekskluzive të komunave në përputhje me Ligjin mbi Vetë-Qeverisjen Lokale.

Afati kohor	Implikimet financiare
<p>Masat prioritare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e 13 fshatrave të Gores në sistemin e menaxhimit të mbeturinave (1.1.) • Aprovimi i rregullores për mbeturinat e ngurta (1.3.) • Aprovimi i rregullores për mbledhjen e taksave (1.2.) • Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave (1.4.) 	<p>I ulet</p> <p>I ulet</p> <p>I ulet</p> <p>I mesem</p>
<p>Masat afatmesme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aprovimi i rregullores e cila e parandalon regjistrimin e makinave ose 	

taksen e pronësive perderisa nuk sigurohet deshmi se është paguar taksa e mbeturinave (1.2.)	I ulët
Masat afatgjata <ul style="list-style-type: none"> • Mbeshtetje biznesit të riciklimit (1.4.) • Kampanje vetedijësuese për mbrojtjen e mjedisit me komunitetin dhe shkollat (1.4.) 	I mesëm I mesëm

Arsyetim:

1. Mungesa e shërbimeve komunale për grumbullimin e mbeturinave solide në 40% të territorit të komunës së Dragashit për shkak të vetëdijësimit të ulët të komunitetit për të mirat e menaxhimit të mbeturinave. Disa nga administratorët e njësive lokale të fshatit nuk janë të bindur se duhet të ketë shërbime të menaxhimit të mbeturinave solide në zonat rurale. Komuna duhet të inkurajojë dhe rritë vetëdijësimin për të pranuar shërbimet nga kompani të licensuara për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave, ose të kontraktojnë shërbimet e kompanive private.
2. Komuna do të shtojë rrugën për të përfshirë fshatrat në sistemin e grumbullimit të mbeturinave duke punuar nga afër me komunitetin. Shërbimet mund të ofrohen nga kompania rajonale për grumbullimin e mbeturinave ose do të kontraktohet një kompani private që t'i kryejë këto aktivitete.
3. Meqë në Dragash këto shërbime ofrohen nga 'Eco Regjioni', kompania duhet të sigurojë kazanë plastike për mbeturina 140 L dhe komuna duhet të sigurojë kazanë të posaçëm për mbeturina të degradueshme, kazanë për bio-kompostë.
4. Trajtimi i mbeturinave—mbeturina solide të riciklueshme që do të grumbullohen ndarazi nga shtëpitë e banimit përmes sensibilizimit dhe motivimit. Artikujt e riciklueshëm do të shiten për të gjeneruar fonde (Plastika PET dhe qese (50 centë/ton), kompostim dhe plastikë e rëndë.
5. Edhe autoritetet fiskale duhet të përfshihen në mënyrë që vendimet të merren në nivel lokal nga ata që janë më shumë në gjendje të gjykojnë nevojat dhe prioritetet lokale. Komuna të përgatisë dhe ekzekutojë rregulloren për fiskalizim ose penalizim të fshatrave lokale nëse nuk respektojnë detyrën e tyre në menaxhimin e mbeturinave solide.
6. Pastrimi i vendeve ekzistuese hu hidhen mbeturinat, të cilat dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin në fshatra.
7. Deponia e Dragashit të përdoret për hedhjen e mbeturinave, duke patur parasysh se menaxhimi dhe funksionimi i deponisë do të bëhet në mënyrën e duhur. Kur të përfundojë jetëgjatësia e deponisë ekzistuese celula e ardhshme e deponisë të ndërtohet me koncesion ose fonde komunale/të qeverisë.

Qëllimi i përgjithshëm

Komuna do ta përkrahë KRM "Eco Regjioni" për të siguruar se shërbimet për largimin e mbeturinave solide i ofrohen popullsisë 100 % (banim dhe iznese) brenda 3 vjetësh nga data e fillimit të planit në 2013.

Burimet në dispozicion:

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Sipas draft master planit për menaxhimin e mbeturinave jipen këto të dhëna ekonomike në mënyrë që të mundësohet qëndrueshmëria financiare e sistemit të grumbullimit të mbeturinave

Blerja dhe mirëmbajtja e kamionëve dhe automjeteve

	Lloji FS	Sasia	Çmimi për njësi €	Totali €
Kamion për grumbullim të mbeturinave (8-10 ton)	Aset	1	70,000	70,000
Mjet i vogël për grumbullim (2 ton)	Aset	1	20,000	20,000
Automjet	Aset	1	15,000	15,000
Mirëmbajtja e automjeteve (7%)	Shpenzim		7,350	7,350
Amortizimi i automjeteve (5%)	Shpenzim		5,250	5,250
Total				117,600

Kostoja për mirëmbajtje

	Lloji FS	Njësi	Çmimi €	Totali €
Blerja e kazanëve për mbeturina (140 L)	Aset	5,635	20	112,700
Blerja e kontejnerëve (1.1m3)	Aset	50	200	10,000
Mirëmbajtja e kazanëve të mbeturinave (2%)	Shpenzim		2,254	2,254
Amortizimi i kazanëve të mbeturinave (20%)	Shpenzim		22,540	22,540
Totali				147,494

Kostoja për fuqi punëtore (*Bruto)

	Njësi	Paga mujore €	Totali €
Paga e menaxherit	1	450	450
Paga për financier dhe kontabilist	1	350	350
Grumbulluesit e mbeturinave	23	300	6,900
Grumbulluesit e pagesave	10	300	3,000
Totali			10,700

Figura e përafërt e totalit të KM që automjeti do të kalojë është 3,480 KM. Të supozojmë se automjeti i vogël do të kalojë 1,500 KM dhe kamionët 2,000 KM, totali është 3,500 KM.

Kostoja e transportimit

Materialet	Litra	Çmimi për njësi	Totali mujor
Karburant – kamionë të mëdhenj 2000 KM / 40 litra për 100 km)	800	1.3	1,040
Karburant – Automjet i vogël 1500km/15l për 100 km	225	1.3	292.5
Lubrikant (1.5 litra për 100 km për të dy automjetet)	52.5	3.5	183.75
Sasia totale mujore			1,516.25

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Pagesa për deponi

Pagesa aktuale për dfeponi është caktuar nga Rregullatori dhe është 5.27 pa TVSH. Kompania e grumbullimit në Dragash duhet të bëjë pagesën për deponinë 6.5€ për 1 ton mbeturina. Kjo përlllogaritet t'i kushtojë kompanisë rreth 29,731 Euro në vit në bazë të sasive të përlllogaritura të mbeturinave vjetore që gjenerohen nga Komuna.

Me Ligjin e ri për Mbeturina, komuna, në bashkëpunim me DKA janë përgjegjëse për të caktuar tarifatat për hedhjen e mbeturinave.

Përmbledhje e kostove operacionale

Kostoja totale vjetore operacionale për kompaninë është paraqitur në tabelën më poshtë.

Kosotoja	Sasia
Puna	128,400
Amortizimi	27,790
Uji	300
Rryma	1,200
Mirëmbajtja	9,604
Karburanti	18,195
Shpenzime të deponisë	29,731
Posta, telefoni, interneti	1,200
Qiraja	-
Tarifatat bankare	300
Të tjera	1,200
Kostoja totale operative	217,920

Përmbledhje e kostos së investimit

Për të ofruar shërbime të grumbullimit të mbeturinave në Dragash dhe në fshatrat e tij, kompania publike e grumbullimit do të ketë shpenzime ekstra që duhet të merren parasysh për kazanë të mbeturinave, automjete për grumbullim, karburant, fuqi punëtore dhe shpenzime të tjera.

Aseti	Njësi	Çmimi	Totali
Kamion për grumbullim të mbeturinave (8-10 tones)	1	70,000	70,000
Automjet i vogël grumbullues (2 tonë)	1	20,000	20,000
Automjet	1	15,000	15,000
Blerje e kazanëve të mbeturinave (140 L)	5,635	20	112,700
Blerje e kontejnerëve (1.1m3)	50	200	10,000
Pajisje të tjera zyre		3,000	3,000
Kosto totale e investimit			230,700

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Pagesat totale për shërbim

Kompania për grumbullimin e mbeturinave duhet të investojë në aspektin operacional dhe për automjetem në total:

Kostoja	Total në Euro
Kostoja operationale	217,920
Kostoja për investim	230,700
Investimi total	448,620

Nga të hyrat, kompania e grumbullimit mund të mbulojë koston operationale dhe koston e investimit nëse supozohet se banorët do të paguajnë për shërbimet.

Suficiti mund të përdoret nga kompania për të përmirësuar shërbimet e mbeturinave duke siguruar investimin për aktivitete të riciklimit dhe fushatën e vetëdijësisimit.

Mbulesa me kosto				
Shërbime	Nr. I shërbimeve	Pagesa mujore Euro	Pagesa vjetore Euro	Kostoja totale operationale Euro
Shtëpitë	5,635	4.5	54	304,290
Biznese	819	18	216	176,904
Institucione	80	500	6,000	480,000

9. Dispozitat e implementimit

Dispozitat e implementimit të kushteve ekzistuese që duhet të plotësohen për aplikimin dhe implementimin e Planit Zhvillimor Komunal të Dragashit. Duhet të arrihet një shkallë e lartë e qeverisjessociale; zhvillimi i ardhshëm duhet të bazohet në rregullat e matura.

9.1 Udhëzues mbi çështjet e interpretimit të PZHK

- PZHK bazohet në Planin Hapësinor të Kosovës dhe duhet të përputhet me propozimet e tij. Vendimet dhe hollësitat e Planit Hapësinor janë vendosur në nivel kombëtar dhe duhet të respektohen.
- PZHK pajtohet të themelohet Parku Nacional “Malet e Sharrit” në Komunën e Dragashit.
- PZHK është bazë për dizajnimin e Planeve për Zhvillim Urbanistik (PZHU) dhe Planet Urbane Rregullative (PUR). Këto plane duhet të respektojnë rekomandimet e PZHK, sidomos kur bëhet fjalë për strategjinë e vendbanimit.
- PZHK shërben si udhëzues për të gjithë sektorët e tjerë në komunë.
- Çdo propozim ose vendim që ka të bëjë me PUR dhe është në kundërshtim me dispozitat e PZHK, duhet të kalojë procesin e shqyrtimit publik (siç është paraparë me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor) dhe të marrin miratimin e Këshillit.

9.2 Kushtet mbi çështjet që janë të rëndësishëm për përdorimin e tokës dhe zhvillimin

9.2.1 Kushtet e përcaktimit të destinacionit të zonave në territorin e komunës

Përcaktimi i destinacionit të zonave në territorin e komunës bazohet në kushtet dhe karakteristikat gjeografike dhe kushtetuese, si dhe në vizionet dhe synimet e planit, të cilat mundësojnë drejtimet e ardhshme të zhvillimit. PZHK përcakton kushtet për rregullimin e vendbanimeve dhe zonave ndërtimore, tokës bujqësore, pyjeve, zonave komerciale dhe industriale, hapësirat publike, infrastrukturën fizike dhe sociale, objektet për sport dhe rekreim (turizëm), rreziqe natyrore, etj. Në përgjithësi, kushtet janë përcaktuar në kornizën e zhvillimit hapësinor të PZHK, strategjitë dhe Hartat Udhëzuese të PZHK, dhe në planet e detajuar (p.sh. PZHU, PUR) si dhe me anë të ligjeve relevante.

9.2.2 Kushtet për rregullimin e hapësirës

Regullimi i vendbanimeve është përcaktuar nga strategjia e vendbanimevedhe hartat e Udhëzimit (shih Kapitulli 8.2). Specifikimet e hollësishme të rregullimit hapësinorregulate do të ndërmerren me anë të PZHU/PUR.

(a) Objektet me rëndësi për Kosovën

Trashëgimia e preکشme kulturore dhe asetet e peizazhit (mullinjte, objektet tradicionale autoktone, etj.) është anketuar dhe vlerësuar në Raportin mbi Asetet dhe Trashëgiminë Kulturore (2012); strategjia për turizëm dhe trashëgimi kulturore prezanton çështjet dhe veprimet kryesore për ruajtjen e këtyre objekteve (shih Kapitulli 8.7) të cilat janë në interes kombëtar, dhe të përkrahë pronarët në mbrojtjen e tyre. Komuna do të bashkëpunojë me institucionet qendrore dhe do të ruajë kontrollin e zhvillimit përreth këtyre objekteve.

(b) Zonat ndërtimore për vendbanimet

Objektet janë të lejuara vetëm në zonat e caktuara me PZHK. Infrastruktura fizike dhe sociale do të mundësohet vetëm brenda zonës urbane. Kushtet për zonat ndërtimore brenda zonës urbane përcaktohen me strategjinë e vendbanimeve dhe hartat e Udhëzuesve (shih Kapitulli 8.2). Këto kushte marrin parasysh:

- Rregullimi i mirëfilltë i dendësisë dhe sipërfaqes së hapur urbane
- Cenueshmëria nga rreziqet dhe fatkeqësitë (ortekët, erozioni, vërshimet)
- Makro-mikroklima (rrezet e diellit, era, vendet e ngrira)
- Të dhënat mbi zonën e zhvillimit dhe parcelat e kadastrit: përfshijnë analizën e pozitës, orientimit, formës, madhësinë e zonës së zhvillimit, ndërtimi i tokave, analiza e përshtatshmërisë, përdorimi i tokës në zonat përreth, përgatitja e vendit (largimi i objekteve dhe rehabilitimi i tokës, etj.)
- Rregullat për të hyrë në objekt (infrastruktura rrugore dhe instalimet e tjera)
- Siguria dhe rendi publik (jeta dhe shëndeti i njerëzve, mjedisi, stabiliteti, mbrojtja nga zjarri, kanalizimi, izolimi për ngrohje dhe izolimi nga zhurma, stabiliteto dhe largësia e objekteve fqinje, etj.)
- Vlera historike dhe kulturore

Komuna siguron lejet e ndërtimit për të gjitha objektet, përveç atyre që janë përcaktuar në Nenin 35 e Ligjit për Ndërtim. Për këto struktura, leja e ndërtimit jepet nga MMPH:

- Ndërtimi dhe lidhjet e telekomunikimit (referoju detajeve mbi ligjin)
- Objektet energjetike, hidrocentralet dhe objektet industriale
- Objektet për qëllime të veçanta

Objektet/strukturat që nuk kanë nevojë për leje të ndërtimit janë përcaktuar në Nenin 41 të Ligjit për Ndërtim.

(c) Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve

Ndërtimi jashtë zonave të definuara për ndërtim është i ndaluar me përjashtim të objekteve të përmendura në nenin 17.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor. MMPH jep lejet e ndërtimit për nevojat e:

- Mbrojtjes nga zjarri dhe materialet e dëmshme - eksplozivët etj.
- Menaxhimi i burimeve të ujit
- Transporti dhe infrastruktura tjetër
- Objektet për hulumtim dhe përdorim të materialeve të shfrytëzuara minerale
- Aktivitetet bujqësore dhe rekreative, pylltaria, gjuetia, peshkimi dhe turizmi rural

Komuna nuk do të përgjigjet për sigurimin e infrastrukturës jashtë vendbanimeve që janë përcaktuar në PZHK.

9.2.3 Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike

PZHK ka përcaktuar zonat ekonomike në qytetin Dragash dhe nënqendrat, ku do të lejohen aktivitetet ekonomike. Shpallja e kësaj zone si një zonë ekonomike duhet të përputhet me kriteret e caktuara sipas ligjit për veprimtari ekonomike, dhe përfshin: statusin e zonë (p.sh. zona ekonomike ose industriale, parku teknologjik ose industrial, etj.), kufijtë e zonave, llojet e aktivitetetve që do të zhvillohen në zonë etj.

Lejet do të jepen vetëm për ndërtim për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depove për ruajtjen e produkteve, shërbimet dhe qëllimet komerciale pa asnjë ndikim negativ mbi mjedisin. Hartimi i PUR do të përmbajë kushtet për rregullimin e zonës së caktuar sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Ligjit për Zonat Ekonomike, si dhe hartimin e Vlerësimit Strategjik të mjedisit. Kushtet e përgjithshme për themelimin e zonës përfshijnë përcaktimin e statusit të pronësisë së tokës, pëlqimet paraprake, hartimin e planit të biznesit, planet e projekteve ndërtimore dhe kushte të tjera të veçanta, të përcaktuara me detyrën e projektit.

Komuna do të stimulojë tregtinë dhe subjektet tregtare që ofrojnë programe të qëndrueshme për bizneset e tyre, duke përdorur teknologjinë e energjisë të ripërtëritshme dhe duke integruar efikasitetin energjetik. Bizneset prodhuese do të lejohen brenda zonave ekonomike, nëse përputhen me kushtet e përdorimit të tokës dhe dispozitat e tjera të mbrojtjes së mjedisit.

Korniza hapësinore e PZHK ka përcaktuar zonat e caktuara të menaxhimit intensiv dhe të gjerë të menaxhimit bujqësor dhe përdorimin e tokës. Kjo do të mbrojë mjedisin dhe do të ruajë aktivitetet bujqësore. Komuna do të stimulojë shoqatat e bujqve dhe grumbullimin e produkteve pyjore që nuk janë drunj, nëse respektohen ligjet dhe lejet e ministrive përkatëse.

Kushtet për zhvillim turistik bazohen në Strategjinë e Turizmit Natyror (2011) dhe Strategjinë e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore (shih Kapitulli 8.7). Zonat turistike definojnë në strategjinë e vendbanimeve dhe hartat e Udhëzuesit (shih Kapitulli 8.2), ndërsa qendrat dhe zonat turistike janë përcaktuar në kornizën e zhvillimit hapësinor. Komuna do të lejojë ndërtimin për turizëm vetëm në zonat e turizmit dhe zonat që nuk e dëmtojnë mjedisin. Akomodimi dhe pushimoret duhet të vendosen në raport të përshtatshëm me kërkesën dhe kushtet natyrore. Projektet e tepruara në madhësi nuk do të lejohen. Komuna do të inkurajojë dhe lejojë infrastrukturën turistike dhe fushat e zhvillimit, të tilla si gastronomia, aktivitetet kulturore, zejtaria, etj. në pajtim me dispozitat ligjore dhe planet zhvillimore.

9.2.4 Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike

Aktivitetet publike zhvillohen në rrugët e fshatit dhe në vendet tradicionale në fshat. PZHKnxit zmadhimin e projektimit të hapësirave publike dhe ruajtjen e sipërfaqeve të hapura për tubime tradicionale ose të përbashkëta. Hapësira e gjelbëruar e cila është dëmtuar nga ndërtimi duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga Komuna. Hartat udhëzuese të strategjisë së vendbanimit (shih Kapitulli 8.2) definojnë kornizën për projektimin e hapësirës, e cila do të detajohet në projektet arkitektonike të peizazhit dhe PZHU/PUR. Përveç kësaj, objektet tradicionale të trashëgimisë kulturore dhe Shtëpitë e Kulturës, të emëruara në Strategjinë për Turizëm dhe Kulturë dhe nëpër harta (shih Kapitulli 8.7), si dhe fushat e sportit dhe oborret e shkollave duhet të zhvillohen dhe zgjerohen për veprimtari publike. Komuna do të bëjë marrëveshje për partneritete publike-private për shfrytëzimin e objekteve për qëllime kulturore, në rastet kur këto janë pronësi private (kjo vlen sidomos për strukturat me vlerë të trashëgimisë kulturore).

Një temë e veçantë e PZHK është nxitja e arsimit dhe ofrimi i përkrahjes për të rinjtë. Komuna vazhdon mbikqyrjen e frekuentimit të shkollës, mundëson transportin në shkollë aty ku është i nevojshëm dhe siguron raportin adekuat nxënës:mësimdhënës. Projektet që inkuadrojnë të rinjtë në jetën sociale dhe shtojnë objektet për aktivitete sportive dhe rekreative, do të do të promovohen nga Komuna. Detyra e projektit përshkruan në hollësi vendin dhe kushtet urbano-teknike.

9.2.5 Kushte për vendosjen e korridoreve ose shtigjeve, zonave të komunikimit dhe sistemet e tjera infrastrukturore

Komuna është përgjegjëse për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit lokal rrugor, për sigurinë dhe efikasitetin në trafik, transportin publik dhe sistemet e tjera të infrastrukturës. Sipas Ligjit për Rrugë, ndërtimi nuk duhet të ndodhë brenda një distance të caktuar të rrugëve dhe duhet të kryhet Vlerësimi i Ndikimit të Mjedisit. Dimensionet rrugore përcaktohen në pajtim me politikat dhe standardet e mobilitetit të rrugëve në kategorinë të cilës i përkasin. Rrugët lokale duhet të rregullohen për të siguruar lëvizjen e sigurtë të trafikut në të gjitha kushtet e motit. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë projektimit të kryqëzimeve dhe rretheve për qarkullim, duke i dhënë prioritet sigurisë dhe komoditetit të këmbësorëve. Çdo përdorues i rrugës duhet të jetë në gjendje të mbikqyrë situatën.

9.2.6 Masat për mbrojtjen e peizazhit, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

Komuna bashkëpunon me ministritë relevante, institucionet dhe organizatat e tjera për përgatitjen e planeve të menaxhimit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e natyrës, një plan lokal veprimi për mbrojtjen e mjedisit, dhe një plan operativ për menaxhimin e pyjeve, për të siguruar harmonizimin me planet dhe strategjitë e qeverisë. Komuna siguron pjesëmarrjen e publikut, OJQ-ve, organizatave profesionale, komunitetit afarist etj. Në procesin e hartimit të planeve, programeve dhe projekteve. Komuna bashkëpunon me komunat fqinje, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e peizazhit dhe vlerave natyrore dhe kulturo-historike. Dy ose më shumë komuna mund të zhvillojnë dhe të miratojnë bashkarisht planet ose programet e përbashkëta të veprimit për mbrojtjen e mjedisit, për të zvogëluar efektet negative mbi mjedisin.

Në suaza të kompetencave të veta, komuna ndërmer masat dhe aktivitetet në vazhdim:

- Është përgjegjëse për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe peizazhit në territorin e vet;
- Shpall zonat e mbrojtura për të cilat mban përgjegjësi dhe merr pjesë në procedurën për shpalljen e zonave të mbrojtura, të cilat shpallen nga Qeveria ose Parlamenti;
- Siguron kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat mban përgjegjësi;
- Nxit mbrojtjen e natyrës dhe përkrah shoqatat, aktiviteti i të cilave është mbrojtja e natyrës;
- Mbikqyr gjendjen e mbrojtjes të natyrës dhe i raporton Ministrisë për Mjedis dhe Hapësirë Publike; mban evidencë të të dhënave relevante që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës;
- informon publikun mbi kushtet e natyrës në territorin e vet dhe lidhur me masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës;

Komuna siguron ruajtjen e karakteristikave të peizazhit dhe mirëmbajtjen e vlerave biologjike, gjeologjike dhe kulturore, të cilat përcaktojnë rëndësinë e tij dhe eksperiencën estetike. Komuna mbikqyr minimizimin e ndikimeve të mjedisit nga projektet e ndryshme të zhvillimit. Strategjitë e PZHK (shih Kapitulli 8) përcaktojnë zhvillimin komunal duke marrë parasysh aspektet e mjedisit. Përgjegjësitë e komunës për ruajtjen e natyrës janë:

- të bashkëpunojë me ministritë relevante dhe të sigurojë se veprimet janë në pajtim me ligjin
- të marrë parasysh aspektet e mjedisit në përgatitjen dhe miratimin e planeve (p.sh. pozitën e objekteve, kursi i rrugëve, ...)
- të promovojë fushatat e ndërgjegjësimit për të shtuar vetëdijen e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit
- të kultivojë speciet autoktone (bujqësi, blegtori dhe pylltari)
- të shtojë infrastrukturën teknike dhe të eliminojë ndotjen e mjedisit (përmes ujërave të zeza, mbeturinave të ngurta)

Përgjegjësitë e komunës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë:

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e saj për regjistrimin e vlerave të trashëgimisë, duke përpiluar një listë të trashëgimisë që përfshin vlerat e caktuara në mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, duke krijuar dhe azhurnuar bazën e të dhënave mbi statusin e trashëgimisë kulturore, si dhe për implementimin e restourimit/rinovimit/rehabilitimit dhe ndërrimin e qëllimit të projekteve të trashëgimisë kulturore.
- Me hyrjen e një pasurie të trashëgimisë kulturore në listën e përkohshme ose të përhershme për mbrojtje (shih Ligjin e procedurave për shpalljen e një vlere për mbrojtje të përkohshme ose të përhershme), kjo evidentohet në regjistrin e kadastrit. Trashëgimia kulturore në mbrojtje të përkohshme ose të përhershme është e përjashtuar nga tatimi i pronës. Dhënia e lejeve të ndërtimit për objektet që janë në mbrojtje të përkohshme ose të përhershme ose brenda zonave arkeologjike, mjetet e përdorimit me qëllim të përfitimit ekonomik dhe

kulturor, çështjet e kompensimit, financimit, shitjes, të drejtave të pronës për trashëgiminë kulturore nën kontroll shtetëror ose pronësia private e trashëgimisë kulturore, rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e Trashëgimisë.

- Intervenimet në tërësi ose në vlerat e trashëgimisë kulturore duhet të kenë leje me shkrim nga institucioni kompetent. Punimet pa autorizim nuk lejohen në pasuritë ose vlerat e trashëgimisë kulturore.
- Aktivitetet e ruajtjes dhe restaurimit, projektet dhe proceset e intervenimit për ruajtje dhe restaurim duhet të bëhen nga organe të licencuara nga Ministria për këtë qëllim, dhe të cilat paraprakisht kanë marrë miratim dhe mbikqyren nga institucioni kompetent.
- Monumentet arkitektonike të shënuara në listë për mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme kanë zonë të mbrojtjes 50 metra nga perimetri i monumentit. Rrezja e një Zone të Mbrojtjesi është 100 metra nga perimetri i vendit të trashëgimisë së mbrojtur arkeologjike.
- Komuna realizon inspektime të rregullta dhe ndërmerr masat për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë.
- Komuna realizon aktivitetet të vetëdijësimit për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë dhe promovimi i tyre pë përkrahjen e zhvillimit komunal.
- Të gjitha gjetjet arkeologjike dhe trashëgimia e lëvizshme deri para vitit 1453 janë prone e Kosovës. Muzetë publikë janë institucione kompetente për menaxhimin e grumbullimeve publike.
- Trashëgimia e lëvizshme siç është e definuar në Ligjin mbi Trashëgiminë Kulturore prej më shumë se 100 vjet janë vendosur automatikisht nën mbrojtje.
- Objektet e lëvizshme, komponentet e trashëgimisë kulturore, komplekset historike dhe objektet fetare janë nën mbrojtje dhe nuk mund të lëvizen pa leje nga konteksti natyror i vendit ku janë vendosur. Masat për ruajtjen, mbrojtjen dhe konservimin e trashëgimisë së lëvizshme nën mbrojtje, distribuimi i trashëgimisë, largimi, etj. rregullohen me Ligjin mbi Trashëgiminë.
- Çdo person ligjor ose fizik ka obligim të ruajë integritetin e trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar/e, posedues/e ose përdorues/e. Çdo person ligjor ose fizik që dëmton trashëgiminë kulturore, pa marrë parasysh nga marrëdhënia e tyre, do të dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligiit për Kundërvajtje dhe në pajtim me Nenin 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Trashëgimisë.

9.2.7 Mjetet për trajtimin e mbeturinave

Komuna mban përgjegjësinë për trajtimin e mbeturinave të ngurta të komunës. Komuna harton planin lokal për menaxhim të mbeturinave në pajtim me Planin Strategjik të Kosovës për menaxhimin e mbeturinave, të cilin e ka përpiluar MMPH. Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave përfshin një periudhë prej së paku 5 vjet dhe duhet të marrë miratimin e MMPH. Dy ose më shumë komuna mund të hartojnë një plan të përbashkët. Përmbajtja dhe metoda e përgatitjes së planit duhet të jenë në pajtim me Ligjin për Mbeturinat, Nr.02/I-30.

Komuna rregullon aktivitetet e mjedisit për menaxhim të mbeturinave dhe organizon menaxhimin në territorin e vet përmes dhënies së lejeve për menaxhim të mbeturinave. Obligimet e atyre që i mbajnë mbeturinat, prodhuesit e mbeturinave, transportuesit, operatorët për trajtimin e mbeturinave dhe deponitë janë të rregulluara me ligj.

Komuna rregullon, grumbullon dhe trajton organizimin dhe metodën e ndarjes së mbeturinave për riciklim në pajtim me dispozitat ligjore (Neni 28) dhe në pajtim me planin e vet lokal. Mbeturinat e rrezikshme (eksplozivet, oksiduese, shumë të ndezshëm dhe të ndëzshëm, toksike, etj.) dhembeturinat e veçanta grumbullohen dhe transportohen veçmas me mjete të përshtatshme.

Komuna është përgjegjëse për trajtimin e ujërave të zeza. Ajo përpilon programin për rehabilitim të rrjetit ekzistues të ujërave të zeza dhe zgjerimin e rrjetit në zonat e zhvilluara. Komuna ndalon derdhjen e kanalizimit në shtretër të lumenjve dhe hedhjen e mbeturinave dhe substancave të rrezikshme.

9.2.8 Masat për parandalimin e ndikimeve të dëmshme për mjedisin

Si pjesë e përgjegjësive që i ka të definuara me ligj, Komuna siguron kontroll të vazhdueshëm dhe mbikqyr gjendjen e mjedisit në pajtim me ligjet e veçanta dhe programet monitoruese. Mbikqyrja e mjedisit përbëhet nga matjet sistematike, hulumtimi dhe vlerësimi i ndotjes së mjedisit. Kjo përfshin mbikqyrjen e faktorëve natyrorë (ajri, uji, toka, biodiversiteti, dhe peizazhi), shtresa e ozonit, rrezatimi, zhurma dhe mbeturinat, si dhe të merren parasysh obligimet dhe përgjegjësitënga marrëveshjet ndërkombëtare. Të dhënat e grumbulluara nga mbikqyrja do të përfshihen në Sistemin Informativ për Mbrojtje të Mjedisit dhe t'i prezantohen publikut.

Masat e detajuara për mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe erozioni, florën dhe faunën nga ndotja dhe degradimi dhe natyrën dhe njerëzimin nga rreziqet (sidomos zjarret, ortekët, vërshimet...) janë përshkruar në strategjitë sektoriale (Kapitulli 8). Këto masa gjithashtu kontribuojnë për zvogëlimin e ndryshimit artificial të klimës.

Vlerësimi Strategjik i Mjedisit: Komuna duhet të arrijë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe duhet të harmonizojë çështjet e mjedisit për përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve, duke siguruar se vlerësimi strategjik i mjedisit është kryer për planet dhe programet të cilat ka gjasa të kenë ndikim të dukshëm mbi mjedisin. (Ligji mbi Vlerësimin Strategjik të Mjedisit Nr.03/L-230)

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis: Projektet që mund të shkaktojnë ndotjen e mjedisit ose të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut – duke përfshirë ndryshimet teknologjike, rindërtimi, zgjerimi i kapaciteteve ose përfundimi i një aktiviteti – duhet të vlerësohen sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Nr.03/L-024. Udhëzimet për hartimin e VNM të projekteve të propozuara me PZhK gjithashtu janë dhënë me vlerësimin e ndikimit socio-ekonomik-të mjedisit të PZhK (shih Kapitulli 8 dhe SEA e PZhK).

9.2.9 Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

Për të shmangur ndikimin negativ social, komuna do të sigurojë infrastrukturën e nevojshme sociale në pajtim me projektet e parapara në plan (rritja e numrit të shkollave, qendrave rinore, muzeumeve, bibliotekave, shtëpive të kulturës, shërbimeve të lëvizshme mjekësore, sallave sportive dhe adaptimin e hapësirave për sport dhe rekreim, etj.), dhe të hartojë programet dhe aktivitetet që do të krijojnë kushtet e mirëqenies sociale.

Komuna promovon programet e punësimit dhe projektet e edukimit të të rriturve. Komuna bashkëpunon me OJQ, biznese, donatorë, etj. për të realizuar projekte që angazhojnë të rinjtë, të papunët dhe më të moshuarit të marrin pjesë aktive në shoqëri. Shpërndarja hapësinore e nënqendrave dhe masat zhvillimore sigurojnë zgjerimin e të gjitha nënhapësirave në Komunën e Dragashit deri në rajonet e Opojes dhe Gorës.

Gjatë hartimit dhe zhvillimit të projekteve të ndryshme të parapara në plan, Komuna duhet të sigurojë një proces transparent për publikun. Lidhur me këtë, komuna duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë krijimit dhe shpërndarjes së informatave, për njerëzit të cilët janë të ndikuar nga projektet dhe duhet të marrin pjesë në projekt.

9.2.10 Masat e implementimit të Planit

(a) Obligimi për hartimin e Planit

Këshilli Komunal është i obliguar të sigurojë kushte financiare dhe të tjera për përgatitjen dhe mbikqyrjen e implementimit të Planeve. Pas hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, hartimit të Planeve Zhvillimore Urbanistike (duke filluar me qytetin e Dragashit) pasojnë Planet Urbanistike Rregullative. Këto plane duhet të jenë të harmonizuara me dispozitat e PZHK.

Në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës, për çdo hapësirë që tejkalon një sipërfaqe më të madhe se 2 hektarë jashtë zonës urbane, duhet të hartohet një PUR (kjo përfshin hapësirat për parqet afariste / zonat industriale për zhvillim të turizmit, zonat sportive dhe rekreative, etj.).

Lejet ndërtimore për zhvillimet jashtë zonës urbane duhet të jenë në pajtim me vendimet e PZHK. Komuna merr parasysh dispozitat ligjore për planifikim urbanistik he lejet ndërtimore për objektet siç janë paraparë me Ligjin e Planifikimit Hapësinor, Ligjin për Ndërtim dhe ligjet e tjera relevante.

(b) Zbatimi i masave zhvillimore dhe masa të tjera

Pas miratimit të planit, Komuna ndërmerr masa për të lidhur planin me regjistrin e kadastrit, duke përfshirë aktivitetet për krijimin e planit të ri të kadastrit, nëse plani kthen përdorimin e tokës për ndonjë qëllim apo funksion tjetër. Ndërsa implementimi i ndryshimit të përdorimit të tokës mund të jetë i nevojshëm për të arritur objektivat hapësinore, shpronësimi duhet të shmanget. Komuna themelon dhe mirëmban sistemin e të dhënave të planit (sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor) i cili duhet të jetë në pajtim me atë të Ministrisë. Masat speciale duhet të ndërmerren për mbrojtjen e zonave të caktuara si pjesë e interesit të veçantë dhe në zonat e mbrojtura. (Shih më lartë).

(c) Rindërtimi i objekteve destinacioni i të cilave është në kundërshtim me destinacionin e planifikuar

PZHK do të hartojë rregulloren komunale ose madje një program (në pajtim me dispozitat ligjore) për trajtimin e ndërtimeve ilegale. Komuna nuk do të lejojë zgjerimin ose modernizimin e objekteve ekzistuese, të cilat janë në zonat e peizazheve të bukura natyrore. Problemet specifike që kanë të bëjnë me vendbanimet joformale, do të zgjidhen në pajtim me udhëzimet e MMPH/PZHH. Komuna ndërmerr masa për të parandaluar ndërtimin në zonat objektet nuk janë të lejuara.

9.3 Dispozitat lidhur me bashkëpunimin

- Komuna informon, bashkëpunon dhe/ose realizon marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me ministritë dhe agjencitë relevante për projektet e propozuara në PZHK, të cilat kërkojnë pjesëmarrjen e këtyre institucioneve.
- Komuna informon, bashkëpunon dhe/ose realizon marrëveshje bashkë-financimi me komunitat fqinje për projekte të interesit të përbashkët. Komuna bashkëpunon me Agjencinë për Zhvillim Rajonal për implementimin e projekteve të këtilla.
- Komuna informon, bashkëpunon dhe arrin marrëveshje partneriteti me ndërmarrjet publike për shërbimet publike në kompetencat e këtyre ndërmarrjeve (çështjet e furnizimit të ujit, ujërave të zeza, energjisë elektrike, menaxhimit të mbeturinave, etj.)
- Komuna bashkëpunon dhe themelon marrëveshje partneriteti (PPP) me sektorin privat për projekte, për të cilat të dyja palët kanë interesa të përbashkëta
- Komuna themelon marrëdhënie të bashkëpunimit ndërkufitar me komunitat e shteteve fqinje për projekte me interesa të përbashkët
- Komuna bashkëpunon me donatorë të ndryshëm për projekte të parapara sipas planit, implementimi i të cilave mund të ndihmohet nga programet e ndryshme donatore.

- Komuna përkrah dhe bashkëpunon me OJQ-të për një numër projektesh të parapara me plan, sidomos ato që trajtojnë fushatat e ndërgjegjësimit dhe promovimit të vlerave komunale.
- Gjatë zhvillimit të planeve të tjera që dalin nga PZHK, komuna duhet të sigurojë pjesëmarrjen dhe involvimin participle publikut (qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit) prej fazave fillestare dhe gjatë gjithë procesit, dhe të ndërmarrë fushata informative siç është paraparë me Ligjin për Planifikim Hapësinor.

9.4 Dispozitat e radhitjes kronologjike

- Siç është paraparë me Ligjin e Ndryshuar për Planifikimin Hapësinor Nr.2003-14 (Ligji Nr.03/L-106), komuna duhet të themelojë **Njësinë për Planifikim Hapësinor**. Kjo njësi duhet të jetë përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve për implementimin e planit dhe përcaktimin e kriterëve për mbikqyrjen e përhershme të planeve; dhe i raporton rregullisht autoriteteve komunale
- Brenda 6 muajve nga miratimi i PZHK, Këshilli Komunal duhet të miratojë planin buxhetor, i cili siguron qartësi mbi financimin e implementimit të planit për periudhën e ardhshme prej së paku 3 vjetësh. Krahas aspekteve të tjera, duhet të përcaktojë se si e parasheh komuna financimin e hartimit të PZHU/PUR dhe implementimin e politikave zhvillimore siç janë paraparë në planet zhvillimore (PZHK dhe PZHU)
- Veç kësaj, në këtë periudhë gjashtë mujore nga miratimi i PZHK, komuna duhet të shqyrtojë politikat e sektorëve për të plotësuar dispozitat e PZHK dhe PZHU.
- Plani Zhvillimor Komunal ka paraparë etapat e zhvillimit të aktiviteteve në vijim: Komuna themelon njësinë e planifikimit e cila do të shqyrtojë dhe mbikqyrë implementimin e planeve dhe projekteve që dalin nga ky plan, do të përgatisë raportet javore për mbikqyrjen dhe vlerësimin e planit dhe do të sigurojë sugjerime për ndryshime të mundshme, etj.
- Komuna (njësia e planifikimit) harton programin për implementim të Planit Zhvillimor Komunal.
- Verimet /projektet e propozuara në PZHK janë të përmbledhura në tre faza të zhvillimit:
 - Faza I: periudha 2013-2016, gjatë së cilës përfshihen kryesisht projektet/veprimet afatshkurta të cilat janë të lidhura me planifikimin afatmesëm komunal të buxhetit
 - Faza II: periudha 2017-2020 përfshin projektet/veprimet afatmesme
 - Faza III: periudha 2021-2023+ përfshin projektet/veprimet afatgjata
- Të gjitha investimet në komunë, të cilat kanë karakter hapësinor duhet të jenë në përputhje me propozimet dhe prioritetet e caktuara në Planin Zhvillimor Komunal
- Pas miratimit të planit dhe hyrjes së tij në fuqi, komuna duhet të analizojë planin aktual të buxhetit (kornizën buxhetore) dhe gjatë shqyrtimit të tij duhet të përfshijë projektet e parapara në kornizën e korigjuar buxhetore.

9.5 Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtejshëm

Plani Zhvillimor Komunal i Dragashit nxit hulumtimin dhe studimet e mëtjeshme në disa fusha si vijon:

- Hulumtimi i biodiversitetit përbrenda dhe jashtë Parkut Nacional
- Analiza e rrezikut gjeologjik (sidomos nga ortekët dhe rënia e shkëmbinjve)
- Veprimi-hulumtimi ekonomik, në mënyrë që të azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme Sondazhi i Burimeve dhe azhurnimi i vazhdueshëm i Udhëzuesit Strategjik
- Studimet e mundësive (fizibilitetit) për projektet e caktuara rrugore
- Hulumtimi profesional për trashëgiminë e prekshe arkeologjike, monumentale, natyrore dhe të paprekshme të Dragashit

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

- Studimi i mundësive për përdorimin e potencialit pyjor (halor) në zhvillimin e industrisë së drurit, përpunimin përfundimtar dhe marketingu i mëtejshëm, si dhe potenciali i përdorimit të teknologjive të reja të ngrohjes
- Studimet e potencialit të hidrocentraleve, rrezatimit diellor, energjisë së erës, burimeve të biomasave dhe potencialit gjeotermal

9.6 Plani i Veprimit Afatmesëm 2013-2016 Faza I

NR.	PRIORITETI	VEPRIMI	LLOJI I VEPRIMIT	INSTITUCIONI.PERSONI PERGJEGJES	SUBJEKTE TJERA TE PERFSHIRA	FINANCIMI	KOHEZGJATJA
Arsimi							
1	I larte	Hapja e shkolles profesionale	Lobim dhe Organizim	Komuna, Ministria e Arsimit	Sektori privat, bizneset, donatoret	Ministria e Arsimit, Komuna	2013- 2014
2	I larte	Integrimi i nxenesve dhe mesimedheneve nga sistemit paralel ne ate te Kosoves	Mbeshtetja e integrimit	Qeveria, Minsitria e Arsimit, Komuna	Komunitetet, Organizata e ndryshme	Komuna, Ministria	2013
3	I larte	Themelimi i mekanizmit per shperndarjen e bursave	Organizim, administrim	Komuna, Drejtoria e Arsimit	Shkollat fillore dhe Shkolla e Mesme	Komuna, Sektori Privat, Universitetet	2013-2014
4	I larte	Organizimi i aktiviteteve ndervepruese mes komuniteteve Kulturore, Arsimore, Sportive	Kordinim, organizim	Komuna, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Kultures, Rinise dhe Sportit	OJQ-te, Shkollat fillore dhe e Mesme	Komuna, Ministrite perkatese, Donacione	2014-2016
5	I mesem	Permiresimi i infrastruktures fizike neper objektet shkollore	Pregaditja e projekteve	Komuna, Drejtoria e Arsimit	Ministria e Arsimit	Komuna, Ministria Donacione	2013-2016
6	I larte	Zhvillimi i aktivitete profesionale per femra	Identifikimi kurseve te pershtatshme, Implementim	Komuna, Zyra e punesimit	Ministria e Mireqenies sociale, OJQ-te	Donacione	2013-2016
7	I larte	Integrimi i femijeve me nevoja te vecanta ne arsim adekuat	Koordinim, Implementim	Drejtoria e Arsimit,	Organizatate e ndryshme	Komuna, Donacione	2013-2016
Bujqesia dhe Pylltaria							
1	I larte	Permiresimi i infrastrukturës për bujqësinë	Lobimi/dhe konsultime	Komuna/shoqata e GLV	Ministria e Bujqësisë/donatorët	Ministria, Komuna, donatorët	2013-2016
2	I larte	Lehtësimi i qasjes në fonde	Themelimi i organit këshillues për aplikim në fonde	Komuna, shoqatat, GLV	Ministritë, donatorët	Ministria, Komuna, donatorët	2013-2016
3	I larte	Certifikimi i produkteve	Përcaktimi i standardeve për prodhime specifike	Komuna, Forumi i Vlerës së Zinxhirit	Ministritë, donatorët, agjencia për veterinë dhe ushqim, agjencia për standardizim	Ministria, agjencitë për certifikim, Komuna	2013-2016
4	I larte	Konsultime të vazhdueshme	Mbështetja për themelimin të forumit të zinxhirit të vlerës	Komuna, Forumi i Vlerës së Zinxhirit, GLV	Ministritë, organizatat vendore dhe ndërkombëtare	Bizneset private, Komuna	2013-2016
5	I larte	Të evitohet vjelja e tepruar	Draft i rregulloreve për evitimin e vjeljes së tepruar	Komuna, Forumi	Ministritë, organizatat që ofrojnë konsultime	Ministria, donatorët	2013-1013

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Ekonomia lokale							
1	I larte	Themelimi i Shoqates se Bizneseve/Prodhuesve	Lobim dhe Organizim	Komuna	Bizneset, Fermeret, Zejtaret	Komuna, Donacione	2013-2014
2	I larte	Integrimi i zingjirave te vlerave ne shoqaten e bizneseve	Lobim	Komuna	Perfaqesuesit e zingjirave te vlerave	Komuna	2014-2015
3	I larte	Instalimi i fondit garantues	Përgaditja e koncept idese, konsultim me UNDP	Komuna, Shoqata e bizneseve	AZHR, Banka,	Donacione te jashtme	2014-2016
4	I larte	Krijimi i profilit ekonomik	Perpelim, Dizajnim. Publikim, Shperndarje	Komuna, Shoqata	Sektori i biznesit, komuniteti etj	Komuna, Sektori Privat	2014
Uji dhe ujërat e zeza (kanalizimi)							
1	I lartë	Master Plani dhe projekti për së paku 4 fshatra	Dizajnimi i projektit inxhinierik	Komuna	Hidroregjioni dhe donatorë tjerë	Budget komunal, donatore	2013-2014
2	I mesëm	Përsëritja e fushatës së ngritjes së vetëdijes në baza vjetore	Ngritja e vetëdijes	Komuna, HRJ, OJQ	Drejtoria e Arsimit	Buxhet komunal, Donatore	2014-2016
3	I lartë	Përkatësia e njërive të shërbimit me HRJ së bashku me miratimin e Master Planit nga Komuna dhe MMPH	Planifikimi dhe investimet	Drejtoria e shërbimeve publike	HRJ, donatorët	Komuna, Ministria, donatoret	2014-2016
4	I lartë	Miratimi i Master Planit (Harmonizimi i Master Planit me projektet komunale)	Diskutimi i brendshëm në mes Komunës dhe HRJ	Drejtoria e shërbimeve publike	HRJ	Komuna, Asambleja komnale	2013-2014
5	I lartë	Vazhdimi i sistemeve ekzistuese dhe operative në të gjitha fshatrat	Inkorporimi në sistem	Drejtoria e shërbimeve publike	HRJ	Komuna, Donatoret	2013-2016
Mbeturinat							
1	I larte	Kyqja e 13 fshatrave te Gores ne sistemin e menaxhimit te mbeturinave	Kampanje vetedijesuese, realizim	Komuna/drejtoria e sherbimeve publike	UNDP, OJQ-te	Komuna, Donatoret/UNDP	2013
2	I larte	Aprovimi i rregullores per mbeturinat e ngurta dhe mbledhja e taksave	Administrim	Komuna, Kuvendi Komunal	Grupet lokale te veprimit	Nuk ka	2013
3	I mesem	Aprovimi i rregullores qe kushtezon regjistrimin e veturave me pagesen per mbeturina	Administrim	Komuna, Kuvendi Komunal		Nuk ka	2014
4	I larte	Pastrimi i deponive ilegale te mbeturinave	Realizim	Komuna	UNDP	Komuna, UNDP, Donatoret	2013
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale							
1	I mesem	Shendrimi i AMF ne Restelice ne QMF	Organizimi i mbrendshem	Drejtoria e shendetesise	Ministria e shendetesise	Buxheti	2015
2	I mesem	Punesimi i nje gjinekologe femer	Organizimi i mbrendshem	Drejtoria e shendetesise	Ministria e shendetesise	Ministria e Shendetesise dhe financave	2014
4	Afatgjate	Transporti i pacienteve	Nga shtepia ne QKMF	Drejtoria e shendetesise	Ministria e shendetesise	Komuna, donatore	2017

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
 Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

6	Afatgjate	Punesimi i punetoreve shendetesior ne QKMF dhe AMF	Ngritja e cilesise ne sherbimet mjekesore	Ministria e shendetesise	Ligji mbi shentesesine	Ministria e Shendetesise dhe financave	2017
Infrastruktura rrugore dhe transporti							
1	I larte	Asfaltim dhe zgjerim PZ-Dragash (nëpër Zhur)	Përpunimi i projektit	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	I jashtëm	2017-2020
2	I mesem	Asfaltim (Dragash-Pz-Zapluxhe)	Kryerja e rrugës	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	Komunal-i jashtëm	2015-2016
3	I larte	Zgjerim – asfaltim (Krushevë-Shishtavec) Shqipëri-Kosovë	Kryerja e rrugës	Drejtoria e Urbanizmit	MAPL dhe Ministria e Transportit e Shqipërisë	EC CBC	2013-2014
4	I larte	Asfaltim dhe zgjerim i rrugës Reselicë deri në kufi me Maqedoninë	Përpunimi i projektit	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	Komunal I jashtëm	2016
5	I larte	Formimi i njësisë punuese për mirëmbajtje të rrugëve lokale	Lobimi	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Spektori rajonal për rrugë	Komunal	2015
6	I larte	Asfaltim dhe zgjerim, Orçushë – Cisti, Brrut- Zgatar, Baçkë- rruga e Brodit		Drejtoria e Shërbimeve Publike	Komuna	Në ndërtim e sipër	2013-2015
7	I mesem	Zgjerim, asfaltim dhe ndërtim i mureve mbrojtëse dhe mbrojtësve anësorë (Brod rrugë 12 km)	Përpunimi i projektit, lobimi	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	I jashtëm	2016
8	I mesem	Rrugë anësore: Brod-Zlipotok-Restelicë	Përpunimi i projektit	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	Komunal-i jashtëm	2015-2016
9	I ulet	Lidhje: Livadhe Rabecke - Orgoshta - Kukës	Përpunimi i projektit	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	Komunal-i jashtëm	2017-2020
10	I ulet	Lidhje: Brezne, Buçe, Pllavë, Rapçë	Përpunimi i projektit	Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Transportit	Komunal-i jashtëm	2016
11	Afatmesëm	Asfaltimi i rrugës Radeshë Leshtan	Kryerja e rrugës	Drejtoria e Urbanizmit	Komunal	Komunal	2015-2016
Energjia							
1	I lartë	Themelimi i Zyres Komonale per energji -ZKE	Planifikim	Komuna	Ministria e Zhvillimit Ekonomik - MZHE	Komunal	2013
2	I lartë	Hartimi i Planit Komunal te Veprimit për Eficiencë të Energjise	Planifikim	Agjencia e Kosovës për Eficiencë të	Ministria e Zhvillimit	Komuna/	2013-2014

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

		– PKVEE		Energjisë – AKEE / Komuna	Ekonomik - MZHE	donatoret	
3	I lartë	Implementim i masave për eficiencën e energjisë	Planifikim / implementim	Komuna	Ministria e Zhvillimit Ekonomik - MZHE /donatoret OJQ	Komuna, Qeveria donatoret	2013-2016
4	I lartë	Shtimi i investimeve private per Energjine e Ripërtitshme	Mbeshtetje e sektorit privat (PPP)	Komuna/sektori privat	Komuna/sektori privat	Komuna/sektori privat	2014-2016
5	I lartë	Rritja e vetedijesimit per Eficiencë të Energjisë - EE dhe Burime të Ripërtitshme të Energjisë - BRE	Vetedijesim	Komuna/Zyra Komunale për Energji - ZKE/OJQ	Komuna/ Ministria e Zhvillimit Ekonomik - MZHE /donatoret OJQ	Komuna, Qeveria donatoret	2013-2016
6	I mesëm	Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji - PKVE	Planifikim	Komuna / Zyra Komunale për Energji - ZKE/OJQ	Ministria e Zhvillimit Ekonomik – MZHE / Zyra e Rregullatorit të Energjisë – ZRE	Komuna, Qeveria donatoret	2014
7	I mesëm	Implementimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji	Planifikim	Komuna / Zyra Komunale për Energji - ZKE/OJQ	Ministria e Zhvillimit Ekonomik – MZHE / Zyra e Rregullatorit të Energjisë	Komuna, Qeveria donatoret	2015-2020
Biodiverziteti dhe mbrojtja e natyres Hasan Dishallari, Halil Ibrahim, Shaban Shabani dhe Bajram Hoxha							
1	I larte	Hartimi i rregullores per mbrojtjen e mjedisit	Administrim	Komuna/zyra ligjore komunale/drejtoria e uranizmit	Ministria e ambientit/ Drejtoria e PN, OJQ, REC etc	Buxheti komunal	2015
2	I larte	Nenshkrimi i marrevshtjes me drejtorine e PN Sharri, APK, per realizimin e menaxhimit te PN	Planifikim	Komuna/zyra ligjore komunale/drejtoria e uranizmit/ Asambleja komunale	Ministria e ambientit/ Drejtoria e PN APK	Buxheti komunal	2013
3	I larte	Informimi i publikut mbi statusin e zonave te mbrojtura	Kampanje vetedijesuese	Komuna/drejtoria e urbanizimit	Drejtoria e PN, Ministria e ambientit/ oJQ	Buxheti komunal/donator	2013-2016
4	I larte	Koordinimi i subjekteve perkatese per parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri	Administrim	Komuna/drejtoria e sherbimeve publike	Policia, APK, komuniteti /ministria e puneve te mbrendshme/Agjencia e emergjencave	Komuna	2013-2020
5	I mesem	Krijimi i partneritetit me komunat nderkufitare	Planifikim	Komuna/ekonomi	Komunat nderkufitare ministrite e linjes nga dy shtetet kufitare	Komuna/Ministria/ donatoret	2013-2015
6	I mesem	Promovimi i EKO turizmit me qellim te gjenerimit te te hyrave	Kampanje vetedijesuese	Komuna/drejtoria e bujqesise /sektori i turizmit	Drejtoria e PN, Ministria e bujqesise/Ministria e Ekonomise	Komuna/donatoret	2014-2016
7	I mesem	Hartimi i planit per turizem ekologjik	Planifikim	Komuna/drejtoria e bujqesise /sektori i turizmit	Drejtoria e PN, Ministria e bujqesise/Ministria e Ekonomise	Komuna/donatoret	2014-2015
8	I mesem	Hartimi i rregullores per shfrytezimin e produkteve jodrunore	Administrim	Komuna/drejtoria e bujqesise /sektori i turizmit	Sektori privat/ojq	Komuna/donatoret	

Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës në Dragash
Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023

Vendbanimet							
1	I larte	Hartimi i planeve urbane dhe rregulluese	Planifikim	KK Dragash/ Drejtoria e Urbanizmit	Ministria e Ambientit dhe planifikimit hapësinor	Komunal/donatore	2014-2016
2	I larte	Hartimi i planeve për zvogelimin nga rreziqet natyrore	Planifikim	KK Dragash/ Drejtoria e Urbanizmit/shërbimet publike/	Ministria	Komuna/donatore	2014
3	I larte	Hartimi i planit rregullues për zonen industriale dhe zonat ekonomike	Planifikim	KK Dragash/ Drejtoria e Urbanizmit/shërbimet publike/Drejtoria e ekonomise	Ministria/sektori privat	Komuna/donatore/sektori privat	2014-2016
4	I larte	Hartimi i projekteve për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore	Planifikim	KK Dragash/drejtoria për urbanizem/kulture	Ministria e Kultures	Komuna/donatoret/Ministria	2014-2017
5	I larte	Hartimi dokumentacionit për procedurat e lejeve ndërtimore dhe kushteve ndërtimore	Planifikim	KK Dragash/drejtoria për urbanizem/ inspektoriat	Ministria e Ambientit	Komuna/Ministria	2014
Kulturë dhe turizëm							
1	I larte	Stimulimi i zhvillimit të turizmit në përgjithësi (dimëror, veror, kulturor, shëndetësor...)	Përpunimi i planit të veprimit për zhvillim të turizmit në komunë	Komuna/Drejtoria për KRS	Ministria e tregëtisë, industrisë - departamenti për turizëm	Buxheti komunal ekzistues	2014-2020
2	I larte	Të punësohet një zyrtar për turizëm	Të gjindet një ekspert nga fusha e turizmit, zyra për informim	Komuna		Komuna/donatorë të jashtëm, UNDP	2014
3	I mesem	Zhvillimi i infrastrukturës teknike	Hapja e rrugëve të reja deri te vendet turistike, elektrifikimi, uji, qendra skijimi...	Komuna	Sektori privat, Qeveria e Kosovës	Komuna, Qeveria, sektori privat	2013-2020
4	I mesem	Të ofrohet mbështetje për themelimin dhe funksionimin e Parkut Kombëtar "Sharri"	Të njoftohen banorët me përparësitë e PK dhe dobietë për banorët dhe komunën	Komuna Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Menaxhmenti i PK, Ministria e Planifikimit Hapësinor, sektori i OJQve	Komuna/Ministria	2013-2016
5	I mesem	Regjistrimi i trashëgimisë materiale dhe kulturore	Krijimi i bazës së të dhënave dhe katalogëve të ndryshëm	Drejtoria për KRS	Ministria për KRS dhe historianë lokal	Komuna/donatorët	2014-2016
6	I mesem	Edukimi i banorëve mbi dobietë nga turizmi dhe trashëgimia kulturore	Takime nëpër fshatra të cilat kanë bazë për zhvillim të turizmit	Zyrtari për turizëm	Sektori i OJQve, shkollat	Komuna/donatorët	2013-2016
7	I larte	Radhitja e garave të përlivanëve, ekspozita e qenëve të Sharrit dhe vrapimet e kuajve në aktivitete dhe manifestime tradicionale	Të organizohet promovimi në nivel qendror dhe rajonal	Komuna/Drejtoria për KRS	Qeveria e Kosovës, Ministria për KRS	Buxheti komunal	2013-2020

8	I mesem	Promovimi i trashëgimisë jomateriale dhe kulturore	Folklor, tregime, këngë, tradita të dasmave..	Komuna/Drejtoria për KRS	OJQtë, asociacioni i grave dhe vajzave	Komunal	2013-2020
9	I ulët	Muzeu etnologjik	Të gjindet një objekt i vjetër që do të kryente funksionin e muzeut apo të ndërtohet një objekt i posaçëm dhe të furnizohet me rekuizita të vjetra nga treva jonë	Komuna/Drejtoria për KRS	Donatorë, OJQ	Komunal/donatorët	2015

9.6.1 Ekipa Komunale për zbatim, Monitorim dhe Vlerësim (EKZMV)

Me qëllim që PZHK të zbatohet në përputhshmëri me prioritetet e dala dhe përkrahjes në procesin e zbatimit të planit zhvillimor komunal si dhe në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të këtij plani, duhet të formohet Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim (në tekstin e mëtejshëm: Ekipi) si organ koordinues për zbatim, monitorim dhe vlerësim i cili funksionon në kuadër të qeverisë komunale dhe i raporton bordit, kryetarit dhe Kuvendit të Komunës. Përbërja e ekipit (EKZMV) duhet të përbëhet prej kryetarit, zëvendës kryetarit dhe tre ose pesë anëtarëve nga radhët e drejtorive komunale kyçe. Ekipin duhet të udhëheqë dhe e kryeson kryetari i Ekipit, kurse në mungesë të tij, zëvendësi i kryetarit të Ekipit. Përbërja e Ekipit duhet të reflektojë barazi gjinore dhe mundësi të barabarta për të gjitha komunitetet. Përbërja e Ekipit sipas nevojës mund të zgjerohet me ekspertë tjerë profesional, mirëpo numri i anëtarëve të rregullt duhet të mbetet siç është paraparë me këtë udhëzues (5 ose 7). Përshkrimet e punës Punët administrative – teknike të Ekipit të EKZMV do të specifikojnë mandatin e saj.

9.7 Dispozitat përfundimtare

Hyrja në fuqi: Ky plan hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Komunal dhe pas 8 ditësh nga shpallja në Gazetën Zyrtare të Kosovës

Skadimi: Ky plan do të jetë i vlefshëm deri në vitin 2023. Plani duhet të rishqyrtohet/rishikohet çdo 5 vjet.

Vlerësimi dhe ndryshimet e planit; Vlerësimi dhe ndryshimet e planit: Shqyrtimi profesional i PZHK nënkupton ndryshime ose shtesa që duhen bërë në mënyrë të caktuar dhe procedura për miratimin e tyre fillestar (*Ligji për Planifikim Hapësinor, 2003/14, Neni 20*). Çdo ndryshim i propozuar, ndryshim ose shfuqizim (heqje) e planit duhet të kalojë procesin e shqyrtimit publik, i cili zgjat së paku 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë (*Udhëzimi administrativ për implementimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor lidhur me procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike 54/2005, Neni 5.4*).